

STAR PROJECT II

Consolidation of Territorial and Administrative Reform



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Manual praktik për procedurat e administrimit fiskal në njësitë e vetëqeverisjes vendore



Manual praktik për procedurat e administrimit fiskal në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Hartuar nga ESA Consulting dhe HM&H



HM&H

Prill 2019

Ky Manual është hartuar nga grupi i ESA Consulting në bashkëpunim me zyrën e avokatisë HM&H, në kuadër të projektit STAR II, i zbatuar nga PNUD. ESA Consulting falënderon Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zotin Fran Brahimi (MFE), si dhe punonjësit e bashkive, që morën pjesë në programin e ngritjes së kapaciteteve dhe e pasuruan këtë manual me përvojat e tyre nga terreni. Grupi i punës përbëhej nga Sabina Ymeri e Ervin Doçi (ESA Consulting) dhe Brunila Leskaj, Elion Shkodrani e Juna Nathanaili (HM&H). Një falënderim i veçantë shkon për Silvana Mekon, për mbështetjen e sugjerimet, dhe për specialistet Elida Fara dhe Edlira Muhedini, të projektit STAR II.

Autorë:

Brunila Leskaj
Elion Shkodrani
Juna Nathanaili

Kontribuues:

Ervin Doçi, Sabina Ymeri

Përgatiti për botim:

Sabina Ymeri

ESA Consulting

Rr. Abdyl Frashëri, Nr. 3/1 Tiranë, Shqipëri
info@esaconsulting.org

HM&H sh.p.k.

Rr. Abdi Toptani, Torre Drin 4
www.hmh.al

© UNDP, prill 2019

Deklarim

“STAR II - Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative” është projekt që zbatohet nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Tiranë, në partneritet me qeverinë shqiptare, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Bashkimit Europian, qeverive të Suedisë, Italisë, Zvicrës, si dhe USAID. Ky dokument është hartuar në kuadër të mbështetjes për përmirësimin e njohurive të punonjësve të bashkive të Shqipërisë, në lidhje me procedurat e administrimit fiskal. Ai reflekton këndvështrimet e autorëve të tij dhe jo domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të lartpërmendura.

Përmbajtja

Shkurtime	5
Parathënie	9
1. Hyrje	11
2. Parimet e sistemit tatimor	13
2.1 Parimet e përgjithshme	13
2.2 Parimet e administrimit tatimor	15
3. Konceptet dhe përkufizimet: taksë, tatim, tarifë	17
3.1 Rregullat e përbashkëta dhe dallimet e taksave dhe tarifave vendore	18
4. Funksionet kryesore të administratës tatimore vendore	23
4.1 Funksionet themelore	23
4.2 Funksionet mbështetëse	26
5. Identifikimi i taksapaguesve	31
5.1 Personat juridikë dhe fizikë	31
5.2 Rregulla të veçanta për regjistrimin e taksapaguesit individ	32
6. Procedurat e zbatueshme për mbledhjen e detyrimeve tatimore	35
6.1 Deklarimi, vlerësimi dhe njoftimi tatimor	35
7. Apeli tatimor	45
7.1 Procedura e apelit administrativ në nivel vendor	45
7.2 Objekti i ankimit administrativ	47
7.3 Dorëzimi i ankimit administrativ tatimor vendor	48
7.4 Veprimet e strukturës vendore të apelit	51
7.5 Ankimi në rrugë gjyqësore kundër vendimit të strukturës së apelit	54
7.6 Organizimi i strukturës vendore të apelit administrativ të taksave dhe tarifave vendore	55

8. Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor	57
8.1 Baza ligjore	57
8.2 Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit	58
8.3 Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit	77
8.4 Ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor	78
8.5 Mosvijimi i procedurave të mbledhjes me forcë në rast ankimi	79
8.6 Fillimi i procesit të falimentimit	79
9. Llojet e taksave vendore dhe lehtësitë ligjore	81
9.1 Përjashtimet	81
9.2 Uljet	83
9.3 Marrëveshja e pagesës me këste	84
10. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	85
10.1 Baza ligjore	85
10.2 Koncepte bazë	85
10.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional	87
10.4 Taksa mbi tokën bujqësore	88
10.5 Taksa mbi truallin	89
10.6 Taksa mbi ndërtesën	90
11. Transparenca e administratës tatimore	103
11.1 Transparenca, aksesimi në informacion dhe bashkëpunimi me taksapaguesit	103
11.2 E drejta e taksapaguesve për informim, asistencë dhe njoftim	104
11.3 Publikimi i legjislacionit për çështjet tatimore	105
11.4 Njohja dhe zbatimi i jurisprudencës për çështjet tatimore	106
11.5 Mënyrat e komunikimit me taksapaguesin	106
12. Menaxhimi i riskut	109
12.1 Mjedisi i menaxhimit të riskut	111
12.2 Procesi i menaxhimit të riskut	115
13. Referenca	121

Shkurtime

ALUIZNI	Agjencia për Legalizimin dhe Urbanizimin e Zonave Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATQ	Administrata Tatimore Qendrore
ATV	Administrata Tatimore Vendore
INSTAT	Instituti i Statistikave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
NUIS	Numri Unik i Identifikimit
NJVV	Njësi e vetëqeverisjes vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RGJC	Regjistri i Gjendjes Civile
SVAATTV	Struktura Vendore e Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZRPP	Zyra për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme

Të nderuar kryetarë dhe menaxherë të njërive të vetëqeverisjes vendore



Znj. Anila Denaj
Ministër i Financave
dhe Ekonomisë

Procesi i decentralizimit, gjatë këtyre viteve të fundit, ka njohur arritje të rëndësishme, prandaj të realizosh shërbime për qytetarët e tu, duhet së pari të kesh një buxhet të mjaftueshëm e të qëndrueshëm. Taksat dhe tarifat vendore u sigurojnë të zgjedhurve vendorë mundësinë reale, që ata të përmbushin misionin për të cilin janë zgjedhur, të përmbushin prioritetet vendore pse jo, edhe ato të qytetarëve e komuniteteve të tyre. Manuali për procedurat e administrimit fiskal në njësitë e vetëqeverisjes vendore, i hartuar në kuadër të projektit STAR II, i zbatuar nga PNUD, është një përpjekje për t'u mundësuar të zgjedhurve dhe administratave të tyre njohuri më të sakta rreth ligjit për sistemin e taksave vendore, praktika të konsoliduara të administrimit të të ardhurave, vizion dhe mjete për të rritur eficiencën e të ardhurave vendore, në mënyrë që mbledhja dhe administrimi i taksave vendore të jetë efektiv, të zvogëlojë ndjeshëm evazionin fiskal, të lejojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë mes qytetarëve.

Një ndër sfidat më të vështira që kanë financat publike është, pa dyshim, mbledhja dhe administrimi i të ardhurave nga tatimet dhe taksat vendore, proces që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi edhe në vendin tonë, në funksion të rritjes së pavarësisë financiare. Ky Manual për procedurat e administrimit fiskal të NJVQV është një instrument i rëndësishëm për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të taksave dhe menaxherëve vendorë për të thelluar dhe konsoliduar dijet dhe njohuritë e tyre, me synim

ritjen e të ardhurave publike, çka do të thotë rritje e investimeve dhe punëve publike për komunitetet e tyre.

Me përmbledhjen e kuadrit ligjor të taksave dhe tarifave vendore, të përditësuar me procedurat konkrete të administrimit të tyre, mënyrën e planifikimit të të ardhurave sipas përlogaritjes së llojshmërisë së mbledhjes, administrimit, kontrollit dhe raportimit të tyre, ky Manual do të jetë një mundësi e instrument i përshtatshëm për administratën tatimore vendore dhe, në të njëjtën kohë, një praktikë e mirë, në të cilën janë reflektuar të gjitha metodologjitë e administrimit të të ardhurave. Me këtë Manual përmbushet një detyrim ambicioz, që taksat dhe administrata fiskale vendore të konsolidohet dhe të kenë nivele të larta performance, të krahasueshme me administratën fiskale qendrore.

Edhe një herë, dua të falënderoj PNUD për ndihmën e rëndësishme që ka dhënë dhe vazhdon të japë, përmes projektit STAR II, në lidhje me modernizimin e financave vendore.

Parathënie

Në vitin 2016, qeveria shqiptare, në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, ka nisur zbatimin e projektit “STAR II - Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale”, me shtrirje në të 61 bashkitë e vendit, me qëllim që të forcojë kapacitetet institucionale e administrative të bashkive, të përmirësojë nivelin e shërbimeve publike e administrative dhe të forcojë demokracinë vendore nëpërmjet një qeverisjeje llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në procesin e vendimmarrjes. Projekti u bë i mundur me mbështetjen financiare dhe bashkëpunimin e Bashkimit European, qeverive të Suedisë, Italisë, Zvicrës, USAID, PNUD dhe të qeverisë shqiptare.

Në kuadër të projektit STAR II, ESA Consulting, në bashkëpunim me zyrën ligjore HM&H, u angazhuan për të mbështetur bashkitë për fuqizimin e kapaciteteve për menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Ndihma teknike u dha gjatë periudhës maj 2018-prill 2019. Qëllimi kryesor ishte fuqizimi i kapaciteteve institucionale për proceset e administrimit tatimor dhe ofrimi i njohurive rreth metodave e praktikave më të mira për zyrtarët vendorë. Ngritja e kapaciteteve synonte përforcimin e njohurive rreth të gjitha elementeve thelbësore e të nevojshme, që janë pjesë e një sistemi të mirë të administrimit tatimor, si: përcaktimi i politikave fiskale, parashikimi i mirë i të ardhurave, role dhe përgjegjësi të qarta, sisteme të vlerësimit të riskut, kontroll i brendshëm dhe transparencë fiskale. Përfituesit e drejtpërdrejtë të ndihmës ishin drejtoritë e financës dhe drejtoritë e taksave e tarifave dhe aktorë të tjerë, sipas vlerësimit. Në kuadër të këtij projekti, u krye një vlerësim i thellë fillestar i kuadrit rregullator; praktikave ekzistuese në nivel vendor për administrimin fiskal dhe nevojave të trajnimit të bashkive dhe për 61 bashki u organizuan trajnime dyditore.

Ky Manual praktik ka për qëllim t’u vijë në ndihmë administratave tatimore vendore në ushtrimin e autoritetit të tyre ligjor për mbledhjen dhe miradministrimin e detyrimeve tatimore vendore, me synim rritjen e të ardhurave vendore.

Ai synon të plotësojë një nevojë të administratorëve vendorë dhe t’u japë atyre në duar një dokument orientues e përmbledhës të dispozitave ligjore, që normojnë procedurat e administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave vendore, duke qartësuar e disiplinuar hapat proceduralë në përputhje me procedurat ligjore ta-

timore. Ai i jep gjithashtu mundësi menaxhimit të bashkisë, për të vendosur mbi disa çështje të pambuluara e për t'ua adresuar ato institucioneve kompetente në formën e propozimeve.

Për hartimin e këtij Manuali kanë shërbyer si burim:

- Kushtetuta e Shqipërisë;
- Karta Europiane e Autonomisë Vendore, ratifikuar me Ligjin Nr. 8548, datë 11.11.1999;
- Ligji Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; (më poshtë referuar si "Ligji për taksat vendore");
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë referuar si "Ligji për procedurat tatimore");
- Ligji Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë referuar si "Udhëzimi për procedurat tatimore");
- Manuali i mbledhjes së detyrimeve tatimore të administratës tatimore qendrore.

Ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor bazë, që ndikojnë procedurat e planifikimit dhe administrimit fiskal vendor, pas datës në të cilën ky Manual është botuar, duhet të reflektohen në një variant të rishikuar.

1. Hyrje

Misioni i administrimit fiskal është të rritë efikasitetin në edukimin e bazës së taksueshme, të ofrojë shërbimin më të mirë të mundshëm dhe të fitojë besimin e qytetarëve, duke bërë të mundur njëkohësisht edhe pagesat vullnetare në masë të gjerë të taksave e tarifave vendore nga ana e taksapaguesit.

Administrata vendore është hallka më e rëndësishme midis individit, zhvillimit të rajonit, qeverisë qendrore dhe zbatimit të ligjit. Sikurse të gjithë e dimë, bërthama kryesore e një shoqërie është familja, bashkia, qarku ku ato bëjnë pjesë dhe qeveria qendrore. Nevoja për një qeverisje publike ka ardhur si pamundësi për të projektuar e ndërtuar nga individët ato shërbime që konsiderohen të mëdha, përtej fuqisë personale dhe familjare. Qeveria qendrore, nëpërmjet procesit institucional dhe këshillimit me pushtetin vendor, vendos për zhvillimin ekonomik-social e kulturor të një shteti. Nevojat dhe zhvillimet familjare apo rajonale bëjnë të mundur lidhjen mes rajoneve të ndryshme dhe legjislativit për përgatitjen sa më përthithëse të ligjeve të një vendi nga rajonet dhe familjet. Pa dyshim, këto ligje duhet të jenë në unitet me traditën, kushtet social-ekonomike dhe interesat e ndërsjella të bashkësisë.

Detyra kryesore e qeverisë vendore është pikërisht administrimi sa më i mirë i interesave të komunitetit. Sa më në dijeni të jetë pushteti vendor për nevojat e qytetarëve, aq më shumë do ta ndihmojë bashkësinë në plotësimin e këtyre nevojave.

Kriteret kryesore që bashkitë duhet të analizojnë përpara se të marrin vendime janë:

- Si është gjendja e infrastrukturës aktuale (rrugore, hekurudhore, ajrore ose detare, në varësi të pozicionit gjeografik që ndodhen);
- Cilat janë kapacitetet akomoduese për qëllime banimi, tregtimi, magazinimi, industriale etj.;
- Si është perceptimi i cilësisë së jetës (shërbimet publike, shëndetësia, shkollat, shërbimet argëtuese, si dhe niveli i sigurisë së pronës e jetës);
- Si është përbërja e fuqisë punëtore në bashkitë përkatëse, duke filluar nga përqindja në kualifikime, arsimimi, mosha mesatare, të ardhurat mesatare, si

dhe kostoja e fuqisë punëtore;

- Si është klima e biznesit në marrëdhënie me qeverinë vendore dhe sa e informon e ndihmon kjo biznesin me stimuj që qeveria qendrore ofron për biznesin e vogël, sipas fushave përkatëse.

Në lidhje me sa më sipër, qeveria vendore përdor instrumentet ligjore, duke filluar nga Kushtetuta, kodet e ndryshme ligjore e deri te vendimet bashkiake përkatëse. Funkzionet dhe kompetencat e vetëqeverisjes vendore përcaktohen me Ligjin e veçantë Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore". Në këtë ligj specifikohen funksionet dhe kompetencat e vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i këtyre funksioneve përbën fillimin e një administrimi fiskal efikas. Të gjitha këto shërbime vendore financohen nga:

- Burimet e veta (taksa, tarifa dhe të ardhura të tjera vendore);
- Fondet e transferuara nga qeverisja qendrore;
- Fondet që vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave kombëtare;
- Huamarrje vendore, donacione, si dhe burime të tjera të parashikuara me ligj.

Financimi nga burimet e veta duhet të jetë burimi kryesor i pushtetit vendor. Nëse administrohet dhe projektohet në mënyrën e duhur, siguron sukses mbi 90% në realizimin e të ardhurave, bazuar dhe në studimet e praktikave më të mira ndërkombëtare. Rritja e efikasitetit në mbledhjen e taksave e tarifave vendore bëhet i mundur duke ofruar shërbime sa më të mira dhe duke zbatuar ligjin në mënyrë të drejtë për çdo qytetar.

Potenciali fiskal i çdo bashkie është lehtësisht i evidentueshëm nëse bëhet një punë e konsiderueshme në mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave dhe në zbatimin e ligjit në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, duke marrë parasysh faktorët ekonomiko-socialë të asaj shoqërie, duke informuar të gjithë aktorët, si dhe duke zbatuar frymën e ligjit me të gjithë levat ekonomike që ofron kuadri ligjor.

2. Parimet e sistemit tatimor

2.1 Parimet e përgjithshme

Respektimi i ligjit¹

Në veprimtarinë e tyre, organet e njësive të vetëqeverisjes vendore zbatojnë legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Për sa i përket legjislacionit tatimor, ai përbëhet nga marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet tatimore specifike dhe aktet e tyre nënligjore, përfshirë vendimet e Këshillit të Ministrave, udhëzimet dhe urdhrat e ministrit të Financave, rregulloret dhe udhëzimet teknike të lëshuara nga administratat tatimore.

Një rol të veçantë për njësitë e vetëqeverisjes vendore luajnë edhe vendimet e miratuara nga këshillat e njësive vendore, sidomos këshillat bashkiakë, për sa i përket zbatimit në territoret përkatëse të politikave fiskale në nivel vendor.

Aktet ligjore më të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre janë:

- Kushtetuta e Shqipërisë dhe
- Karta Europiane e Autonomisë Vendore².

Kompetencat, funksionet dhe veprimtaria e tyre në kuadër fiskal bazohen kryesisht në legjislacionin tatimor, i cili përbëhet mbi të gjitha nga:

- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore";
- Ligji Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Procedurat zbatuese për taksat vendore, ushtrohen sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve të miratuara në zbatim të tij³.

¹ Shih Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

² Ratifikuar me Ligjin Nr. 8548, datë 11.11.1999, "Për ratifikimin e Kartës Europiane të autonomisë vendore".

³ Shih Udhëzimin e ministrit të Financave, Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Autonomia vendore¹

Njësitë e vetëqeverisjes vendore veprojnë duke u bazuar në parimin e autonomisë vendore, i sanksionuar dhe garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe Karta Europiane e Autonomisë Vendore.

Nisur nga përkufizimi ligjor i ligjit për vetëqeverisjen vendore, "*Autonomi vendore*" konsiderohet e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.

Autonomia fiskale²

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtën të krijojnë, të mbledhin të ardhura dhe të bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, duke vendosur taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe duke përcaktuar nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin.

Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantohet e drejta për të krijuar të ardhura në mënyrë të pavarur, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe të drejtën për të përfituar transfertë të pakushtëzuar nga buxheti i Shtetit dhe të drejtën për të përfituar nga ndarja e të ardhurave nga taksat kombëtare.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi të plotë në përdorimin e të ardhurave të tyre, të grumbulluara nga burimet e mësipërme.

Garantimi i mjaftueshmërisë financiare³

Politikat kombëtare financiare duhet të garantojnë mjaftueshmërinë financiare të vetëqeverisjes vendore, bazuar në shumëllojshmërinë e burimeve të të ardhurave. Funksionet dhe kompetencat e deleguara shoqërohen gjithmonë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara prej qeverisjes qendrore dhe fondet që atyre u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj, siç mund të jenë: huamarrja vendore, të ardhurat nga qiratë dhe shitja e pronave, huamarrja apo kredidhënia, investimet mbi kapitalet, titujt, fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi apo bashkëpronësi, nga partneritetet publike-private, donacionet, grantet, ndihmat, interesat dhe gjobat, si dhe mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive apo veprimtari të tjera, të përcaktuara me ligj.

¹ Shih Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

² Shih Ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

³ Shih Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Përputhshmëria me sistemin buxhetor

Ky parim përcakton se njësia e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

2.2 Parimet e administrimit tatimor¹

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organet tatimore i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me Ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Për sa i përket veçanërisht administrimit tatimor në nivel vendor, zbatohen parimet në vijim:

- Zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore, që do të thotë që legjislacioni tatimor, dispozitat nënligjore, përfshirë udhëzimet teknike dhe manualët tatimore, zbatohen në mënyrë uniforme e të logjikshme për çdo taksapagues në rrethana të njëjta e të ngjashme;
- Nxitja e vetëdeklarimit të detyrimeve tatimore nga ana e taksapaguesit;²
- Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore, që nënkupton detyrimin e administratës tatimore për të informuar taksapaguesit, agjentët dhe përfaqësuesit tatimorë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që disponon, përfshirë publikimet elektronike, në median e shkruar dhe audiovizive, botimin e fletëpalosjeve etj.
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive e planeve operacionale, për të garantuar zbatimin e legjislacionit tatimor dhe luftën ndaj shmangieve tatimore dhe të evazionit tatimor;
- Ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;
- Nxitja e shërbimeve elektronike tatimore, sidomos e deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor.

¹ Shih Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

² Në nivel qendror, ky parim përfshin edhe nxitjen e vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit, që nënkupton të drejtën e tatimpaguesve për të llogaritur dhe përmbushur detyrimet e tyre tatimore në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel vendor, për taksat të ndryshme (p.sh. taksat e ndërtesës) nuk zbatohet parimi i vetëvlerësimit, por ai i vetëdeklarimit, si dhe i vetëdeklarimit të ndryshimeve të tjera që mund të sjellin ndryshime në përlogaritjen e detyrimeve (p.sh. kalimi nga biznesi i vogël në të madh; apo ndryshimi i llojit të aktivitetit për bizneset).

- Rekrutimi, trajnimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve tatimorë, të ndershëm, të sjellshëm e të drejtë dhe që, për çdo rast, zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet, në bazë të fakteve objektive.

3. Konceptet dhe përkufizimet: taksë, tatim, tarifë

Është shumë e rëndësishme që administrata vendore të njohë mirë konceptet, nocionet, përkufizimet dhe termat e përdorur, për sa u përket veçanërisht taksave dhe tarifave vendore, në mënyrë që të shmanget zbatimi jokorrekt i politikave fiskale apo shkelja e legjislacionit. Legjislacioni në fuqi i përkufizon si në vijim nocionet tatim, taksë dhe tarifë:

*Tatim*¹ është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo në buxhetin e organeve të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave e shërbimeve të caktuara.

*Taksë*² është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e shtetit apo në buxhetin e organeve të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, i cili ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik.

*Taksë vendore*³ është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, i cili ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

*Tarifë vendore*⁴ është pagesa që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Ndryshimet themelore të këtyre termave lidhen me elementet e mëposhtme:

- Pagesa e tatimit nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara;
- Pagesa e taksës bëhet në shkëmbim të një të drejte apo shërbimi të caktuar;

¹ Shih Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

² Shih Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

³ Shih Ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

⁴ Shih Ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- Tatimet dhe taksat e përhershme vendosen me ligj, kurse taksat e përkohshme dhe tarifave vendore vendosen nga këshilli bashkiak;
- Tarifave paguhen vetëm nëse përfitohet një e drejtë, një e mirë apo një shërbim publik.

3.1 Rregullat e përbashkëta dhe dallimet e taksave dhe tarifave vendore

3.1.1 Taksat vendore

Taksat vendore mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.

Taksat e përhershme vendore përcaktohen me ligj, ndërsa *taksat e përkohshme* vendore mund të vendosen nga këshilli bashkiak përkohësisht, kur gjykohet e domosdoshme dhe në interes të përgjithshëm të komunitetit.

Për sa u përket taksave vendore të përhershme, njësi e vetëqeverisjes vendore ka këto kompetenca të njohura nga legjislati:

- Bën kategorizime më të hollësishme, brenda kategorive minimale të bazës së taksës;
- Vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar, për çdo kategori e nënkategori të bazës së taksës;
- Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e shlyerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale;
- Përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave;
- Përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella;
- Rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake, në mbështetje të administrimit të taksave vendore;
- Vendos rregullat e raportimit, të dokumentimit dhe kontrollit të taksave vendore;
- Vendos kriteret dhe procedurat e marrëdhënieve me taksapaguesit, përfshirë të drejtën e tyre të ankimit;
- Përcakton mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ka të drejtë të vendosë *taksë të përkohshme vendore* për ofrimin e shërbimeve dhe të investimeve publike specifike, për një periudhë të caktuar kohore.

Vendosja e taksës së përkohshme duhet të bazohet në një plan të posaçëm, i cili përmban:

- Shërbimin apo investimin specifik që financohet nga taksa e përkohshme;
- Kohëzgjatjen e taksës së përkohshme dhe të ardhurat që pritet të mblidhen;
- Koston dhe afatet e kryerjes së shërbimit e investimit dhe burimet e tjera të financimit.

Ky plan duhet të konsultohet nëpërmjet dëgjesave publike me komunitetin vendor në të paktën tri konsultime publike të kryera në një periudhë jo më pak se pesë muaj dhe më pas miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Taksa të përkohshme mund të vendosen edhe për qëllime që u shërbejnë vetëm disa zonave të caktuara të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Numri dhe kohëzgjatja e taksave të përkohshme u nënshtrohen disa kufizimeve si më poshtë¹:

- Baza e llogaritjes së taksës së përkohshme është vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme të taksapaguesit dhe niveli i taksës së përkohshme nuk mund të jetë më i lartë se 35% e bazës së taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit në atë njësi të vetëqeverisjes vendore.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të zbatojnë më shumë se dy taksa të përkohshme gjatë një viti buxhetor².
- Përveç kësaj, taksat e përkohshme, zbatohen për një afat të përcaktuar kohor, i cili nuk mund të jetë më shumë se tre vjet nga data e hyrjes në fuqi të tyre³.

Pra, vendosja e një takse të përkohshme vendore nuk mund të miratohet në kushte të përgjithshme të papërcaktuara apo, në rastin më të keq, thjesht sepse burimet financiare të bashkive janë të pamjaftueshme. Taksat e përkohshme vendore duhet të kërkohen vetëm nëse do të jepet një shërbim apo nëse do të kryhet një investim specifik. Po kështu, duhet të përcaktohet edhe afati kohor i

¹ Vihet re se, ligjvënësi, për të shmangur arbitraritetin apo abuzimet e mundshme të diskrecionit mbi politikat fiskale të zbatueshme në nivel vendor, ka vendosur disa mekanizma kufizues për sa i përket zbatimit të taksave të përkohshme vendore. Këtu mund të identifikohen kufizimet në lidhje me kohëzgjatjen, lidhjen e domosdoshme me një shërbim apo investim specifik, konsultimin paraprak publik, si edhe numrin e kufizuar të tyre.

² Shih pikën 9, neni 13 i Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

³ Shih pikën 2, neni 13 i Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

zbatimit të tyre. Të gjitha këto elemente vlerësuese duhet të përfshihen në planin specifik të zbatimit të taksës. Përveç sa u tha më sipër, ky plan zbatimi i tyre duhet të konsultohet paraprakisht me publikun në të paktën tri dëgjesa publike në një periudhë prej pesë muajsh.

Përpara se të miratojnë vendosjen e taksave të përkohshme, këshillat bashkiakë duhet të verifikojnë me kujdes plotësimin e kushteve ligjore të mësipërme, si dhe kryerjen korrekte të procedurave të konsultimit publik.

3.1.2 Tarifat vendore

Në ndryshim nga tatimet dhe taksat e përhershme, të cilat miratohen me ligj, vendosja e tarifave vendore është kompetencë e këshillit të njësisë vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë. Tarifat vendore në nivel bashkie miratohen me vendim të këshillit bashkiak, i cili përcakton llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcakton nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent. Edhe tarifat vendore mund të jenë të përhershme ose të përkohshme.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të krijojnë të ardhura nga zbatimi i tarifave vendore të mëposhtme¹:

- Zënia dhe përdorimi i hapësirës publike dhe fasadave;
- Mbledhja dhe largim i mbetjeve;
- Furnizimi me ujë dhe kanalizimet;
- Shërbimi i ujitjes dhe kullimit;
- Shërbimet administrative dhe dhënien e licencave, lejeve e autorizimeve;
- Tarifa të tjera, të përcaktuara në ligj (p.sh., mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit²);
- Tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i Njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Tarifa të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj.

Edhe në rastin e tarifave vendore, legjislacioni vendos disa rregulla specifike. Së pari, si rregull i përgjithshëm, niveli i tarifave të shërbimeve publike, synon mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar. Gjithashtu, niveli i tarifave duhet

¹ Shih nenin 14 i Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

² Shih nenin 17 i Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

të jetë në përpjesëtim të drejtë me konsumin ose përfitimin, që në parim duhet të jetë i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, me anë të instrumenteve që përcaktojnë aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë.

Për sa u përket llojeve të tarifave vendore të zbatueshme, të identifikuarra më sipër, legjislacioni detajon se, tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave zbatohen në rastet e mëposhtme:

- Për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi;
- Për përdorimin e tabelave të reklamave;
- Për zënien e hapësirave të parkimit për mjete motorike;
- Për zënien e sipërfaqeve për kamping, tenda dhe mjete të tjera për përdorim të përkohshëm;
- Për zënien e brigjeve ujore për biznes dhe qëllime të tjera;
- Për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve e të mjeteve të lundrimit dhe objekteve të tjera në det, lumenj ose liqene;
- Për mbajtjen dhe përdorimin e barkave e të platformave pluskuese;
- Për restorante dhe mjedise të tjera ushqimi dhe argëtimi pranë detit, lumenjve ose liqeneve;
- Për zënien e hapësirës publike për rulota dhe trajlera;
- Për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit;
- Tarifa të tjera, të vendosura nga këshilli i NJVV.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë autonomi në lidhje me miratimin e tarifave për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, ndërsa për furnizimin me ujë e kanalizimet dhe për ujitjen e kullimin tarifat miratohen nga Enti Rregullator i Ujit.

Tarifat për shërbimet administrative mund të vendosen për lëshimin e dokumenteve zyrtare nga NJVV, në një nivel të tillë që të mbulojnë vetëm kostot e shërbimit për të cilin bëhet pagesa e tarifës.

4. Funkcionet kryesore të administratës tatimore vendore

Ky seksion jep një tablo të përgjithshme të funksioneve themelore dhe mbështetëse të administratës tatimore, ndërsa seksionet në vijim trajtojnë në mënyrë më të hollësishme ato më kryesoret. Të gjitha funksionet në tërësinë e tyre shërbejnë për realizimin e misionit dhe objektivit final të ATV, që është mbledhja e taksave dhe tarifave në mënyrën më efektive dhe eficiente.

4.1 Funkcionet themelore

i. Regjistrimi i taksapaguesve

Pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave, në përputhje me Ligjin “Për sistemin e taksave vendore” dhe me Ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.¹

Krijimi i një baze të saktë të dhënash është një element kyç i administrimit tatimor. Mbledhja dhe regjistrimi në kohë dhe në mënyrë të saktë i informacionit bazë të identifikimit të taksapaguesit, e lejon administratën tatimore të kuptojë bazën e saj të taksapaguesve, të punësojë stafin e nevojshëm dhe të planifikojë funksione të tjera. Administrata nuk mund t’i menaxhojë taksapaguesit e saj, nëse nuk e di se cilët janë ata, ku ndodhen dhe nëse janë aktivë ose joaktivë. NJVV kanë detyrimin të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të subjekteve fizike dhe juridike, që u nënshtrohen taksave dhe tarifave vendore të vendosura në territorin në kompetencë të tyre².

¹ Udhëzimi, në zbatim të nenit 12 të Ligjit 68/2017, nuk ishte miratuar ende në kohën kur u botua ky Manual.

² Detyrimi për krijimin e regjistrit të taksave dhe taksapaguesve vendorë përcaktohet në Ligjin 9632. Gjithashtu, Ligji për financat vendore 68/2017, neni 12, parashikon detyrimin për krijimin e këtij regjistri, forma dhe përmbajtja e të cilit përshkruhet me anë të një vendimi të ministrit të Financave

ii. Përpunimi i njoftimeve dhe pagesave tatimore

Legjislatiioni tatimor kërkon që çdo taksapagues të paraqesë dokumentacionin ligjor në lidhje me formën e aktivitetit dhe pronën, si dhe të paguajë detyrimin e duhur, për çdolloj takse apo tarife, brenda afateve të caktuara sipas VKB të secilës bashki. Përgatitja dhe dërgimi te çdo subjekt apo individ i njoftim-detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore brenda afateve, është përgjegjësi dhe një nga detyrat kryesore të administratës tatimore vendore.

iii. Kundërshtimet dhe apelimet

Një nga funksionet e rëndësishme të administratës tatimore lidhet me mundësimin e paraqitjes së ankimeve nga taksapaguesit dhe shqyrtimin e vendimmarrjen në lidhje me to. Bashkitë duhet të miratojnë një strukturë të posaçme apelimi, sipas rregullave të përcaktuara në seksionin specifik të ankimit, i detajuar në këtë Manual (Seksioni 7).

Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimet tatimor në bashki.

iv. Mbledhja e detyrimeve të prapambetura

Kur administrata tatimore konstaton se taksapaguesi nuk i ka paguar në afat detyrimet, ajo ka autoritetin për t'i mbledhur këto të fundit me forcë. Në çdo rast, para se të nisnin procedurat e mbledhjes me forcë, duhet verifikuar situata e taksapaguesit, sipas përmbledhjes së mëposhtme:

Administrata nuk mund të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë	Administrata fillon procedurat e mbledhjes me forcë
Detyrimi është apeluar	Detyrimi nuk është apeluar; apo Ka humbur e drejta e apelimet; apo Ekziston një vendim apelimi i formës së prerë

Në rastet kur detyrimi tatimor nuk është apeluar, ose është humbur e drejta e apelimet, ose ekziston një vendim apelimi i formës së prerë, administrata tatimore është e detyruar të dërgojë në adresë të tatimpaguesit njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore dhe ta njoftojë atë për nisjen e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore.

dhe Ekonomisë (ende të pamiruar). Megjithatë, duhet vënë në dukje se përkufizimi i ligjit nuk përfshin shprehimisht detyrimin për mbajtjen e regjistrimit të taksapaguesve individualë dhe familjarë, ndonëse kjo do të përbënte një praktikë të mirë dhe do të ndihmonte ATV për identifikimin e taksapaguesve dhe përpunimin më të lehtë të njoftimeve e mbledhjes së detyrimeve.

v. Shërbimi i taksapaguesit

Ky funksion mund të konsiderohet edhe si përmbledhës i të gjitha funksioneve të ATV, pasi konsiderohet si një shërbim publik, që institucionet e administratës të vetëqeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre, u ofrojnë individëve, personave fizikë dhe juridikë.

Struktura e shërbimit të taksapaguesve është përgjegjëse për të bashkëvepruar drejtpërdrejt me taksapaguesit e biznesit dhe ata familjarë për çdo paqartësi, pyetje, korrespondencë, duke u ofruar ndihmë të përditshme për çdo problem që mund të lindë mes palëve. Kjo strukturë është gjithashtu përgjegjëse për këshillimin e taksapaguesit, prandaj punonjësit e saj duhet të kenë aftësi e njohuri profesionale në nivel të lartë, si dhe aftësi të mira komunikimi.

Meqenëse kjo strukturë është kontakti i parë për çdo problem të ngritur nga taksapaguesit, informacioni i mbledhur prej saj, në rast se përdoret me maturi, mund të çojë në zbatimin e strategjive të reja në përputhje me misionin dhe vizionin e autoriteteve të taksave për përmirësimin e efikasitetit.

vi. Inspektimi në terren

Inspektimi në terren është një funksion specifik i administrimit të detyrimeve tatimore në nivel vendor. Struktura kompetente për administrimin në terren bën të mundur mbledhjen e informacionit dhe zbulon rastet e subjekteve taksapagues, që nuk janë regjistruar në administratën tatimore vendore, nuk deklarojnë ose kanë ndërprerë deklarimin dhe pagesën e detyrimeve të tyre vendore. Informacioni i grumbulluar dhe i përpunuar nga kjo strukturë, shërben si bazë për hartimin e planeve periodike të veprimit, për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve. Për shkak të rëndësisë që ka funksioni i inspektimit në terren, inspektorët e kësaj strukture përzgjidhen me kujdes në bazë të legjislacionit përkatës. Drejtuesi i Zyrës së Taksave të NJVV duhet të sigurohet që, para se të dalin në terren, këta inspektorë të jenë trajnuar, të kenë marrë kualifikimin e duhur për të zbatuar funksionet e tyre, si dhe të jenë të monitorueshëm.

Për të siguruar autoritetin në mbledhjen e informacionit rreth statusit ose aktivitetit të taksapaguesit, duke synuar mbrojtjen e interesave publikë dhe konsolidimin e të ardhurave, inkurajimin për përmbushje vullnetare, shkurajimin e shmangies tatimore, kompetencat dhe detyrat e strukturës së inspektimit në terren mund të përmbledhen në një rregullore të veçantë të NJVV. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, inspektorët e strukturave të terrenit duhet të garantojnë në çdo kohë të drejtat që ligji u jep taksapaguesve.

4.2 Funkcionet mbështetëse

i. Teknologjia e informacionit

Teknologjia e informacionit (TI) u lejon administratave tatimore që të mbledhin dhe analizojnë më mirë informacionin, të administrojnë në mënyrë proaktive ngarkesën dhe burimet e punës, të nxisin bashkëpunimin me taksapaguesit dhe të standardizojnë trajtimin e tyre, duke lehtësuar zbatimin uniform të ligjeve tatimor.

ATV duhet të ndjekë ndryshimet në mjedisin e biznesit dhe atë legjislativ e të përshtatë sistemet e saj të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit (aty ku është e zbatueshme) dhe proceset e punës për arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të duhur.

Përdorimi i sistemeve moderne të informacionit shkurton kohën e administratës tatimore për llogaritjen e detyrimeve tatimore dhe shmang gabimet e mundshme si pasojë e llogaritjes manuale të tyre. Efienca e punës së stafit të ATV rritet, duke shkurtuar edhe kohën e përpunimit të informacionit. Përdorimi i teknologjisë së informacionit lehtëson po ashtu respektimin vullnetar të detyrimeve nëpërmjet krijimit të kanaleve të shumëllojshme elektronike, interaktive me taksapaguesit dhe ndihmëse në monitorimin e zbatueshmërisë dhe përputhshmërisë, nëpërmjet mbledhjes e menaxhimit të informacionit. Kontakti me taksapaguesit lehtësohet, sepse lejohet përpunimi i të dhënave më me lehtësi sipas kriterëve të përzgjedhura, kërkesave dhe nevojave, duke e bërë marrëdhënien mes palëve edhe më transparente. Për më tepër, siç ndodh edhe me organizatat e tjera, TI-ja moderne lehtëson vendimmarrjen duke u dhënë informacionin e duhur menaxherëve dhe stafit.

Në të njëjtën kohë, ATV mund të hartojë raporte përmbledhëse dhe të mbajë një informacion më të saktë e të përditësuar, me qëllim parashikimin më të saktë të të ardhurave dhe hartimin e politikave fiskale vendore më të drejta nga ana e drejtuesve të bashkive dhe këshillave bashkiakë.

ii. Shërbimet ligjore

Vendimet tatimore shpeshherë kërkojnë analiza më të gjera ligjore, mund të kenë ndikim të rëndësishëm e të ndjeshëm në mbledhjen e të ardhurave nga ATV, si dhe mund të jetë e nevojshme përfshirja e një avokati/këshilluesi ligjor me njohuri më të specializuara rreth legjislacionit fiskal. Funkcioni ligjor brenda ATV realizohet nga një departament apo sektor i posaçëm, në varësi të madhësisë dhe strukturimit të secilës bashki. Stafi që mbulon këtë departament apo sektor përfaqëson ATV në të

gjitha procedurat gjyqësore me taksapaguesit. Roli i saj zgjerohet duke përfshirë këshillimin ligjor në apelime, ndihmë në interpretimin e legjislationit tatimor, si dhe në mbledhjen e detyrimeve tatimore, për të cilat nevojitet ndërveprimi me organet gjyqësore.

iii. Burimet njerëzore

ATV mbështetet fort në personelin e saj për mbarëvajtjen e aktivitetit të vet, ndaj dhe menaxhimi i burimeve njerëzore është çështje shumë e rëndësishme.

Funksioni i BNJ duhet që, në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase, të mbështesë nevojat e ATV, duke bërë të mundur rekrutimin e punonjësve, të cilët kanë performancë të lartë. Në role drejtuese duhet të vendosen individë që paraqesin jo vetëm nivele të larta të njohurive teknike e legjislative, po edhe nivele të larta menaxheriale për të organizuar punonjësit e çdo departamenti, me qëllim arritjen e qëllimeve përkatëse.

Ka shumë llojshmëri në ndarjen e funksioneve brenda administratave tatimore. Megjithatë, statistikat e OECD vënë në pah ngjashmëritë në shpërndarjen e stafit në funksionet e nivelit të lartë (30% në menaxhimin dhe shërbimin e tatimpaguesve, 32% në auditim e verifikim, 10% në mbledhjen me forcë të detyrimeve, 15% në menaxhimin e taksapaguesve të mëdhenj dhe 13% në të tjera)¹. Ndryshimet përcaktohen kryesisht nga niveli i përdorimit të vetëvlerësimit, nga automatizimi, nga konsolidimi i detyrave në përpunimin e të dhënave dhe qendrat e shërbimit të klientëve, nga jashtëkontraktimi për funksione, të tilla si mbështetja me sisteme TI, si dhe madhësia dhe struktura organizative e stafit të terrenit.

Edhe pse protokollin e rekrutimit për administratën tatimore, si pjesë e administratës publike, është i përcaktuar në një kuadër ligjor të veçantë, një mënyrë për t'u siguruar se një kandidat ka cilësitë e përshtatshme për pozicionin e punës është ndjekja e metodës së përzgjedhjes "bazuar në sjellje". Kjo mënyrë përzgjedhjeje bazohet në njohuritë, aftësitë dhe sjelljet që lidhen drejtpërdrejt me ato që janë të nevojshme për vendin e punës. Hapat në këtë përzgjedhje përfshijnë përcaktimin e kriterëve të zgjedhjes, identifikimin e burimeve të përzgjedhjes, intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar.

Kualifikimi i arsimit universitar është një fillim i mirë kur nevojitet një staf më i kualifikuar. Për më tepër, stafi i administratës tatimore i të gjitha niveleve mund të hyjë në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, ndaj ai ka nevojë për aftësi të mira ndërpersonale dhe aftësinë për t'u përballur me situata konfliktive. Nevojat për

¹ Këto statistika janë vetëm indikative dhe u referohen administrative tatimore qendrore, të cilat kanë specifika të ndryshme nga ato vendore.

kualifikimet arsimore duhet të specifikohen në përshkrimet e plota të vendeve të punës që duhet të krijohen për çdo pozicion.

Trajnimi, që duhet të zbatohet në të gjithë administrimin publik, duhet të përfshijë trajnimin e hyrjes (procesi gjatë të cilit punonjësit përshtaten ose familjarizohen me punën dhe mjedisin e punës), etikën, menaxhimin e projekteve dhe aftësitë udhëheqëse. Gjithashtu, punonjësit e administratës tatimore vendore duhet të marrin edhe trajnime teknike të specializuara.

Menaxhimi i performancës është procesi i menaxhimit të punonjësve dhe ekipeve të administratës tatimore, bazuar në pritshmëritë e përcaktuara të performancës dhe në rezultatet e matura të saj. Procesi do të thotë që drejtuesit, në mënyrë të vazhdueshme, duhet: 1) të përcaktojnë kërkesat dhe pritshmëritë e performancës; 2) t'u komunikojnë pritshmëritë e performancës individëve dhe ekipeve; 3) të masin performancën aktuale, krahasuar me performancën e synuar; dhe 4) të japin vazhdimisht mendime dhe shpërblime për performancën e mirë. BNJ mbështesin drejtuesit duke ofruar aktivitete dhe programe që lehtësojnë këtë proces. Është e rëndësishme që procesi i menaxhimit të performancës të kryhet mbi kritere objektive, jo vetëm mbi realizimin e planit të mbledhjes së të ardhurave, i cili mund të ndikohet edhe nga faktorë të jashtëm që janë përtej ndikimit të administratës tatimore. Në këtë kontekst, planifikimi real i të ardhurave luan një rol të rëndësishëm.

iv. Planifikimi i buxhetit

Buxhetimi është procesi i alokimit të burimeve financiare të kufizuara për të ofruar shërbime që plotësojnë nevojat e qytetarëve/taksapaguesve. Përgatitja e buxhetit është kritike për ATV. Për ta kryer këtë detyrë në mënyrë efektive dhe eficiente, administrata tatimore ka nevojë për personel, pajisje dhe mjedise të përshtatshme.

Në procesin e planifikimit të buxhetit, parashikimi i të ardhurave të veta, e kryesisht nga taksat e tarifave vendore, ka një rëndësi të veçantë. NJVV përgjithësisht bëjnë parashikimin, duke u mbështetur në një sërë faktorësh: norma mesatare e "rritjes" së të ardhurave në periudhën më të fundit prej 3-5 vjetësh, norma zyrtare e inflacionit dhe një shkallë e caktuar që lidhet me përmirësimet e pritshme në administrim. Për të arritur në një planifikim sa më real të të ardhurave, zyrtarët vendorë, në gjykimin e tyre më të mirë, vlerësojnë ndryshimet e mundshme në politikën fiskale në nivel qendror që ndikojnë ato në nivel vendor; analizojnë nivelin e mbledhjes, realizimin faktik dhe prirjen e të ardhurave, rreziqet e mundshme në mosrealizimin e të ardhurave dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve. Sigurimi i

një baze të mirë të dhënash për taksapaguesit vendorë, i lejon NJVV të bëjnë një parashikim të kujdesshëm e të përgjegjshëm të potencialit të të ardhurave që mund të mblidhen në një vit fiskal. Për planifikimin e tarifave vendore të shërbimit, është e rëndësishme që, gjatë planifikimit, të mblidhen informacione mbi kostot e pritshme të shërbimit dhe lidhja e masës së tarifës me nivelin dhe cilësinë e shërbimit që merr çdo taksapagues. Planifikimi i të ardhurave për taksat e tarifatat duhet të kryhet nga administrata tatimore dhe zyrat e buxhetit të NJVV, në bashkëpunim me zyrat përkatëse teknike të shërbimit (p.sh., struktura përgjegjëse për shërbimet në lidhje me tarifën e pastrimit, apo zyra e urbanistikës në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë).

Ndër burimet kryesore të informimit për bazën e të dhënave të taksapaguesve vendorë, është Qendra Kombëtare e Biznesit për kategorinë biznes dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për kategorinë familje. Në mënyrë më specifike, për taksën e ndërtesës, informacioni bazë mblidhet nga ASHK (ZRPP, ALUIZNI) dhe çdo regjistër tjetër publik që zotëron të dhëna të dobishme. Kadastra Qendrore Fiskale (në ndërtim e sipër), është konceptuar të sigurojë bazën e saktë të të dhënave për taksën e pasurisë së paluajtshme për NJVV. I gjithë ky informacion bazë, i përditësuar me verifikimet në terren, u jep mundësinë administratave tatimore vendore të koordinojnë veprimet e tyre për rritjen e numrit të taksapaguesve dhe përmirësimin e pajtueshmërisë së tyre me legjislacionin e taksimit vendor.

Planifikimi strategjik është një mekanizëm menaxherial, që përdoret për shpërndarjen e burimeve dhe për të siguruar vëmendje në aktivitetet më kryesore, si dhe matjen e arritjeve që çojnë në realizimin e misionit të administratës tatimore.

Procesi i planifikimit strategjik kërkon që ATV të përcaktojë se ku dëshiron të jetë, të identifikojë problemet/sfidat dhe qëllimet kryesore, si dhe mënyrat për realizimin e këtyre qëllimeve.

Ky planifikim ndihmon të fokusojë të gjitha burimet dhe përpjekjet e administratës dhe t'i orientojë ato drejt të njëjtit qëllim. Produkti përfundimtar i këtij procesi planifikimi janë një sërë vendimesh bashkërenduese mbi objektivat/qëllimin se çfarë të bëjmë, nëpërmjet një sërë veprimesh dhe projeksimesh rreth qasjes e mënyrës se si ta realizojmë.

5. Identifikimi i taksapaguesve

5.1 Personat juridikë dhe fizikë

Çdo entitet që kryen veprimtari ekonomike-tregtare ka detyrimin që, përpara se të fillojë veprimtarinë ekonomike, të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Me përmbushjen e kësaj procedure, brenda të njëjtës ditë, QKB ka detyrimin të informojë çdo autoritet tatimor vendor për regjistrimin e subjekteve të reja tregtare, selia apo adresa sekondare e të cilave gjendet në juridiksionin territorial të NJVV, duke përfshirë informacionin në lidhje me emrin, NUIS (Numrin Unik të Identifikimit) e caktuar dhe parashikimin e xhiros vjetore.

Përgjithësisht, Administrata Tatimore Vendore (ATV) mund të kërkojë që taksapaguesit të japin informacione dhe të dhëna të mëtejshme në lidhje me aktivitetin e biznesit, që i mundësojnë njësisë së administratës vendore të vlerësojë garancitë e përmbushjes së detyrimeve të taksapaguesit. Për shembull, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore e bashkisë Tiranë kërkon një listë minimale dokumentesh për plotësimin e dosjes së çdo taksapaguesi, por mospërmbushja e këtyre kërkesave nuk e pengon taksapaguesin të vazhdojë me pagesat e taksave. Taksapaguesve nuk duhet t'u kërkohej të japin informacione të tepërta, të cilat nuk do të përdoren në të ardhmen.

Procesi unik i regjistrimit përmes QKB i jep administratës tatimore një pasqyrë të plotë të taksave potencialisht të arkëtueshme, redukton kostot e përputhshmërisë dhe bën të mundur mbajtjen e një bazë të dhënash efektive regjistrimi.

Sistemi unik i regjistrimit zvogëlon shpenzimet për të gjitha palët e përfshira dhe mundëson një pamje të plotë e të integruar të bazës së tatueshme. Megjithatë, procesi unik i regjistrimit nuk është gjithmonë i mundur, si në rastin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme, ku kërkohen informacione shtesë, siç janë informacioni mbi emrin, adresën dhe vlerën e pronës. Një databazë e veçantë e taksapaguesve po ngrihet nga qeveria e Shqipërisë (kadastra fiskale). Kadastra fiskale është një regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme që shërben për hedhjen, përpunimin, rregullimin e të dhënave në lidhje me pasuritë e paluajtshme/ ndërtesë për efekt të llogaritjes së detyrimeve të secilit taksapagues në lidhje me

taksën mbi pasurinë e paluajtshme. Ky regjistër do të ofrojë informacion të plotë për çdonjërin nga NJVV për administrimin e taksës mbi ndërtesat.

ATV duhet të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme edhe me regjistrin e mbajtur nga Administrata Tatimore Qendrore (ATQ). Në regjistrin e mbajtur nga ATQ regjistrohen persona juridikë, fizikë dhe institucione e individë si më poshtë¹:

- Persona fizikë e juridikë;
- Organizata jofitimprurëse;
- Përfaqësi e ambasada të huaja, entet publike kombëtare apo vendore, njësi të zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm me to;
- Shitës ambulante;
- Kryefamiljari që punëson individë;
- Fermeri.

Megjithatë regjistrat e mbajtur nga secila administratë tatimore, qendrore dhe vendore, ende nuk janë të integruar me njëri-tjetrin, mbetet përgjegjësi e ATV të përditësojë bazën e saj të të dhënave, duke seleksionuar dhe përfshirë në regjistrin e saj të taksapaguesve vetëm personat dhe individët nga lista e përmendur më sipër, që kanë detyrimin të paguajnë taksa dhe tarifa vendore në bashkitë apo NJVV në të cilat janë të vendosur.

5.2 Rregulla të veçanta për regjistrimin e taksapaguesit individ

Identifikimi fillestar i taksapaguesve familjarë/rezidentë bëhet në bazë të Regjistrit të Gjendjes Civile (RGJC). Informacioni i marrë nga RGJC, i kombinuar me verifikimet në terren si dhe me çdo burim tjetër të mundshëm informacioni nga regjistra të tjerë publikë, krijon bazën për regjistrin e taksapaguesve individë/familjarë ose rezidentë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në mënyrë specifike, për taksat mbi pasuritë e paluajtshme rëndësi të veçantë ka regjistri i ASHK/ZRPP, ALUIZNI, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe/ose regjistrat e kadastrës bujqësore, PPV për truallin urban, OSHEE etj., siç sqarohet me hollësi në kapitullin kushtuar këtyre taksave. Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve, si agjent tatimor (në rastet kur aplikohet), luan një rol të

¹ Neni 40, Ligj 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar.

rëndësishëm në mbledhjen/arkëtimin e detyrimeve vendore nga kjo kategori.

Përdorimi i automatizimit është i domosdoshëm për të krijuar dhe mbajtur një databazë efektive. Automatizimi redukton po ashtu kostot e përputhshmërisë si për administratën tatimore, ashtu edhe për taksapaguesit, përmes reduktimit të ndjeshëm të kohës së përpunimit dhe procedurave më efikase.

6. Procedurat e zbatueshme për mbledhjen e detyrimeve tatimore

6.1 Deklarimi, vlerësimi dhe njoftimi tatimor

Një aspekt tepër i rëndësishëm i punës së administratës tatimore në nivel vendor lidhet me zbatimin e përpiktë dhe respektimin e procedurave tatimore, të cilat bazohen në dispozitat e Ligjit 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimit të ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore".

Dispozitat e mësipërme ligjore përcaktojnë hapat që ndiqen gjatë procedurave të zbatueshme për detyrimet tatimore. Këta hapa proceduralë detajohen si në vijim:

a. Deklarimi nga taksapaguesi

Kur legjislacioni tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, taksapaguesi duhet të bëjë vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin apo kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan atë brenda afatit ligjor. Në këto raste, deklarata e tij konsiderohet si vetëvlerësim tatimor. Në rastin e njërive të vetëqeverisjes vendore, në kohën e botimit të këtij Manuali nuk ka detyrim për vetëvlerësim tatimor për taksat e tarifave vendore, përveç rasteve në vijim. Taksapaguesit individë e biznese kanë detyrimin të vetëdeklarojnë të dhënat për taksën mbi pasurinë e paluajtshme, e cila përfshin taksën mbi truallin, tokën bujqësore dhe atë mbi ndërtesat, për qëllim të përlllogaritjes së kësaj takse¹, si dhe, në raste të caktuara, detyrimin për vetëdeklarimin e të dhënave të lidhura me biznesin (p.sh., në rastin e zënies së hapësirës publike apo tabelave të reklamës).

Për sa u përket taksave vendore, vetëdeklarimi zbatohet në rastin e taksës mbi truallin dhe tokën bujqësore në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe në rastin e taksës mbi

¹ Shih Seksionin 9.

ndërtesat sipas VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës". Sipas këtyre parashikimeve, çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë, truall apo tokë bujqësore. Vetëdeklarimi duhet të bëhet pranë NJVV apo çdo institucioni të autorizuar prej tyre.

Është kompetencë e këshillave të njësive vendore, që të përcaktojnë mënyrën e mbledhjes, përfshirë afatet e vetëdeklarimit dhe pagesës së taksës, së bashku me numrin e kësteve, si dhe kushtet lehtësuese, në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve.

Deklarata tatimore që duhet dorëzuar nga taksapaguesi, bazohet te formatet dhe modelet standarde të miratuara me udhëzim të ministrit të Financave, të cilat vihen në dispozicion të publikut dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore.

Taksapaguesi e dorëzon deklaratën tatimore nëpërmjet postës, në mënyrë elektronike, nëpërmjet bankës apo një institucioni tjetër financiar.

b. Vlerësimi tatimor

Pas marrjes së vetëdeklarimit, në rastet kur kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi apo në mënyrë periodike për vlerësimet tatimore për të cilat nuk është i nevojshëm vetëdeklarimi nga taksapaguesi, administrata tatimore vendore bën përlllogaritjen e detyrimit. Kjo përlllogaritje duhet të kryhet brenda afateve të përcaktuara nëpërmjet rregulloreve të brendshme nga ana e NJVV, të cilat duhet të garantojnë përfundimin e procesit të vlerësimit në një periudhë kohore e cila garanton lënien e një kohe të mjaftueshme deri në afatin përfundimtar të pagesës, duke përfshirë afatet e ndërmjetme të dërgimit të njoftimit të vlerësimit tatimor, si dhe ushtrimin të së drejtës për ankim nga taksapaguesit, siç shpjegohet në shkronjën c., në vijim.

Kur administrata tatimore konstaton se detyrimi tatimor i dhënë në vetëdeklarim, është i pasaktë ose taksapaguesi nuk ka kryer vetëdeklarim, ajo bën vlerësimin e detyrimit tatimor bazuar në të dhënat që kjo e fundit disponon në bazë të rezultateve të verifikimeve në terren dhe nëpërmjet përdorimit të mënyrave alternative të vlerësimit të parashikuara nga ligji për procedurat tatimore, ligji për sistemin e taksave vendore dhe nga VKM Nr. 132 në rastin e taksës mbi ndërtesat.

Përdorimi i metodave alternative për vlerësimin e detyrimit apo rishikimet e llogaritjeve fillestare të detyrimeve mund të kryhen kurdo që ATV siguron të dhëna, të cilat ndikojnë në llogaritjen e detyrimit tatimor.

Në rastet e rishikimit të detyrimit tatimor që i është njoftuar më parë taksapaguesit, rillogaritja e detyrimit kryhet vetëm për periudhat apo pjesën e vitit që pason datën e aktit të konstatimit të ndryshimit në të dhënat fillestare të përdorura për llogaritjen e detyrimit.

Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit, administrata tatimore i dërgon taksapaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor.

Për sa u përket afateve procedurale, konsiderohet se vlerësimi i kryer nga administrata tatimore hyn në fuqi 10 ditë kalendarike pas datës, kur njoftimi i vlerësimit tatimor dhe i kërkesës për të paguar vlerësohet të jetë marrë, siç përcaktohet në pjesën në vijim rreth njoftimit të vlerësimit tatimor.

c. Njoftimi i vlerësimit tatimor

Dërgimi i njoftimit tatimor rezulton të jetë kusht paraprak i rëndësishëm për përmbushjen e procedurave tatimore, për të bërë të mundur njoftimin në kohë të taksapaguesit për detyrimet e tij fiskale, duke lehtësuar pagesën në kohë apo ushtrimin e të drejtave të tij për rivlerësim apo ankim. Mospërmbushja e detyrimit të administratës tatimore për dërgimin e rregullt të njoftimit, rezulton shkelje e të drejtave të taksapaguesve dhe ndërlikon procedurat e pagesave të taksave. Po kështu, njoftimi i bërë në mënyrë të parregullt, pengon edhe ushtrimin në kohë të së drejtës së ankimit nga ana e taksapaguesve.

Në lidhje me mënyrën e kryerjes së njoftimit, legjislacioni i ofron administratës tatimore një mekanizëm lehtësues, krahasuar me metodat tradicionale të njoftimit, të parashikuara në procedurat e tjera, si p.sh., sipas Kodit të Procedurës Civile apo Kodit të Procedurave Administrative. Kjo pasi ligji për procedurat tatimore në rastet kur administrata respekton tërësinë e elementeve informuese të njoftimeve dhe procedurën e dërgimit të tyre, përcakton prezumimin e marrjes dijeni nga ana e taksapaguesve. Bazuar në dispozitat ligjore, vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare që administrata tatimore u dërgon taksapaguesve parashikohen të merren nga taksapaguesi jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e dërgimit të mesazhit elektronik dhe postës rekomande¹.

Për sa i përket komunikimit të njoftimit të vlerësimit tatimor dhe kërkesës për

¹ Ligji 9920, i ndryshuar; Neni 69, paragrafi 1, i cili u referohet parashikimeve të pikës 3, të nenit 23 dhe nenit 69, pika 4,

pagesën e detyrimit tatimor, legjislacioni përcakton se ai mund të kryhet ose në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike, kur taksapaguesit kanë dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike, ose nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

Bazuar në dispozitat ligjore, njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën duhet të përmbajë detyrimisht të paktën informacionin si më poshtë:

- Emrin dhe mbiemrin e taksapaguesit person fizik, ose emrin e personit juridik;
- Numrin e identifikimit të taksapaguesit;
- Datën e njoftimit;
- Çështjen për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat tatimore, që u referohet njoftimi;
- Shumën e detyrimit (tatimit/taksës/tarifës) të vlerësuar dhe, nëse ka, uljen e humbjes tatimore, uljen e kredisë tatimore, kamatëvonesën, gjobat;
- Afatin e pagesës së detyrimit tatimor;
- Vendin dhe mënyrën e pagesës së tatimit;
- Shpjegimin e arsyes së vlerësimit;
- Shpjegimin e së drejtës së taksapaguesit për të ankimuar vlerësimin.

Pra, nuk mjafton vetëm që administrata tatimore të njoftojë taksapaguesit. Duhet që njoftimi, jo vetëm të bëhet sipas procedurave korrekte, siç u shpjegua më sipër, por edhe të jetë i plotë, duke pasur në brendësi të tij të paktën elementet e informacionit minimal të kërkuar nga ligji. Këto procedura në lidhje me njoftimin tatimor, vlejné dhe zbatohen jo vetëm kundrejt bizneseve, por edhe për taksapaguesit individë ose familjarë.

Siç u përmend më sipër, kryerja e rregullt e njoftimeve nga ana e administratës tatimore, lidhet ngushtësisht edhe me ushtrimin e mundshëm nga ana e taksapaguesve të së drejtës së ankimit. Legjislacioni parashikon se personi i tatueshëm, që nuk është dakord me njoftimin e vlerësimit tatimor, ka të drejtë ta ankimojë atë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit.

Njoftimet e detyrimeve vjetore duhet t'u dërgohen taksapaguesve biznese dhe individëve në fillim të çdo periudhe tatimore dhe duhet të përmbajnë informacione në lidhje me detyrimet e tyre tatimore¹ dhe mënyrën e përlllogaritjes për secilin detyrim. Për më tepër, njoftim-detyrimi duhet të përmbajë informacion mbi mënyrat e pagesës, afatet, si dhe mënyrat e ankimit të vlerësimit tatimor, siç përshkruhet me hollësi në vijim.

¹ Zakonisht, në fillim të çdo viti kalendarik.

Për bizneset, vlerësimet tatimore bazohen në vendndodhjen, llojin e biznesit dhe xhiron vjetore të tij. Zakonisht detyrimi vjetor për bizneset parapaguhet brenda gjashtëmuorit të parë të secilit vit për pjesën më të madhe të detyrimeve, megjithëse këshillat bashkiakë kanë diskrecion të plotë për përcaktimin e afateve alternative të pagesës. Është e këshillueshme që taksapaguesve t'u ofrohen mënyra të ndryshme pagese, për ta lehtësuar atë, për shembull përmes bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, në sportelet e Postës, pranë operatorëve financiarë si Easy Pay, Unioni Financiar dhe AK Invest, dhe përmes portalit qeveritar e-Albania për taksapaguesit që zotërojnë një kartë debiti/krediti, brenda apo edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Njoftimi i detyrimeve duhet të kryhet edhe për taksapaguesit individë (familjarë), duke përfshirë informacion të ngjashëm me atë për bizneset, pra informacion për detyrimet për taksat dhe tarifat vendore; mënyrën e përlogaritjes së tyre (bazën ose shkallën e taksës/tarifës, si baza e detyrimit tatimor të gjeneruar); afatet dhe format e pagesës, si edhe përshkrimin e të drejtës së tyre për ankim dhe procesin përkatës. Njoftim-detyrimi duhet t'u dërgohet taksapaguesve individë/familjarë në fillim të periudhës tatimore, edhe në rastet kur bashkia përdor një agjent tatimor, si p.sh., shoqëria e ujësjellësit dhe kanalizimeve vendore, rast në të cilin taksat vendore llogariten dhe përfshihen në faturën mujore të shoqërisë së ujësjellësit dhe kanalizimeve. Në këto raste, bashkia mund të dërgojë një njoftim detyrimi përmbledhës për detyrimet specifike të çdo taksapaguesi familjar, së bashku me faturën e parë të ujësjellës kanalizimeve për vitin përkatës (periudhën tatimore).

Pagesat e faturave të taksave vendore të administruara nga një agjent tatimor mund të bëhen gjithashtu në bankat e nivelit të dytë, ose në sportelet e vendosura në dispozicion nga shoqëria që vepron si agjent tatimor. Është e rëndësishme që faturat e lëshuara nga ujësjellësi, apo ndonjë agjent tjetër tatimor, të reflektojnë edhe të drejtën e ankimit edhe për taksat vendore, përveç të drejtës së ankimit p.sh., për tarifën e ujit, në rastin e agjentit UK. Kjo mund të kërkojë një rishikim të lehtë të formateve dhe përmbajtjes së faturave të agjentit tatimor, që duhet të negociohet nga bashkia me agjentin e saj tatimor.

Praktikat e mira kërkojnë edhe që bashkia të publikojë në faqen e saj të internetit, apo edhe në media të tjera, përmbledhje të hollësishme të detyrimeve të qytetarëve dhe bizneseve për taksat dhe tarifat vendore. Ky informacion nuk duhet të kufizohet vetëm me publikimin e paketave fiskale, që gati gjithmonë është një informacion i ndërlikuar për qytetarin tipik; por duhet të jetë i përshtatur për kategori të ndryshme biznesesh/qytetarësh dhe i shpjeguar në mënyrë të thjeshtuar, por të plotë.

RAST STUDIMOR

NJOFTIMI I DETYRIMEVE

Shënim: Rasti konkret është gjykuar në të tri shkallët e gjyqësorit dhe, në përfundim, vendimi i mësipërm është konsideruar i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj, duke mbetur në fuqi.

Situata faktike:

Shoqëria A zhvillon aktivitet në tri fshatra të bashkisë B.

Me herët, përpara reformës administrative territoriale, këto fshatra ishin pjesë e tri komunave të ndryshme.

Bashkia B, në vitin 2018, përpara se t'i njoftonte detyrimet vendore shoqërisë A, konstaton se kjo e fundit nuk ka paguar taksën e tabelës dhe tarifën e pastrimit për të tri ish-komunat për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Nuk ka prova që dëshmojnë se këto detyrime i janë njoftuar shoqërisë A nga ana e secilës prej ish-komunave.

Bashkia B i përfshin këto detyrime në njoftim-vlerësimin për detyrimet vendore për vitin 2018, pa i specifikuar vlerat veçanërisht, si dhe aplikon gjobë për vonesë në pagesë, sërish pa specifikuar si është përlllogaritur kjo e fundit.

Shoqëria A ankimon në gjykatë detyrimet e vendosura nga bashkia A në lidhje me detyrimet e viteve 2013, 2014 dhe 2015.

Pyetje:

A mund të përfshihen detyrime të periudhave të mëhershme në njoftim-vlerësimin për vitin aktual?

Nëse po, çfarë përshkrimi nevojitet të bëhet për këto zëra?

Nëse njoftim-vlerësimet e periudhave me herët janë njoftuar por nuk janë paguar, mund të përfshihen në njoftim-vlerësimin aktual apo përdoren mekanizma të tjerë?

Nëse ish-komunat nuk kanë nxjerrë njoftim-vlerësime për vitet 2013-2015, si duhet të veprojë bashkia Y për të bërë mbledhjen e tyre?

Çfarë ndodh me detyrimet që nuk kanë filluar brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor duhej të paguhej?

Vendimi i gjykatës

Si rezultat i ushtrimit të së drejtës së ankimit nga ana e taksapaguesit, në përfundim të procesit gjyqësor vendosi:

“Pranimin e padisë së paraqitur dhe shfuqizimin e aktit administrativ lidhur me detyrimin për tarifat dhe taksat vendore, si i pabazuar në prova dhe në ligj, duke i ngarkuar bashkisë B edhe shpenzimet gjyqësore.”

Elementet më të rëndësishme ku u bazua ky vendim gjyqësor ishin:

Bashkia, e cila mbart barrën e provës, nuk arriti të provonte se taksapaguesi ishte njoftuar në përputhje me ligjin, pasi njoftimet nuk i ishin dërguar taksapaguesit;

Mosdërgimi i njoftimit cenon interesat e taksapaguesve dhe i pengon ata në ushtrimin e së drejtës së ankimit;

Nuk mund të aplikohet asnjë gjobë për vonesë, përderisa nuk është njoftuar rregullisht detyrimi;

Edhe nëse një subjekt ka detyrime të prapambetura nga vitet e mëparshme, ato duhet të identifikohen qartë dhe veçmas për secilin vit, i konsideruar nga ligji si periudhë tatimore. Njoftimi duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara nga ligji;

Në përputhje me dispozitat e nenit 109 të Kodit të Procedurës Administrative, një akt administrativ konsiderohet i paligjshëm, midis të tjerash, nëse është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative apo kur është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ.

Pra, hapat që duhet të ndjekë administrata për kërkimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore, sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni për procedurat tatimore (rikujtojmë se bashkitë mund të miratojnë procedura, rregulla dhe afate të ndryshme, më favorizuese për taksapaguesit), detajohen si vijon:

1. Vetëdeklarim nga taksapaguesi: Në rastet kur kërkohet nga legjislacioni i taksave vendore (si p.sh., për taksën mbi pasurinë e paluajtshme) dhe brenda afateve të përcaktuara nga NJVV, taksapaguesi kryen vetëdeklarimin e të dhënave dhe e dorëzon atë tek administrata tatimore;

2. Vlerësim tatimor: Kryhet nga administrata tatimore në rastet kur (i)

taksapaguesi nuk ka detyrim vetëdeklarimi, (ii) në bazë të të dhënave të vetëdeklaruar nga taksapaguesi, kur ekziston ky detyrim, për efekt verifikimi saktësie, por edhe kur (iii) nuk është dorëzuar vetëdeklarim nga taksapaguesi (vlerësim alternativ);

3. Dërgim i njoftimit të vlerësimit tatimor te taksapaguesi: Kryhet brenda 10 ditëve nga data e vlerësimit tatimor prej administratës tatimore;¹

4. Marrja në djeni e njoftimit të vlerësimit tatimor nga taksapaguesi: Njoftimi konsiderohet si i marrë nga taksapaguesi dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të pranimit të dokumentit nga shërbimi postar, kur dërgohet nëpërmjet postës rekomande;

5. Hyrja në fuqi e vlerësimit tatimor: Vlerësimi tatimor hyn në fuqi dhjetë ditë kalendarike pas datës, kur njoftimi i vlerësimit tatimor dhe i kërkesës për të paguar mendohet të jetë marrë;

6. Afati kohor për ankimin e taksapaguesve: Administrata tatimore nuk mund të mbledhë detyrimin, pa pritur përfundimin e afatit kohor për ankimin e mundshëm të taksapaguesve, përveçse nëse ai paguhet gjatë kësaj periudhe nga vetë taksapaguesi.

- **Ankimi administrativ:** Nëse nuk bie dakord me vlerësimin tatimor, taksapaguesi mund ta ankimojë atë te Struktura Vendore e Apelimit, brenda tri ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit, ose të vlerësuar si të jetë marrë; Meqenëse ankimi mund të paraqitet edhe nëpërmjet postës, administrata këshillohet që këtij afati duhet t'i shtojë edhe kohën e nevojshme për mbërritjen e ankimeve (zakonisht 2-3 ditë); Nëse taksapaguesi ka paraqitur ankim administrativ, administrata duhet të presë rezultatet e ankimit, të cilat i njoftohen nga Struktura Vendore e Apelimit. Në rast pranimi të ankimit, administrata vepron në përputhje me vendimin e pranimit të ankimit administrativ.
- **Ankimi gjyqësor:** Në rast se ankimi administrativ i shqyrtuar nga SVAATV nuk e pranon ankimin e taksapaguesit, ky ka të drejtën e paraqitjes së ankimit gjyqësor. Në këtë rast, administrata tatimore duhet të presë përfundimin e

¹ Ose, në rastet e atyre taksave apo tarifave vendore për të cilat nuk kërkohet vetëdeklarim, pra për shumicën e taksave dhe tarifave vendore për familjarët dhe bizneset, njoftimi i vlerësimit tatimor duhet dërguar te taksapaguesit nga administrata tatimore në fillim të çdo periudhe tatimore. Përfundim nga ky rregull përbëjnë detyrimi për vetëdeklarimin e të dhënave për taksën e ndërtesës nga individët dhe personat fizikë e juridikë në vitin e parë të zbatimit të saj mbi bazë vlere (dhe çdo ndryshim i mëtejshëm); si dhe detyrimi për deklarim i bizneseve në momentin e regjistrimit apo ndryshimit të karakteristikave.

afatit kohor për paraqitjen e ankimit gjyqësor, i cili është 30 ditë nga marrja dijani e vendimit mbi ankimin administrativ. Ankimi gjyqësor i njoftohet administratës nga gjykata që shqyrton çështjen. Në rast të vijimit të ankimit administrativ, administrata tatimore duhet të presë derisa vendimi gjyqësor të ketë marrë formë të prerë;

Në të gjitha këto raste, administrata tatimore vijon procedurat e mbledhjes së detyrimeve, nëse ankimi tërhiqet nga taksapaguesi, apo nuk pranohet nga SVA ose gjykata.

7. Njoftimi i kërkesës për pagesë: Në rast se taksapaguesi nuk ka ankimuar vlerësimin tatimor, apo kanë përfunduar procedurat e ankimit administrativ dhe/ose gjyqësor, administrata i dërgon atij kërkesën për pagesë, duke i treguar afatin kohor për kryerjen e pagesës. Edhe në këtë rast zbatohen afatet e njoftimit të vlerësimit tatimor dhe të prezumimit të marrjes dijani;

8. Fillimi i procedurave të mbledhjes me forcë: Në rast se edhe pas përfundimit të afatit kohor, të treguar në kërkesën për pagesë, taksapaguesi nuk ka paguar detyrimin tatimor, nuk e ka ankimuar këtë akt, apo kanë përfunduar procedurat e ankimit administrativ dhe/ose gjyqësor, atëherë administrata fillon procedurat e mbledhjes me forcë, duke përdorur njërin ose disa prej mënyrave, të parashikuara në kapitullin e mbledhjes me forcë sipas parashikimeve të ligjit për procedurat tatimore, siç specifikohet në vijim, në seksionin 8. Procedurat e mbledhjes me forcë fillojnë me dërgimin të taksapaguesi të Njoftimit dhe Kërkesës për Pagesën e Detyrimit, duke i bërë me dije këtë të fundit afatin kohor për kryerjen e pagesës. Edhe në këtë rast zbatohen afatet e njoftimit të vlerësimit tatimor dhe të prezumimit të marrjes dijani.

7. Apelimi tatimor

7.1 Procedura e apelimit administrativ në nivel vendor

Procedura e ankimit në lidhje me taksat vendore ka pësuar disa ndryshime të rëndësishme si pasojë e paketës fiskale të vitit 2018, në veçanti Ligji 106/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime ligjore në Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’”.

Sipas këtyre parashikimeve, e drejta e ankimit të taksapaguesve është një prej elementeve të administrimit fiskal nga ana e pushtetit vendor, e cila, në zbatim të parimit të autonomisë vendore, përcaktohet nga vetë pushteti vendor, më saktë nga këshilli bashkiak.

Ankimi bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kriterëve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak. Këshilli bashkiak duhet të përcaktojë në rregulloren e ankimit të paktën elementet e mëposhtme:

- Afatin e ankimit;
- Mënyrat e paraqitjes së ankimit;
- Dokumentacionin që shoqëron ankimin;
- Kushtet paraprake të pranimit të ankimit (p.sh. pagesa paraprake e detyrimit);
- Mënyrën e krijimit të Strukturës Vendore të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore (SVAATTV);
- Përbërjen, kuorumin dhe vendimmarrjen e SVAATTV;
- Procedurën e shqyrtimit të apelimeve;
- Afatin maksimal për vlerësimin e ankimeve;
- Formën dhe përmbajtjen e vendimeve të SVAATTV;
- Mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të SVAATTV.

Gjatë procesit të hartimit të kësaj rregulloreje nga ana e pushtetit vendor, si elemente udhëzuese për përmbajtjen e saj, duhen konsideruar dhe duhen marrë parasysh rregullat e përgjithshme të legjislacionit, sidomos dispozitat e ligjit

për procedurat tatimore (Ligji 9920), Kodit të Procedurave Administrative (Ligji 44/2015) dhe legjisllacionit të zbatueshëm për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore (Ligj 8480).

Në përputhje me nenin 5 dhe 7 të ligjit, këshillat bashkiakë miratojnë Strukturat Vendore të Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tarifave Vendore, procedurat, kriteret dhe rregullat e ankimit. Strukturat mund të ndryshojnë gjerësisht nga një bashki në tjetrën¹. Sot, rreth gjysma e bashkive kanë një strukturë/njësi kushtuar ankimeve administrative tatimore. Kjo strukturë, në nivel organizativ, mund të jetë një njësi e përhershme (drejtori, komision), ose një strukturë e ngritur *ad hoc*, sa herë që ka ankime administrative tatimore.

Ankimi mund të bëhet nga vetë taksapaguesi apo nga përfaqësuesi i tij dhe mund të përfshijë apelimin e disa vendimeve administrative në të njëjtën procedurë. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankimit, Struktura Vendore e Apelimit ka të drejtë të grupojë së bashku disa ankime të ngjashme, me qëllim maksimizimin e efikasitetit në procedurën e ankimit.

Aktet e Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, që rezultojnë nga procedura e ankimit, nuk mund të jenë më objekt ankimi administrativ. Këto vendime mund të ankimohen në gjykatë.

Përrjashtimisht, procedura e ankimit në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që mbledhet nga administrata tatimore qendrore, rregullohet nga dispozitat specifike të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Në këtë rast, ankimi duhet paraqitur te Drejtoria e Apelimit Tatimor ose te Komisioni për Shqyrtimin e Apelimit Tatimor, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Parakusht për pranimin e ankimit është pagesa e plotë e detyrimit tatimor të kundërshtuar. Vendimet e organeve të apelimit duhet të jenë të arsyetuara dhe mund të kundërshtohen në gjykatën administrative kompetente brenda 30 ditëve nga data e vendimit, ose brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit, nëse organet shtetërore kompetente nuk kanë shprehur asnjë vendim.

¹ Shih pikën 8.5.

7.2 Objekti i ankimit administrativ

Sipas nenit 7 të Ligjit “Për sistemin e taksave vendore”, taksapaguesi ka të drejtë të ankimojë kundër:

- Çdo akti administrativ të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Çdo veprimi apo mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

- Që ka të bëjë me taksapaguesin; dhe,
- Ndikon në detyrimin e tij të taksave dhe tarifave vendore.

Akte administrative konsiderohen të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, që sjellin efekte financiare dhe/ose ligjore për çdo taksapagues individualisht.

Vendimet administrative që mund të ankimohen përfshijnë çdo njoftim vlerësimi apo akt tjetër administrativ, që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit, përfshirë llogaritjen e gjobave dhe/ose gabimet në llogaritjen kamatëvonesës.

Ankimi mund të bëhet edhe kundër një mosveprimi, domethënë një mosveprimi të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore që ndikon në detyrimin tatimor të taksapaguesit (p.sh., një akt që nuk është miratuar nga njësisia e vetëqeverisjes vendore ose Këshilli Bashkiak brenda periudhës së përcaktuar në ligj, pavarësisht nëse taksapaguesi ka bërë kërkesë në lidhje me të).

Aktet që nuk mund të ankimohen pranë Strukturës Vendore të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë:

- Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore, që nuk ndikojnë në detyrimin tatimor vendor të taksapaguesit;
- Aktet, vendimet, veprimet apo mosveprimet e administratës tatimore vendore, që shkelin të drejtat e taksapaguesve sipas Ligjit “Për procedurat tatimore”; për taksat dhe procedurat që administrohen nga administrata tatimore qendrore;
- Masat administrative të mbledhjes me forcë të detyrimeve.

Në përputhje me parashikimin e nenit 92, kreu XI i Ligjit “Për procedurat tatimore”, masat administrative të parashikuara aty dhe në krerë të tjerë të këtij ligji, që kanë

të bëjnë me masat e mbledhjes me forcë, nuk janë objekt apelimi administrativ pranë Strukturës Vendore të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Megjithatë, taksapaguesi, ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë në formën e barrës siguroese apo hipotekare, ka të drejtë të paraqesë ankesë te drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo te drejtuesi më i lartë i Zyrës së Taksave Vendore sipas organizimit të NJVV, jo për arsye që lidhen me vlerësimin e detyrimit, por për arsye që lidhen me procedurën, pra në ato raste kur zbatimi i masave të sigurisë nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt. Ekzekutimi i vendimit për marrjen e masave të sigurisë nuk është kryer në rregull në rastet kur:

- a. Taksapaguesi nuk ka pasur njoftim të rregullt për sigurimin e detyrimit tatimor, brenda afateve kohore të parashikuara nga Ligji "Për procedurat tatimore";
- b. Gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij, detyrimi tatimor vendor është paguar;
- c. Pasuria e vendosur si barrë siguroese apo hipotekare, është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk lejohet ekzekutimi sipas nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile;
- d. Akti me anë të të cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin e mbledhjes me forcë të taksave dhe tarifave vendore ka dalë jo në emër të taksapaguesit, por kundrejt një personi tjetër.

7.3 Dorëzimi i ankimit administrativ tatimor vendor

7.3.1 Kriteret formale

Ankimi duhet të bëhet sipas rregullave, kriterëve dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me rregullore nga Këshilli Bashkiak. Gjatë hartimit të kësaj rregulloreje duhet pasur parasysh që bashkitë mund të aplikojnë rregulla, kriterë dhe afate më të favorshme se ato të specifikuar nga ligji për procedurat tatimore, por jo rregulla më të rrepta apo afate më të shkurtra se ato të përcaktuara nga ky ligj. Në mungesë të miratimit të kësaj rregulloreje, administrata tatimore vendore duhet të zbatojë të paktën rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga ligji për procedurat tatimore dhe nga Kodi i Procedurave Administrative, i cili përcakton si

afat periudhën e tridhjetë ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë.

Aktet administrative tatimore dhe çdo korrespondencë që i dërgohet taksapaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik, në rastet kur taksapaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e komunikimit në rrugë elektronike, apo të pranimit të postës rekomande nga shërbimi postar. Në llogaritjen e afateve nuk përfshihet dita kur del akti; llogaritja e afatit bëhet një ditë pasi akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi. Në rastet kur dita e fundit e afatit bie ditë pushimi apo festë zyrtare, ai shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

Në qoftë se, në kundërshtim me ligjin, në aktin administrativ mungon njoftimi që informon taksapaguesin për të drejtën e tij për të ankimuar aktin administrativ, përfshirë afatin dhe hallkën e apelimit, taksapaguesi mund të ankimojë brenda tre muajve nga data kur akti administrativ është marrë, ose konsiderohet të jetë marrë prej tij.

Në rast mosveprimi nga ana e administratës tatimore (refuzimi për të nxjerrë një akt), procedura e ankimit fillon tre muaj pas ditës së dorëzimit të kërkesës fillestare për nxjerrjen e aktit administrativ.

Në qoftë se ankimi pranë Strukturës Vendore të Apelimit nuk bëhet brenda afatit të caktuar, ai konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Taksapaguesi mund të kërkojë rivendosjen në afat vetëm nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme respektimi i afatit procedural. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se një vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet dorëzuar edhe ankimi pranë Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Ankimi duhet të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ankimesi. Gabimet jomateriale, ortografike, apo mungesa që nuk prekin vlefshmërinë apo thelbin, nuk përbëjnë arsye për mosmarrjen në shqyrtim të apelimit. Ankimi dorëzohet pranë zyrës së protokollit të bashkisë drejtpërdrejtë nga taksapaguesi ose nëpërmjet shërbimit postar.

Dokumentacioni shoqërues, që i bashkëngjitet ankimit, duhet të detajohet në rregulloren përkatëse, por duhet që të paktën të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Emrin dhe adresën e taksapaguesit;
- Numrin identifikues të regjistrimit të taksapaguesit;
- Aktin administrativ, të nxjerrë ose jo nga organi tatimor, që është objekt ankimi, duke përfshirë periudhën tatimore përkatëse dhe shumën e detyrimit tatimor;
- Pagesën ose jo (në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak) të detyrimit tatimor që ankimohet;
- Arsyet për ankimin e tij;
- Informacion në mbështetje të ankimit (Aktin e kontrollit, procesverbalet etj.);
- Çdo dokument tjetër që ankimuesi e gjykon të rëndësishëm;
- Nënshkrimi.

Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kriterëve formale të përshkruara më lart, Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij, të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar, brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike.

7.3.2 Pagesa e detyrimit të ankimuar

Është e drejtë e Këshillit Bashkiak të vendosë nëse taksapaguesi duhet ta parapaguajë ose jo detyrimin tatimor për të cilin ankohet, apo ta parapaguajë pjesërisht atë.

Në rastin kur Këshilli Bashkiak ka vendosur në favor të parapagimit, ankimi pranohet nëse ankimuesi:

- Parapaguan shumën e plotë/të pjesshme të detyrimit tatimor, objekt ankimi të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet, ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat të paktën gjashtë muaj, por jo më pak se afati sipas të cilit vendimi merr formë të prerë;
- Vërteton pagesën ose garancinë, duke paraqitur një kopje të dokumentit të pagesës së detyrimit tatimor objekt ankimi apo të garancisë bankare.

Taksapaguesi pajset nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me një dokument urdhër pagesë, ku pasqyrohet saktësisht detyrimi tatimor për t'u paguar.

Në qoftë se taksapaguesi nuk paguan shumën e caktuar para skadimit të afatit të ankimit, ose nuk vendos garancinë bankare, ankimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet.

Në qoftë se nuk plotësohet ndonjë prej kriterëve formale të përshkruara më lart, Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore i kërkon taksapaguesit ta ridërgojë ankimin e tij, të plotësuar si duhet me informacionin e kërkuar, brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike.

Taksapaguesi nuk mund të apelojë në gjykatë një akt administrativ, pa bërë më parë ankimin administrativ dhe pa përfunduar procesi i vlerësimit të një ankimi në Strukturën Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore. Në rastet kur Struktura Vendore e Apelimit merr një vendim refuzues të ankimit apo nuk shprehet brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e marrjes së ankimit, taksapaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë

7.4 Veprimet e strukturës vendore të apelimit

Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore shqyrton dhe merr vendime të pavarura për ankimet e paraqitura nga taksapaguesit në lidhje me të gjitha taksat dhe tarifatat vendore. Ajo i bazon vendimet e saj në provat dhe argumentet e paraqitura nga taksapaguesi dhe administrata tatimore vendore. Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore mund të kërkojë informacion shtesë, p.sh., dokumente të tjera nga taksapaguesi, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga palë të treta, si dhe mund të bëjë verifikime që ndihmojnë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore e kufizon shqyrtimin e ankimit vetëm në çështjet e ngritura nga taksapaguesi në ankim. Në qoftë se gjatë procedurës zbulohen fakte të reja që provojnë se detyrimi tatimor i përcaktuar nuk është i mjaftueshëm, Struktura e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk mund ta rrisë vetë detyrimin tatimor. Në këtë rast, Struktura e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore informon me shkrim Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, duke e vënë në dijeni për rrethanat e reja.

Struktura e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore ka të drejtë të gjykojë mbi detyrimin tatimor, si dhe kamatëvonesat e gjobat që lidhen me të.

Vendimi i Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të përfshijë një sqarim me shkrim të mënyrës së arsyetimit të vendimit dhe duhet të ketë të gjitha elementet formale dhe arsyetuese të kërkuara nga neni 98 e në vijim i Kodit të Procedurave Administrative.

Vendimi i Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të përfshijë një dispozitë që vë në dijeni taksapaguesin për të drejtën e tij për ankimin e vendimit në gjykatë dhe afatin kohor për ankimin gjyqësor. Ky vendim i dërgohet taksapaguesit dhe Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore, që ka nxjerrë vendimin objekt ankimi.

Përdorimi për arsyetim i të dhënave të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsytimit. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme.

Pas shqyrtimit të çështjes, Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, vendos:

- Të refuzojë shqyrtimin e ankimit për shkak se e konsideron këtë të fundit të papranueshëm;
- Ta rrëzojë ankimin;
- Ta anulojë aktin administrativ objekt ankimi, duke pranuar ankimin;
- Ta pranojë ankimin (pjesërisht ose plotësisht) dhe ta ndryshojë aktin administrativ objekt ankimi.

Struktura Vendore e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore mund të refuzojë shqyrtimin e ankimit vetëm për shkaqet e mospranimit të përcaktuara nga ligji dhe nga rregullorja e Këshillit Bashkiak. Shkak ligjor i mospranimit është tejkalimi i afateve kohore, ndërsa vetë njësitë vendore mund të kenë miratuar në rregulloren e mësipërme edhe kushte paraprake shtesë për pranimin e ankimit, të tilla si: parapagimi i detyrimit, paraqitja e dokumenteve shoqëruese të ankimit apo plotësimi i disa të dhënave dhe elementeve formale të ankimit. Shkaqet e papranueshmërisë nuk duhet të justifikohen nga gabime të vogla, të riparueshme nga ankimesi apo kur administrata e zotëron vetë informacionin ose dokumentacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankimin konkret.

Struktura e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të rrëzojë një ankim nëse gjykon që ankimi është i pabazuar, pasi procedura është ndjekur sipas rregullit dhe akti administrativ ka qenë i drejtë dhe ligjërisht korrekt.

Struktura Vendore e Apelimit, në bazë të fakteve të vërtetuara gjatë procedurës, ndërmer anulimin e aktit administrativ dhe vendos vetë për çështjen, ose i kërkon Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore ta zgjidhë atë, nëse konstaton që Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore:

- I ka vlerësuar provat gabim;
- Ka nxjerrë konkluzion të gabuar nga faktet e parashtruara;
- Ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi është zbatuar gabim;
- Struktura Vendore e Apelit vlerëson se duhet zbatuar një vendim i ndryshëm nga ai që është marrë i marrë.

Në rastet kur e konsideron të drejtë ankimin e paraqitur, Struktura Vendore e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore mund ta pranojë atë, duke e ndryshuar aktin administrativ objekt ankimi.

Ankimuesi mund të heqë dorë nga ankimi para se të dakë vendimi i ankimit. Në këtë rast, procedura e ankimit ndërpritet me një vendim për mbylljen e procedurës së ankimit.

7.4.1 Afati i shqyrtimit të ankimit

Afatet e shqyrtimit të ankimit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në mungesë të miratimit të tyre, mund të ndiqen në mënyrë analoge rregullat e zbatueshme nga administrata tatimore qendrore sipas ligjit për procedurat tatimore. Në këtë rast, Struktura Vendore e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore vendos brenda gjashtëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së ankimit.

Në qoftë se Struktura Vendore e Apelit nuk nxjerr vendim brenda gjashtëdhjetë ditësh nga marrja e ankimit të plotësuar si duhet, taksapaguesi mund të fillojë një ankim gjyqësor edhe në mungesë të vendimit të Strukturës Vendore të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në qoftë se vendimi i ankimit varet plotësisht ose pjesërisht nga një çështje e mëparshme, që është subjekt i procedurave gjyqësore ose është nën juridiksionin e një organi tjetër publik, Struktura Vendore e Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore, mund të nxjerrë një vendim të përkohshëm për pezullimin e procedurës, deri në zgjidhjen e çështjes së mëparshme.

Gjithashtu, në rastin e pezullimit të një procedure, vendimi përfundimtar i Strukturës Vendore të Apelit të Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të nxirret brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së ankimit të plotësuar, përndryshe ankimuesi mund të ankimojë drejtpërdrejt në gjykatë.

7.4.2 Rimbursimi, garancia dhe pagesa e detyrimit në rastet e parapagimit në procesin e ankimit administrativ

Nëse vendimi i Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore është në favor të taksapaguesit, detyrimi i parapaguar nga taksapaguesi i rimbursohet atij brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit.

Nëse taksapaguesi ka paraqitur garanci për pagesën e detyrimit, kjo çlirohet tërësisht apo pjesërisht sipas vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga data kur është marrë ose vlerësohet të jetë marrë vendimi nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit

Nëse Struktura Vendore e Apelimit lë në fuqi vendimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe taksapaguesi e pranon vendimin, çdo detyrim tatimor, që përfshin taksën apo tarifën, në rastin kur nuk është paguar, ose është vendosur garanci, kamatëvonesë dhe çdo gjobë e llogaritur, paguhen nga taksapaguesi brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga data kur vendimi për ankimin është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga ana e Strukturës Vendore të Apelimit.

7.5 Ankimi në rrugë gjyqësore kundër vendimit të strukturës së apelimit

Nëse taksapaguesi nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar në lidhje me ankimin administrativ të marrë nga Struktura Vendore e Apelimit, ligji i njeh atij të drejtën që të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki.

Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë ankim në rrugë gjyqësore kundër vendimit të Strukturës Vendore të Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.

Nëse Struktura Vendore e Apelimit nuk shprehet brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e marrjes së ankimit, taksapaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatë, brenda tridhjetë ditësh nga përfundimi i afatit gjashtëdhjetëditor.

Megjithatë, në qoftë se taksapaguesi nuk është njoftuar në mënyrë korrekte ose nuk është vënë në dijeni për të drejtën e tij për të ankimuar vendimin e Strukturës Vendore të Apelimit, ankimi në gjykatë bëhet brenda tre muajsh nga data kur vendimi është marrë.

Në këtë rast, procesi gjyqësor duhet të kryhet pranë gjykatave administrative, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Një element i rëndësishëm i këtij ligji për t'u konsideruar është transferimi i barrës së provës tek administrata publike, pasi, sipas nenit 35 të tij, është organi publik që ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ.

7.6 Organizimi i strukturës vendore të apelimit administrativ të taksave dhe tarifave vendore

Siç u përmend më sipër, janë vetë njësitë vendore ato që duhet të përcaktojnë strukturat vendore të apelimit, sipas vendimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Organizimi i tyre varet nga disa faktorë, siç janë: vendimmarrja specifike e këshillave vendorë, përmasat e stafit dhe numri i të punësuarve në strukturat tatimore vendor apo kapacitetet e secilës njësi vendore.

Për sa i përket Strukturës së Apelimit, Këshilli Bashkiak duhet të përcaktojë, me rregullore, rregullat që lidhen me përbërjen, kuorumin dhe vendimmarrjen, procedurën e shqyrtimit të apeliemeve, afatin maksimal për vlerësimin e ankimeve, formën dhe përmbajtjen e vendimeve, si dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të kësaj strukture.

Megjithatë, në vijim jepen disa sugjerime të cilat mund të shërbejnë si shembuj të organizimit të strukturave në nivel vendor.

Bazuar në specifikat që çdo Njësi e vetëqeverisjes vendore ka nga pikëpamja e numrit të popullsisë, bizneseve dhe burimeve njerëzore në bashki, është e këshillueshme që ato të mund shfrytëzojnë një prej formave të mëposhtme, si strukturë të apelimit administrativ të taksave dhe tarifave vendore:

- Drejtori/zyrë e Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Komisioni i Apelimit të Taksave dhe Tarifave Vendore, i përbërë nga punonjës të departamenteve të ndryshme të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Këshillohet që Struktura e Posaçme e Apelimit të ketë vendimmarrje me shumicë votash të anëtarëve dhe të jetë e përbërë nga numër tek anëtarësh, për të shmangur rastet e barazisë së votave, apo duke vendosur rregullin që, në rast barazie votash, të vendosë vota e kryetarit të strukturës së apelimit.

Anëtarët e strukturës duhet të kenë profil profesional dhe arsimor në fushat juridike, financiare apo ekonomike, ndërsa për çështjet që lidhen me taksën e pasurisë, mund të jetë anëtar edhe një nëpunës i sektorit të urbanistikës.

Struktura mund të ketë një anëtar nga Drejtoria e Taksave Vendore, i cili ka informacion mbi detyrimin e ankimuar, por sugjerohet që të mos jetë e përbërë tërësisht nga anëtarë të kësaj drejtorie, për të garantuar pavarësinë e gjykimit të ankimit administrativ ndaj vendimit të marrë nga kjo drejtori.

8. Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor

8.1 Baza ligjore

Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor rregullohen dhe duhen parë paralelisht me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; (më poshtë referuar si "Ligji për taksat vendore");
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë referuar si "Ligji për procedurat tatimore");
- Udhëzimi Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë referuar si "Udhëzimi për procedurat tatimore");
- Ligjin Nr. 9874, datë 14.02.2008, "Për ankandin publik" (më poshtë referuar si "Ligji për ankandin publik");
- VKM Nr. 1234, datë 16.12.2009, "Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekare";
- Kodi i Procedurës Civile;
- Kodi Civil.

ATV ka autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore vendore të papaguara, për të cilat:

- Nuk është ushtruar e drejtat e ankimit administrativ; ose
- Janë kaluar të gjitha fazat e ankimit administrativ dhe gjyqësor

8.2 Procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit

Ky kapitull detajon procedurat të cilat përdoren në mbledhjen e borxheve tatimore vendore, bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi, përfshirë këtu veprime konkrete dhe afatet që duhen ndjekur nga ATV në funksion të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor.

8.2.1 Veprimet fillestare

Veprimi i parë që duhet kryer nga administrata në lidhje me fillimin e procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit është që të verifikojë plotësimin e kriterëve ligjore si më sipër, për nisjen e kësaj procedure, pra të verifikojë që:

- Detyrimi tatimor nuk është paguar nga taksapaguesi në datën e nisjes së procedurës dhe taksapaguesi nuk ka ushtruar të drejtat e ankimit administrativ dhe afati ligjor për të kryer këtë ankim ka përfunduar;

ose

- Nëse e drejta e ankimit administrativ dhe/ose gjyqësor është ushtruar nga taksapaguesi, të verifikohet që këto faza janë kaluar dhe ka një vendim përfundimtar të formës së prerë në favor të ATV, në lidhje me detyrimet e papaguara për të cilat synohet të kryhet procedura.

Për qëllime të verifikimeve të mësipërme, është e rëndësishme të ndiqen afatet e mëposhtme:

- Afati për ushtrimin e të drejtës për kryerjen e ankimit administrativ është tridhjetë ditë kalendarike¹ dhe fillon nga dita që pason (i) datën e marrjes së aktit administrativ, pra Njoftimit të Vlerësimit të Detyrimit, nga taksapaguesi; apo (ii) datën kur ky akt konsiderohet të jetë marrë nga taksapaguesi, e cila, sipas përcaktimeve ligjore, është brenda dhjetë ditëve kalendarike pas pranimit të aktit administrativ nga zyra e shërbimit postar;
- Data e humbjes së të drejtës për të bërë ankim administrativ konsiderohet

¹ Ky afat mund të përcaktohet ndryshe nga rregullorja vendore, e cila ka të drejtë të përcaktojë një afat më të gjatë, por jo më të shkurtër se ai i vendosur.

dita e parë e punës së ATV, që pason datën e përfundimit të afatit të ankimit për ushtrimin e të drejtës së ankimit administrativ;

- Në rast se taksapaguesi ka ushtruar të drejtën e ankimit administrativ, por jo atë të ankimit gjyqësor, datë e përfundimit të afatit të ankimit konsiderohet në çdo rast data e përfundimit të afatit të ankimit në rrugë gjyqësore, i cili përfundon tridhjetë ditë pasi vendimi në lidhje me ankimin administrativ është marrë nga taksapaguesi.

ATV fillon procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit nga dita e nesërme, pas përmbushjes së çdonjërit prej kushteve ligjore më lart. Afatet, të cilat përdoren për verifikimin e plotësisimit të kushtit ligjor, shtyhen në ditën e parë të punës, në rast së datat e përfundimit të këtyre afateve bien në ditë pushimi javor apo në ditë festash zyrtare.

Qëllimi i ndjekjes së procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimi tatimor është maksimizimi i efektivitetit në mbledhjen e këtij detyrimi, si dhe reduktimi i kostove administrative. Arritja e këtij qëllimi nënkupton ndjekjen e disa hapave, në kuadër të vlerësimit të rrezikut që lidhet me mbledhjen e detyrimit, që janë përgjegjësi e strukturës së mbledhjes së borxhit tatimor pranë NJVV dhe që mund të ndërmerren nga zyra, duke përdorur informacione të gatshme apo të aksesueshme nga regjistrat publikë.

Më konkretisht këta hapa përfshijnë, por pa u kufizuar, si më poshtë:

- Sigurimin e marrjes së informacionit dhe monitorimin e deklarimeve, pagesave dhe regjistrimeve kontabël;
- Analizën dhe dokumentimin e informacionit të kërkuar, për të proceduar me hulumtimin e rasteve;
- Shqyrtimin e pagesave të detyrimeve tatimore, me qëllim saktësimin e gjendjes së detyrimeve të taksapaguesit (shumat e deklaruara apo të vlerësuara të detyrimit, krahasohen me shumat e paguara të detyrimit).

8.2.2 Njoftimi dhe kërkesa për pagesën e detyrimit

Me verifikimin dhe përmbushjen e kushtit ligjor për nisjen e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit, sipas seksioneve të mësipërme, ATV përgatit dhe dërgon Njoftimin dhe Kërkesën për Pagesën e Detyrimit të taksapaguesi debitor.

i. Dërgimi

Njoftimi dhe Kërkesa për Pagesën e Detyrimit dërgohet nëpërmjet postës rekomande, në rrugë elektronike, nëse taksapaguesi ka dhënë pëlqimin për komunikim të tillë, apo dorazi, kundrejt konfirmimit të marrjes nga taksapaguesi.

Afatet e ndjekura për dërgesën e këtij njoftimi janë të njëjta me ato të njoftimit të vlerësimit tatimor.

Kur administrata tatimore, nga provat e mbledhura prej saj, ose që gjenden pranë saj, krijon bindjen se detyrimi tatimor rrezikon të mos shlyhet, ajo nuk pret dërgimin e këtij njoftimi sipas paragrafit 1 të nenit 89 të Ligj Nr. 9920, "Për procedurat tatimore", por fillon menjëherë procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimit, duke përdorur një ose të gjitha mënyrat e parashikuara.

ii. Përmbajtja

Të dhënat e detyrueshme që duhet të përfshihen në këtë dokument zyrtar janë:

- shuma e detyrimit të papaguar;
- lloji i taksave dhe tarifave të papaguara;
- sanksionet e zbatueshme, në rast të mospagimit të detyrimit, përfshirë gjoba dhe kamatëvonesa¹;
- informacioni mbi fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit.

iii. Personi përgjegjës

Personi përgjegjës për nxjerrjen e aktit është titullari i Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore pranë NJVV. Akti gjithashtu mund të përgatitet e dërgohet edhe nga një person i deleguar nga personi përgjegjës apo një person të cilit i rrjedh kjo e drejtë për shkak të funksioneve që kryen.

iv. Afatet e përgatitjes, nxjerrjes së aktit dhe dokumentimit për qëllime të brendshme

Afati gjithëpërfshirës për përgatitjen dhe nxjerrjen e aktit nga ATV është dhjetë ditë nga data kur taksapaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar detyrimin.

Brenda tri ditëve të para të dhjetëditëshit, si më sipër, sektori që ndjek procedurat e mbledhjes së detyrimeve përgatit Njoftimin dhe Kërkesën për Pagesën e Detyrimit me të dhënat e shpjeguara më sipër.

¹ Shih nenin 76 dhe neni 114 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar.

Brenda dy ditëve në vijim, akti i dërgohet taksapaguesit nëpërmjet njërës prej formave të parashikuara më sipër, në pikën "Dërgimi".

Brenda pesë ditëve nga dita e dërgimit të njoftimit, akti depozitohet në dosjen e taksapaguesit.

v. Përfundimi i afatit të pagesës së detyrimit dhe fillimi i procedurave të mbledhjes me forcë

Afati i pagesës së detyrimit përfundon pas dhjetë ditësh nga data e nisjes me postë të aktit ose brenda tri ditëve nga data e dorëzimit të tij te taksapaguesi, dorazi apo në rrugë elektronike.

Afatet që lidhen me Njoftimin dhe Kërkesën për Pagesë janë të njëjta me ato të parashikuar nga Neni 69 i Ligj 9920, "Për Procedurat Tatimore". Përfundimi i këtyre afateve shënjon fillimin e zbatimit të procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

8.2.3 Masa emergjente

Në rast se ekzistojnë prova objektive e të besueshme, të cilat vërtetojnë se detyrimi tatimor rrezikon të paguhet, ATV nuk pret derisa të dërgohet Njoftimi dhe Kërkesa për Pagesë si më sipër, por nis menjëherë procedurën e mbledhjes me forcë të detyrimit, duke përdorur një ose të gjitha mënyrat e parashikuara.

Gjithashtu, në rastet kur, nga informacioni i mbledhur nga ATV, ka prova që tregojnë se detyrimi tatimor rrezikohet ndjeshëm, pasi taksapaguesi mund të fshehë apo të transferojë pasuritë e tij, ATV mund të marrë edhe masat e mëposhtme:

i. Të ndalojë qarkullimin e taksapaguesit jashtë territorit të RSH.

ATV mund të bëjë kallëzim për ndjekje penale¹ ndaj taksapaguesit dhe t'i kërkojë organit të prokurorisë të procedojë me depozitimin pranë organeve gjyqësore të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit personal².

ii. Të ndalojë transferimin jashtë vendit të likuiditeteve të taksapaguesit.

ATV, vetë apo nëpërmjet organit të prokurorisë, mund t'u kërkojë të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë të mos e lejojnë taksapaguesin të kërkojë transferimin e shumave jashtë territorit të vendit. Në rastin e personave

¹ Shih nenin 131 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

² Shih nenin 233 i Kodit të Procedurës Penale.

juridikë, ky ndalim mund të kërkohet si për taksapaguesin, ashtu edhe për ortakët, aksionarët dhe/ose administratorët e tij.

8.2.4 Nisja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit

ATV, për të siguruar efikasitetin maksimal në mbledhjen e detyrimeve të papaguara, mund të përdorë paralelisht një apo disa nga mjetet ligjore, që i janë vënë në dispozicion nga legjislati në fuqi. Disa nga këto mjete listohen në vijim:

- Sekuestrimi i një pjese të xhiros ditore të taksapaguesit person fizik apo juridik;
- Bllokimi i llogarive bankare të taksapaguesit;
- Vendosja e masës së sigurimit mbi pasuritë e taksapaguesit;
- Transferimi i detyrimit te palët e treta, në rast pamundësie të mbledhjes drejtpërdrejt nga taksapaguesi;
- Kërkimi i pagesës së detyrimit nga palët e treta debitore ndaj taksapaguesit;
- Thirrje për paraqitje e personave që disponojnë informacione rreth situatës financiare dhe/ose pronësore të taksapaguesit.

8.2.5 Sekuestrimi i një pjese të xhiros ditore të taksapaguesit

Ky mjet është i zbatueshëm vetëm për taksapaguesit që kryejnë aktivitet tregtar në formë të organizuar dhe kanë detyrimin për regjistrim¹, si: persona fizikë, persona juridikë, ambulantë etj.

Në kuadër të këtij mjeti, që ATV i është vënë në dispozicion nga legjislati në fuqi me qëllim mbledhjen e detyrimit të papaguar, ATV angazhon strukturat e saj përkatëse për verifikimin dhe monitorimin në terren të aktivitetit tregtar të taksapaguesit debitor. Qëllimi i kësaj procedure është konfiskimi në fund të çdo dite i një shume jo më të vogël se 50% e xhiros ditore dhe, në çdo rast, jo më të madhe se detyrimi tatimor i papaguar nga taksapaguesi.

¹ Shih nenin 22 i Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar; Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe neni 40 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

i. Njoftimi

Taksapaguesi njoftohet përpara se të fillojë verifikimi dhe monitorimi në terren i aktivitetit të tij tregtar. Urdhri i konfiskimit, për të konfiskuar në fund të çdo dite një shumë jo më të vogël se 50% e xhiros ditore, por jo më shumë se detyrimi tatimor, lëshohet nga drejtori i Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore pranë NJVV.

Ky urdhër është akti i vetëm, me anë të të cilit ATV mund të ushtrojë të drejtën e konfiskimit të xhiros ditore.

Urdhri i konfiskimit të xhiros lëshohet në baza ditore dhe përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- Emrin e taksapaguesit;
- NUIS;
- Adresën e taksapaguesit;
- Numrin dhe datën e Njoftimit të Vlerësimit Tatimor, ose të dhënat e aktit të mbledhjes me forcë të detyrimit, sipas fazës në të cilën është procedura e mbledhjes;
- Bazën ligjore, sipas të cilës është duke u kryer masa e konfiskimit¹;
- Shumën e xhiros ditore;
- Shumën e xhiros ditor për të cilën vendoset masa e konfiskimit;
- Informacion të qartë të detyrimit të taksapaguesit për kalimin/pagesën brenda ditës së nesërme të punës të shumës së konfiskuar për detyrimin, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë.

ii. Procedura

Në fund të ditës, inspektorit i ATV dhe taksapaguesi mbajnë një procesverbal mbi xhiron e përgjithshme ditore dhe kalimin e 50% të shumës së kësaj shume në llogarinë bankare të ATV ditën e nesërme të punës. Taksapaguesi kryen çdo ditë të nesërme depozitim të shumave në bankë për llogari të ATV, ndërsa inspektori ndjek dhe verifikon nëse derdhja e shumës prej jo më pak se 50% e xhiros është bërë në baza ditore. Procedura ndërpritet në rast se taksapaguesi shlyen të gjithë detyrimin tatimor, apo në rast se konfiskimet ditore plotësojnë vlerën e detyrimit.

¹ Shih nenin 89 i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

8.2.6 Nxjerrja e urdhrit për bllokimin e llogarive bankare

Urdhri për bllokimin e llogarive bankare nxirret në rastet kur taksapaguesi nuk ka paguar detyrimin ndaj ATV brenda afateve ligjore.

i. Njoftimi

Urdhri për bllokimin e llogarive bankare të taksapaguesit lëshohet një ditë pune pas datës kur detyrimi duhet të ishte paguar, sipas Njoftimit dhe Kërkesës për Pagesë të Detyrimit¹, apo kur afatet për ankimin e këtij akti në rrugë administrative dhe/ose gjyqësore janë kapërcyer dhe jo më vonë se dhjetë ditë nga kjo datë.

Akti lëshohet nga titullari i NJVV dhe dërgohet pranë të gjitha bankave ku ka informacion se taksapaguesi apo palët e lidhura me të (pra, administratori dhe ortakët apo aksionarët) kanë llogari bankare, por mund të dërgohet edhe në të gjitha bankat e nivelit të dytë që operojnë në shkallë vendi. Urdhri është i vlefshëm mbi të gjitha llojet e llogarive bankare të taksapaguesit apo personave të lidhur me të, përfshirë ato rrjedhëse, të kursimit apo depozitave dhe të ardhurave të gjeneruara nga këto të fundit.

Urdhri i bllokimit u dërgohet institucioneve bankare me postë rekomande ose në rrugë elektronike.

ii. Përmbajtja

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare duhet të përmbajë të dhëna të detyrueshme, si më poshtë:

- Identitetin e personit, llogaritë e të cilit kërkohen për bllokim (emrin dhe të dhënat identifikuese të individit, personit fizik apo juridik);
- Arsyen e nxjerrjes së urdhrit;
- Datën kur duhet të ishte kryer pagesa;
- Shumën e detyrimit;
- Afatin se kur banka duhet të bëjë kalimin e shumës në favor të ATV;
- Numrin e llogarisë ku do të bëhet kalimi;
- Shuma që kërkohet për bllokim është më e vogla midis:
 - o Shumës që duhet të mbahet; dhe
 - o Shumës që rezulton në llogarinë bankare

¹ Shih pikën 1 e nenit 89 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

iii. Procedura e ekzekutimit

Mbi bazën e Urdhrit të bllokimit, bankat e nivelit të dytë menjëherë, brenda të njëjtës dite pune, duhet të ekzekutojnë mbi llogaritë bankare të taksapaguesit apo personave të lidhur me të, urdhrin e dërguar nga ATV në masën e detyrimit të papaguar dhe të lajmërojnë menjëherë taksapaguesin për bllokimin. Nëse taksapaguesi ka më shumë se një llogari në të njëjtën bankë, banka, mbi bazën e urdhrin, bllokon llogarinë/llogaritë që kanë shumën e mjaftueshme për të shlyer detyrimin.

Kalimi i shumës së detyrimit apo shumave që gjenden në llogari, nëse këto janë më të vogla se detyrimi, bëhet nga institucioni bankar në favor të ATV brenda tri ditëve pune nga data e marrjes së Urdhrit të bllokimit. Në rast se shuma në llogarinë e taksapaguesit është më e vogël se detyrimi, pas ekzekutimit të shumave të gjendura, banka mban të bllokuara këto llogari në pritje të shumave në hyrje, të cilat mund të mbulojnë pagesën e plotë të detyrimit.

Në rast se ka urdhra të tjerë bllokimi, banka i ekzekuton ata sipas radhës së përcaktuar në nenin 605 të Kodit Civil.

8.2.7 Vendosja e masës së sigurimit të detyrimit

Nëse taksapaguesi nuk i paguan detyrimet në përfundim të afateve ligjore, pasi i është dërguar Njoftimi i Kërkesës për Pagesë, shuma e detyrimit (përfshirë gjokat dhe kamatëvonesat), duhet të sigurohet nëpërmjet vendosjes së masës së sigurimit të detyrimit në favor të ATV mbi pasuritë e taksapaguesit, përfshirë këtu pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Kjo masë e sigurimit të detyrimit vendoset me qëllim që pasuria e taksapaguesit të mos humbasë apo të tjetërsohet nga ky i fundit në favor të të tretëve, përpara se detyrimi të jetë shlyer plotësisht.

i. Vendimi për vendosjen e masës së sigurimit

Masa e sigurimit konsiston në vendosjen e barrës hipotekare mbi pasuritë e paluajtshme të taksapaguesit dhe barrës siguruese mbi pasuritë e luajtshme të tij. Masa e sigurimit të detyrimit bëhet me vendim të titullarit të Zyrës Tatimore Vendore pranë NJVV për Vendosjen e Masës së Sigurimit ("Vendimi") ndaj pasurive të taksapaguesit. ATV i njofton Vendimin taksapaguesit, e publikon atë që palët e treta të vihen në dijeni dhe ua dërgon më pas organeve kompetente për zbatim. Njoftimi si më sipër bëhet që personat e tretë të vihen në dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe që organet apo institucionet të cilat kanë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të taksapaguesit debitor të mos lejojnë kryerjen

e transaksioneve për transferimin e pasurive të këtij të fundit, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar të arkëtohet.

Në vijim listohen të dhënat e detyrueshme që duhet të përmbajë ky akt:

- Të dhënat identifikuese të taksapaguesit;
- Adresa e taksapaguesit;
- Numri personal të identifikimit apo NUIS i taksapaguesit;
- Shuma e detyrimit të papaguar;
- Fakti që të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të taksapaguesit konsiderohen të rënduara me barrë siguroese apo hipotekare, pavarësisht nëse barrët janë regjistruar ose jo;
- Kërkesa për të identifikuar nëse në emër të taksapaguesit, apo personave të lidhur me të, ka apo jo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- Kërkesa për të vendosur barrë siguroese për pasuritë e luajtshme dhe barrë hipotekare për pasuritë e paluajtshme.

Njoftimi i Vendimit për vendosjen e masës siguroese i dërgohet me shkrim taksapaguesit me postë rekomande, në rrugë elektronike, nëse është marrë pëlqimi paraprak për të komunikuar në këtë mënyrë, apo dorazi kundrejt konfirmimit me shkrim të marrjes nga ana e taksapaguesit, si dhe të gjithë institucioneve që administrojnë të dhëna mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Njoftimi i sipërpërmendur publikohet në faqen zyrtare të NJVV, në mënyrë që publiku të njoftohet se taksapaguesi ka detyrim tatimor të papaguar dhe ndaj tij kanë nisur procedurat për vendosjen e barrës siguroese mbi pasuritë e luajtshme apo barrës hipotekare mbi pasuritë e paluajtshme.

ii. Vendosja e barrës hipotekare

Vendimi për vendosjen e masës së sigurimit u njoftohet institucioneve kompetente, të cilat administrojnë regjistrat e pasurive të paluajtshme. Nëpërmjet këtij akti, u kërkohet zyrave qendrore dhe/ose lokale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (pasuese e ZRPP dhe ALUIZNI) të vendosë barrë hipotekare mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme të taksapaguesit debitor. Vendimi për vendosjen e barrës hipotekare ka efekt në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është i detyrueshëm për ekzekutim nga çdo institucion, publik apo privat, që mban dhe administron regjistra të pasurive të paluajtshme.

Nëse ATV nuk disponon të dhëna mbi pasuritë e paluajtshme të taksapaguesit, së bashku me njoftimin e sipërpërmendur, ASHK, apo zyrave lokale të saj, i kërkohet

që, brenda një afati kohor prej pesë ditësh pune, të bëjë identifikimin e këtyre pasurive dhe të kryejnë vendosjen e barrës hipotekare mbi këto pasuri në favor të ATV, deri kur nga ana e taksapaguesit të vërtetohet pagesa e detyrimit.

Barra hipotekare, përveç pasurive të paluajtshme të taksapaguesit, mund të vendoset edhe për:

- Uzufruktet e këtyre pasurive si dhe të drejtave mbi to, të cilat janë të lidhura me të ardhurat e pronarit të pasurisë, pra taksapaguesit debitor;
- Pasuritë e paluajtshme të ardhshme të taksapaguesit apo personave të lidhur me të (ortakut apo aksionarit dhe administratorit).

Vendosja e barrës hipotekare nuk mund të shtrihet te pjesët e pasurisë që u përkasin bashkëpronarëve të pasurisë së taksapaguesit.

Nëse pasuritë mbi të cilat zbatohet vendosja e barrës hipotekare janë të siguruara në shoqëritë e licencuara të sigurimit, atëherë ATV ka të drejtën që, gjatë periudhës së ushtrimit të procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit, të përfitojë të gjitha të ardhurat që mund të rrjedhin nga ndodhja e një ngjarjeje për të cilën pasuria e taksapaguesit është siguruar. Ky përfitim nuk mund të shtrihet mbi pjesët e të ardhurave nga ngjarja e siguruar që u takojnë bashkëpronarëve të pasurisë së taksapaguesit.

Formati i njoftimit të vendimit për vendosjen e barrës hipotekare është i paracaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave¹.

iii. Vendosja e barrës siguruese

Vendimi për vendosjen e masës së sigurimit u njoftohet institucioneve kompetente, të cilat administrojnë regjistrat e pasurive të luajtshme. Për vendosjen e barrës siguruese, ATV vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili rregullon këto barrë².

Me qëllim identifikimin e pasurive të luajtshme të taksapaguesit debitor, vendimi i ATV u njoftohet të gjitha zyrave në Republikën e Shqipërisë që janë të ngarkuara për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme, duke përmendur këtu Regjistrin e Barrëve Siguruese ("RBS"), zyrat e regjistrimit të aksioneve, atë të regjistrimit të titujve shtetërorë etj. Vendimi për vendosjen e barrës siguruese është i

¹ VKM Nr. 1234, datë 16.12.2009 "Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguruese dhe/ose barrën hipotekare"

² Ligj nr. 8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", i ndryshuar; dhe Rregullore e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 493 datë 06.07.2006 "Rregullore e barrëve siguruese"

detyrueshëm për ekzekutim nga këto zyra, duke filluar nga dita e parë e punës pas datës së publikimit të aktit për fillimin e këtyre procedurave në faqen zyrtare të NJVV.

Në rast se ATV ka dijeni për sende të luajtshme në pronësi të taksapaguesit, apo personave të lidhur me të, për të cilët është nxjerrë një urdhër për vendosjen e masës së sigurimit, vendosja e kësaj mase bëhet sipas formularit "Njoftimi C - Regjistrimi i Pretendimeve Shtetërore" të RBS.

Nëse ATV nuk disponon të dhëna mbi pasuritë e luajtshme të taksapaguesit, së bashku me njoftimin e sipërpërmendur, zyrave që administrojnë regjistrat e pasurive të luajtshme u kërkohet që, brenda një afati kohor prej pesë ditësh pune, të bëjnë identifikimin e këtyre pasurive dhe të kryejnë vendosjen e barrës siguroese mbi këto pasuri në favor të ATV, deri kur nga ana e taksapaguesit të vërtetohet pagesa e detyrimit.

Barra siguroese mund të vendoset mbi pasuritë e mëposhtme:

- Automjetet - të tilla do të konsiderohen mjetet sipas përkufizimit të nenit 54 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Nr. 8378, datë 22.07.1998;
- Ciklomotorët - të tillë do të konsiderohen mjetet sipas përkufizimit të nenit 52 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Nr. 8378, datë 22.07.1998;
- Makinat bujqësore - të tilla do të konsiderohen mjetet sipas përkufizimit të nenit 57 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Nr. 8378, datë 22.07.1998;
- Makinat teknologjike - të tilla do të konsiderohen mjetet sipas përkufizimit të nenit 58 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Nr. 8378, datë 22.07.1998;
- Mallrat me numër serie - të tilla do të konsiderohen mallrat që renditen si vijon: automjete, ciklomotorë, makina bujqësore, makina teknologjike, mjete fluturimi, mjete lundrimi, motomjete, motorë mjeti fluturimi, rimorkio, trolejbusë;
- Mjetet e fluturimit - të tilla do të konsiderohen mjetet e ndërtuara për transportimin e personave dhe/ose mallrave nëpërmjet ajrit;
- Mjetet e lundrimit - tilla do të konsiderohen mjetet e ndërtuara për të transportuar persona ose sende nëpërmjet ujit dhe që vihen në lëvizje kryesisht nga çdolloj tjetër force, përveç forcës së muskujve dhe që i kalon gjashtë metra gjatësi.
- Motomjetet - të tilla do të konsiderohen mjetet sipas përkufizimit të nenit 53 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Nr. 8378, datë 22.07.1998;
- Metalet dhe gurët e çmuar;
- Titujt e pronësisë mbi letrat me vlerë publike, si bonot e thesarit, dhe private

si aksione, kambiale, çeqe etj., të parashikuara sipas Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008, "Për Titujt".

Në rast se pasuritë mbi të cilat kryhet vendosja e barrës siguroese janë të siguruara pranë shoqërive të licencuara të sigurimit, atëherë ATV ka të drejtën që, gjatë periudhës së ushtrimit të procedurë së mbledhjes me forcë të detyrimit, të përfitojë të gjitha të ardhurat që mund të rrjedhin nga ndodhja e një ngjarjeje, për të cilën pasuria e taksapaguesit është siguruar. Ky përfitim nuk mund të shtrihet mbi pjesët e të ardhurave nga ngjarja e siguruar që u takojnë bashkëpronarëve të pasurisë së taksapaguesit.

Formati i njoftimit të vendimit për vendosjen e barrës siguroese është i paracaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave¹.

iv. Ankimi ndaj vendimit për masën e sigurimit të detyrimit

Taksapaguesi, për të cilin ka dalë një vendim për vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit, qoftë barrë hipotekare apo siguroese, ka të drejtën për ankim vetëm për shkaqe që lidhen me parregullsi në ekzekutimin e masës së sigurimit. Ky ankim bëhet pranë titullarit të Zyrës Tatimore pranë NJVV nga çasti që vihet në dijeni të parregullsisë. Për këtë qëllim, konsiderohen si parregullsi rastet e mëposhtme:

- Taksapaguesi nuk është njoftuar me shkrim për sigurimin e detyrimit tatimor brenda afateve kohore të parashikuara në ligj;
- Kur gjatë periudhës së daljes së vendimit dhe ekzekutimit të tij detyrimi tatimor është paguar;
- Nëse pasuria mbi të cilën është vendosur barrë siguroese apo hipotekare është në grupin e sendeve mbi të cilat nuk mund të shtrihet ekzekutimi, sipas parashikimeve të nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile;
- Kur akti me të së cilit kërkohet të veprohet për ekzekutimin për mbledhjen me forcë të detyrimit ka dalë jo në emër të taksapaguesit, por kundrejt një personi tjetër.

Bazuar në sa më sipër, është shumë e rëndësishme që ATV të kujdeset që aktet e nxjerra prej saj të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në përgjithësi, për sa i përket formës, përmbajtjes dhe afateve.

Në çdo rast, në ankesën e tij, taksapaguesi është i detyruar t'i provojë ATV kohën se kur ai ka marrë dijeni mbi parregullsinë, gjë që duhet të vërtetohet vetëm me

¹ VKM Nr. 1234, datë 16.12.2009, "Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekare".

anë të provave shkresore. Në çdo rast, pavarësisht nga paraqitja e provave prej taksapaguesit, kur rrethanat e çështjes tregojnë se ai kishte mundësi për të marrë dijëni më parë për parregullsinë në ekzekutimin e masës së sigurimit të detyrimit, ankesa nuk merret në konsideratë nga ana e NJVV.

Në këtë rast, taksapaguesi ka të drejtë të ankimojë administrativisht me tej vendimin e ATV në lidhje me parregullsinë e pretenduar prej tij, në përputhje me dispozitat e ankimit administrativ, miratuar nga KB.

Kur taksapaguesi provon se parregullsia qëndron, atëherë titullari i Zyrës Tatimore pranë NJVV, i cili ka nxjerrë vendimin për vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit, ka të drejtë që, me një njoftim me shkrim, të motivojë revokimin e vendimit dhe të çlirojë nga barra të gjitha pasuritë mbi të cilat është shtrirë masa e sigurimit të detyrimit.

8.2.8 Ekzekutimi i masës së sigurimit të detyrimit

Ekzekutimi i masës së sigurimit të detyrimit realizohet përmes veprimeve procedurale të mëposhtme:

- Sekuestrimi i pasurisë;
- Konfiskimi i pasurisë; dhe
- Shitja e pasurisë.

Sekuestrimi i pasurisë përbën hapin fillestar për ekzekutimin e masës së sigurimit të detyrimit tatimor dhe vjen si rezultat i mosarkëtimit të shumës së papaguar të detyrimit me një nga format e tjera të mbledhjes me forcë të detyrimit, parashtruar më lart.

Me sekuestrim të pasurisë nënkuptohet, përveç vjeljes së mjeteve monetare në vijim të ekzekutimit të urdhrin të bllokimit të llogarive bankare, edhe sekuestrimi i të gjitha pasurive të tjera të taksapaguesit, përfshirë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, mbi të cilat është vendosur më parë barrë hipotekare apo siguroese.

ATV është organi përgjegjës për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale për vendosjen e sekuestrimit. Struktura përgjegjëse për ekzekutimin e detyrimit brenda ATV përcaktohet nga vetë NJVV. Në NJVV më të mëdha janë ngritur sektorë të posaçëm, që merren me administrimin e borxhit. Në NJVV më të vogla me këtë detyrë mund të ngarkohen inspektorë apo punonjës të caktuar. Për këtë qëllim,

ajo njofton të gjitha zyrat dhe/ose institucionet ku janë regjistruar pasuritë mbi të cilat është vendosur barrë siguruese apo hipotekare.

i. Urdhri i sekuestrimit

Urdhri i sekuestrimit është akti me anë të të cilit ATV fillon procedurat e ekzekutimit të masës së sigurimit për pasuritë mbi të cilat është vendosur më parë barrë siguruese apo hipotekare. Urdhri bëhet në formë shkresore nga titullari i Zyrës Tatimore të NJVV.

Të dhënat e detyrueshme për t'u përfshirë në urdhrin e sekuestrimit, janë si më poshtë:

- Të dhënat identifikuese të taksapaguesit;
- Numri personal i identifikimit apo NUIS;
- Selia e regjistruar apo adresa e vendbanimit, në rastin e individëve;
- Numri dhe data e njoftimit për vlerësimin tatimor;
- Shuma e detyrimeve tatimore të papaguara;
- Afati për pagesën e detyrimeve tatimore;
- Pasuria që sekuestrohet;
- Mënyra e ekzekutimit të sekuestrimit;
- Informacioni rreth së drejtës së taksapaguesit për ankim administrativ.

Urdhri i sekuestrimit i dërgohet taksapaguesit në rrugë postare, në rrugë elektronike, në rast se është marrë pëlqimi paraprak për komunikimin në këtë mënyrë, apo dorazi kundrejt nënshkrimit të taksapaguesit për konfirmimin e marrjes së tij.

Urdhri bëhet i ekzekutueshëm nga ana e ATV, duke bërë të mundur sekuestrimin e pasurive nga dita pas përfundimit të afatit të ankimit dhe me kusht që të kenë përfunduar të gjitha afatet në lidhje me ankimin administrativ dhe/ose gjyqësor të këtij akti.

Detyrimi i nxjerrjes së urdhrin të sekuestrimit si parakusht për vijimin e konfiskimit dhe shitjes së pasurisë nuk respektohet, kur ATV vëren se mbledhja e tatimit është në rrezik dhe taksapaguesi përpiqet të tjetërsojë pasuritë e tij, të ulë vlerën e tyre apo kërkon të largohet nga vendi. Në këto raste, ATV mund të dërgojë njoftim dhe kërkesë për pagesën e menjëhershme të detyrimit. Nëse sërish detyrimi tatimor nuk paguhet plotësisht, ATV ka kompetencë të bëjë sekuestrimin e pasurive, pavarësisht nga afatet e parashikuara më lart në lidhje me urdhrin e sekuestrimit.

ii. Pasuritë mbi të cilat nuk shtrihet e drejta e sekuestrimit

Pasuritë e taksapaguesit, të cilat nuk mund të sekuestrohen dhe shiten me qëllim arkëtimin e detyrimit tatimor, janë ato të përcaktuara në nenin 529 të Kodit të Procedurës Civile, si më poshtë:

- Sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij, si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiliet, për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
- Ushqimet dhe lëndët djegëse, që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
- Dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
- Librat, veglat muzikore, mjetet e artit, që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
- Deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljet e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
- Ndihamat që u jepen nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit apo familjare, ose bursa e studimit, përveçse kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast, nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose bursës;
- Frutat natyrore, një muaj para se ato të piqen.

iii. Shitja e pasurisë së sekuestruar

Shitja e pasurisë së sekuestruar kryhet brenda një afati pesëmbëdhjetëditor, duke filluar nga:

- Dita e marrjes së njoftimit të sekuestrimit nga ana e taksapaguesit, pra 40 ditë nga data e dorëzimit të njoftimit pranë shërbimit postar nga ana e ATV dhe nëse taksapaguesi nuk e ka paguar ndërkohë detyrimin tatimor apo nuk ka ushtruar të drejtat e tij për ankim në rrugë administrative dhe gjyqësore; ose
- Nëse taksapaguesi ka ushtruar të drejtat e tij për të ankimuar aktin, në përfundim të procedurave të ankimit administrativ, kur ka një vendim në favor të ATV apo kur vendimi i organeve gjyqësore merr formë të prerë dhe është në favor të ATV.

Shitja e pasurisë së konfiskuar kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit “Për ankandin publik” dhe ATV është organi përgjegjës për realizimin e ankandit brenda këtyre parashikimeve.

Në përfundim të procesit të shitjes, të ardhurat nga shitja përdoren për:

- Shpenzimet për zhvillimin e ankandit;
- Detyrimet e njoftuara taksapaguesit;
- Kostot administrative në lidhje me marrjen e masave të sigurimit, sekuestrimit, vlerësimit, transportit, publikimit, në lidhje me pasuritë e shitura.

Kur vlera nga shitja është më e madhe se shuma e detyrimit të papaguar, surpluset i kthehen taksapaguesit brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të arkëtimit të parave të përftuara nga shitja, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Nëpërmjet depozitimit të shumës në llogarinë bankare të taksapaguesit, pasi të jetë njoftuar për vlerën shtesë të siguruar nga shitja dhe i janë kërkuar të dhënat bankare ku mund të bëhet kalimi; ose
- Në mungesë të një llogarie bankare, në njërin nga banka në vendbanimin/selinë e taksapaguesit, në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

Afatet dhe procedurat e mësipërme nuk zbatohen në rastet kur mallrat e konfiskuara, për nga natyra e tyre, mund të prishen deri në momentin e shitjes. Në këto raste, ATV bën shitjen e menjëhershme të tyre me çmime tregu dhe arkëton vlerën për efekt të shlyerjes së detyrimit tatimor të papaguar.

8.2.9 Transferimi i detyrimit tatimor te palët e treta

Nëse pas përfundimit të procedurave operacionale të përmendura më sipër, përfshirë edhe veprimet e shitjes së sendeve të sekuestruara, nuk arrihet të arkëtohet detyrimi tatimor i papaguar, apo nuk është e mundur që të ndërmerren masat e parashikuara në ligjin e procedurave tatimore, parashtruar më lart në këtë Manual, ATV ka të drejtë që, nëpërmjet strukturave të mbledhjes, të kërkojë përmbushjen e këtij detyrimi edhe nga personat e tretë, përmes transferimit të detyrimit të taksapaguesit te këta persona.

Personat e tretë, të cilëve administrata tatimore u transferon detyrimin, konsiderohen ata persona që, gjatë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve kundrejt një taksapaguesi, kanë përfituar prej tij pasuri të ndryshme. Pasuritë e përfituara mund të jenë si sende të luajtshme, ashtu edhe të paluajtshme.

Për të transferuar detyrimin, duhet që detyrimi tatimor i taksapaguesit të mos jetë arkëtuar plotësisht edhe pas shitjes së pasurive të tij.

i. Personat te të cilët mund të transferohet detyrimi

Persona të tretë, në kuptim e kryerjes së kësaj procedure, konsiderohen sa më poshtë:

- Përfituesit nga transferimi i pasurive të taksapaguesit deri në 3 vjet para datës së nxjerrjes së urdhrit të sekuestrimit dhe me vlerë dukshëm më të vogël se vlera e tregut, të cilët përgjigjen deri në diferencën midis vlerës së tregut dhe pagesës së kryer;
- Të gjithë përfituesit nga transferimi i pasurive të taksapaguesit pas nisjes së procedurave të mbledhjes me forcë e deri në vlerën e pasurisë së transferuar;
- Ortakët/aksionarët e taksapaguesit person juridik, ekzistues në këtë cilësi në datën e njoftimit të detyrimit e në vijim, të cilët në rastet e abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë, përgjigjen sipas rregullave në vijim;
- Administratori i taksapaguesit person juridik, ekzistues në këtë cilësi në datën e njoftimit të detyrimit e në vijim, i cili përgjigjet sipas rregullave në vijim.

Në lidhje me sa më sipër, është e rëndësishme të theksohet rëndësia e kryerjes së një analize të hollësishme të informacionit në lidhje më palët e treta dhe plotësimit të kushteve ligjore për transferimin e detyrimit. Në këto raste përmendim verifikimin e situatës së ortakëve/aksionarëve dhe administratorit të personit juridik për identifikimin dhe trajtimin e çështjeve të solidaritetit në pagesën e detyrimit dhe vlerës për të cilën këto palë janë përgjegjëse.

Legjislacioni tatimor¹ u referohet kriterëve të vendosura nga neni 16 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, i cili rregullon rastet e abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë tregtare. Sipas këtyre përcaktimeve, ortaku, aksionari, administratori apo anëtar i këshillit të administrimit të shoqërive tregtare, apo përfaqësuesi i tyre, i cili, me veprimet apo mosveprimet e tij, i siguron vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje, është përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, përfshi autoritetet publike, me pasurinë e tij për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë kur:

- a) Ka abuzuar me formën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare;
- b) Ka trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tij/të saj personale; ose
- c) Në çastin kur ka marrë dijeni apo duhet të kishte marrë dijeni që shoqëria

¹ Neni 99 i ligjit për procedurat tatimore.

nuk ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, nuk ndërmori masat e nevojshme, të përfshira në kompetencat e tij/të saj, sipas këtij ligji, për të mos lejuar që, në varësi të rrethanave, shoqëria të vazhdonte ushtrimin e veprimtarisë tregtare dhe/ose marrjen përsipër të detyrimeve të reja ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike.

Në këto raste, ligji përcakton se përgjegjësia personale e tyre kufizohet deri në vlerat e përcaktuara në vijim:

- a) Në rastin e parashikuar në shkronjën "a", deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë;
- b) Në rastin e parashikuar në shkronjën "b", deri në vlerën e tregut të pasurive të shoqërisë tregtare, të cilat i ka trajtuar si të ishin pasuritë e tij/të saj personale;
- c) Në rastin e parashikuar në shkronjën "c", deri në vlerën e përgjithshme të detyrimeve të papaguara të shoqërisë, të cilat kanë lindur pas marrjes dijeni për gjendjen e shoqërisë.

Është shumë e rëndësishme të kihet parasysh se këta persona mbajnë përgjegjësi personale vetëm nëse kryerja e shkeljeve lidhet me abuzimin me detyrën dhe nëse vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Nëse këto shkelje kryhen së bashku prej personave të sipërpërmendur, atëherë këta përgjigjen në mënyrë solidare.

Në rastet e abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë, ortakët, aksionarët dhe administratorët e personave juridikë vazhdojnë të jenë përgjegjës për pagesën e detyrimit të papaguar të taksapaguesit, kur nuk ka qenë e mundur që detyrimi të arkëtohet pas përfundimit të procesit të sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes, ose të likuidimit apo falimentimit të personit juridik.

ii. Njoftimi i transferimit të detyrimit

ATV ka detyrimin ligjor për t'i njoftuar çdo personi të tretë detyrimin tatimor të transferuar. Njoftimi duhet ta sqarojë personin e tretë se tek ai është transferuar detyrimi tatimor i një taksapaguesi, nga i cili ky person ka përfutur pasuri gjatë periudhës së sekuestrimit të pasurive të taksapaguesit debitor. Njoftimi i këtij detyrimi bëhet gjithmonë me shkrim dhe në përputhje me parashikimet dhe afatet e përmendura më lart, në lidhje me dërgimin e njoftimeve.

Njoftimi përmban të dhënat e detyrueshme si më poshtë:

- Emrin e personit fizik, personit juridik apo individit, të cilit i transferohet detyrimi;
- NUIS apo numrin personal të identifikimit, sipas rastit;
- Selinë e regjistruar apo adresën e vendbanimit të tij;
- Shumën e detyrimit që i transferohet atij si detyrim tatimor;
- Vlerësimin e shumës që i takon të paguajë dhe se ku është mbështetur ATV për llogaritjen e saj;
- Pasurinë e përfituar prej tij nga taksapaguesi debitor gjatë periudhës së procedurave të sekuestrimit të pasurisë së taksapaguesit debitor;
- Afatin e pagimit të kësaj shume në favor të administratës tatimore;
- Bankën dhe numrin e llogarisë se ku do të kryejë pagesën;
- Emrin tregtar apo emrin e regjistruar të taksapaguesit, detyrimi i të cilit nuk është arkëtuar edhe pas shitjes së pasurive të tij;
- NUIS apo numrin personal të identifikimit të taksapaguesit debitor;
- Selinë e regjistruar apo adresën e taksapaguesit debitor.

Si afat maksimal i pagesës së shumës së detyrimit tatimor, që u transferohet personave të tretë, konsiderohet dita e katërmbëdhjetë kalendarike, pas datës kur njoftimi për pagesë është marrë nga ana e këtij personi apo konsiderohet të jetë marrë (pra, dhjetë ditë nga data e dorëzimit të njoftimit pranë shërbimit postar) dhe afatet për ushtrimin e të drejtës për ankim administrativ kanë përfunduar pa u ushtruar nga taksapaguesi. Në rast se e drejta e ankimit është ushtruar nga ky i fundit, afati katërmbëdhjetëditor fillon të llogaritet nga data e vendimit të ekzekutueshëm, lëshuar nga organi administrativ apo gjyqësor në favor të ATV.

Në rast se detyrimi nuk paguhet brenda afateve të mësipërme, ATV fillon zbatimin e procedurave operacionale ndaj palëve të treta për mbledhjen me forcë të detyrimit, të përshkruara në këtë Manual sipas çdo hapi.

iii. Llogaritja e detyrimit tatimor për personin e tretë

Detyrimi tatimor që u transferohet personave të tretë bëhet mbi bazën e vlerës së tregut të pasurisë që u ka kaluar atyre. Në asnjë rast, detyrimi për personin e tretë nuk mund të llogaritet më shumë sesa vlera reale e tregut për pasurinë e përfituar prej tij. Për të llogaritur vlerën e tregut, ATV mund të mbështetet: në aktet ligjore apo nënligjore, të cilat përcaktojnë çmime referuese në lidhje me pasurinë; në të dhëna që mund të marrë prej INSTAT; në të dhëna që ajo disponon prej taksapaguesve të tjerë për të njëjtin transaksion të kryer në kushte dhe vend të njëjtë me atë që ka kryer taksapaguesi dhe personi i tretë; në çmimet që vetë administrata tatimore mund të nxjerrë nga hulumtimi i tregut etj.

Nëse detyrimi tatimor i transferohet një të treti, struktura e mbledhjes kryen të gjitha veprimet e parashikuara në ligjin për procedurat tatimore dhe në udhëzimin në zbatim të tij. Personi i tretë, të cilit i është transferuar detyrimi tatimor, konsiderohet si taksapagues debitor dhe njoftohet për transferimin e këtij detyrimi si më sipër, ku arsyetohet qartazi shkaku pse detyrimin tatimor i është transferimit atij.

8.2.10 Kërkesa e detyrimeve nga palë të treta

Kur ka dijeni që palë të treta kanë për të paguar shuma të caktuara në favor të taksapaguesit debitor, si pjesë e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, ATV mund të kërkojë nga këta persona që detyrimet e tyre monetare kundrejt tatimpaguesit t'i derdhin në favor të saj. Për të kryer këto pagesa në favor të administratës tatimore, palët e treta duhet të njoftohen prej kësaj të fundit me shkrim dhe detyrimi i pagesës, nga ana e të tretit nga i cili kërkohet detyrimi, fillon brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes së njoftimit, por jo më vonë sesa dyzet ditë nga dorëzimi i njoftimit pranë shërbimit postar nga organit tatimor. Akti i njoftimit është gjithashtu i ankimeshëm në përputhje me dispozitat në fuqi, ndaj, në llogaritjen e afateve, duhet të mbahen parasysh edhe afatet gjatë të cilave taksapaguesi ka ushtruar të drejtën për ankim administrativ apo gjyqësor e deri në daljen e një vendimi përfundimtar të ekzekutueshëm në favor të ATV në lidhje me këtë ankim.

8.3 Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit

Procedurat për mbledhjen e një detyrimi tatimor të papaguar fillojnë menjëherë me përmbushjen e kushteve ligjore të lartpërmendura. Me gjithë përparësinë dhe efektivitetin që ka nisja e menjëhershme e procedurave të mbledhjes, zbatimi i tyre në çdo rast mund të fillojë brenda një periudhe pesëvjeçare nga data kur detyrimi tatimor duhej të paguhej. Nëse këto pesë vite kalojnë, ATV humb të drejtën për të nisur procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, si pasojë e përmbushjes së afateve ligjore të parashkrimit të detyrimit.

Afati i parashkrimit si më lart, lidhur me të drejtën e ATV për zbatimin e procedurave për mbledhjen me forcë të detyrimit, pezullohet vetëm për periudhat kohore gjatë të cilave ka ndodhur njëra apo disa nga ngjarjet e mëposhtme:

- Periudha kohore kur detyrimi tatimor është kundërshtuar nga ana e taksapaguesit, ku merret në konsideratë periudha e kohës nga data kur taksapaguesi ka paraqitur një ankim në organin administrativ dhe deri në përfundimin e shqyrtimit të ankimit të tij në rrugë gjyqësore, nëse kjo e drejtë është ushtruar nga taksapaguesi;
- Kur detyrimi tatimor është objekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga ana e ATV, ku afati ndërpritet për periudhën duke filluar nga data në të cilën administrata tatimore ka marrë një vendim që për detyrimin tatimor të zhvillojë kontrollin apo të ketë nisur një hetim tatimor e deri në përfundimin e tij;
- Kur detyrimi tatimor është objekt i një çështjeje penale, ku afati ndërpritet nga data kur organi përkatës ka regjistruar fillimin e procedimit penal dhe deri në ditën kur çështja penale është mbyllur me një vendim të vlefshëm e të formës së prerë të organit të ndjekjes penale apo të gjykatës që ka shqyrtuar çështjen.

8.4 Ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor

Struktura e mbledhjes i ndërpret procedurat e mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar apo të padeklaruar në rast se:

- Taksapaguesi e ka paguar të gjithë detyrimin e tij tatimor;
- Nga ana e autoriteteve të autorizuara nga ligji i procedurave tatimore është vendosur dhe shpallur detyrimi tatimor si i pambledhshëm, ku si afat i ndërprerjes shërben data e nxjerrjes së aktit për deklarimin e detyrimit si të pambledhshëm, afat i cili evidentohet dhe regjistrohet në dosjen e taksapaguesit;
- Tatimet janë falur me ligj nga Kuvendi;
- Ka mbaruar afati i parashkrimit, pra kur kanë kaluar pesë vjet nga data kur detyrimi tatimor duhej paguar, përfshirë shtesat kohore në rastin e ngjarjeve të përmendura më lart, në pikën 8.3.

8.5 Mosvijimi i procedurave të mbledhjes me forcë në rast ankimi

Procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve nuk mund të vijojë, nëse taksapaguesi ka ankimuar në rrugë administrative e gjyqësore dhe nuk ka një vendim të formës së prerë.

Në mënyrë më të detajuar, legjislacioni parashikon shprehimisht që, nëse taksapaguesi ka paraqitur ankim administrativ, procedurat e mbledhjes me forcë fillojnë vetëm me përfundimin e procedurave të ankimit (shih Seksionin 7, Apelimi tatimor).

8.6 Fillimi i procesit të falimentimit

Administrata tatimore vendore mund të kërkojë në gjykatën e falimentimit nisjen e procedurës së falimentimit për taksapaguesit, bazuar në dispozitat e ligjit për falimentimin.¹

RAST STUDIMOR

Procedurat e mbledhjes me forcë

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "X" shpk, edhe pas marrjes dijoni në mënyrë të rregullt të vlerësimit tatimor dhe kërkesës për pagesë, edhe pas përfundimit të afateve kohore për paraqitjen e ankimit administrativ apo gjyqësor, nuk ka bërë ankim dhe nuk ka paguar detyrimet e saj pranë bashkisë Y.

Drejtoria vendore e taksave e bashkisë Y fillon procedurat e mbledhjes me forcë, duke u dërguar bankave të nivelit të dytë urdhrin për bllokimin e llogarive të administratorit të shoqërisë "X" shpk.

Procedura e ndjekur në këtë rast nuk është kryer në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Fillimisht, administrata tatimore duhet të përpiqet të kërkojë mbledhjen e detyrimit me forcë ndaj subjektit taksapagues, i cili në rastin konkret është shoqëria "X" shpk. Shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar (dhe ato aksionare), siç tregohet nga

¹ Ligj Nr. 110/2016, "Për Falimentimin".

vetë emërtimi dhe siç përcaktohet nga dispozitat ligjore përkatëse, janë me përgjegjësi të kufizuar, pra kjo përgjegjësi mbi shoqërinë nuk u transferohet administratorëve, ortakëve apo aksionarëve të tyre, përveç rasteve kur plotësohen njëkohësisht të gjitha elementet e mëposhtme:

Administratori, ortaku apo aksionari:

- Kanë pasur këto funksione në datën e njoftimit të detyrimit tatimor;
- Kanë abuzuar me detyrën dhe/ose përgjegjësinë e kufizuar që ofron shoqëria tregtare, apo i kanë trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuri personale; ose nuk kanë marrë masat për të mos lejuar që shoqëria të vazhdonte veprimtarinë tregtare, duke marrë përsipër detyrime ndaj palëve të treta, përfshirë autoritetet publike.
- Nëse abuzimi me detyrën është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Është tepër e rëndësishme të kihet parasysh se administrata tatimore mund të kërkojë transferimin e detyrimeve tatimore të shoqërisë të këto subjekte dhe pagesën e detyrimeve prej tyre, jo me iniciativën e saj apo duke u bazuar te një vlerësim i saj, por vetëm nëse abuzimet e tyre vërtetohen me vendim gjyqësor të formës së prerë!

Pra, në rastin konkret, nëse nuk ka pasur vendim gjyqësor që vërteton abuzimin me detyrën, administrata tatimore duhet të lëshonte urdhër bllokimi bankar, vetëm për llogaritë bankare të shoqërisë dhe jo të administratorit, ortakut apo aksionarit të shoqërisë.

9. Llojet e taksave vendore dhe lehtësitë ligjore

Në mbledhjen e të ardhurave tatimore ndikojnë një sërë faktorësh, që mund të ulin nivelin e parashikuar të mbledhjes. Lehtësitë ligjore që përfitojnë taksapaguesit ndikojnë duke zvogëluar të ardhurat që do të mblidhen në të ardhmen nëpërmjet përjashtimeve apo uljeve nga taksa të caktuara, apo nëpërmjet shtyrjes në kohë të mbledhjes së këtyre të ardhurave, si pasojë e nënshkrimit të marrëveshjeve të pagesës me këste të detyrimeve.

9.1 Përjashtimet

i. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme¹

Me vendim të Këshillit Bashkiak, sipas rregullave të përbashkëta, miratohet përjashtimi nga detyrimi për këtë taksë për:

- Personat që kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- Taksapaguesit që i është dëmtuar prona nga veprimi i forcave madhore. Në raport me dëmin e shkaktuar, taksapaguesi përjashtohet deri në 75% të taksës. Vlen të përmendet se përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja mbetet të përcaktohet po me vendim të Këshillit Bashkiak.

ii. Taksa mbi ndërtesat

Përjashtohen nga kjo taksë:

- Pronat e shtetit dhe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, përdorimi i të cilave bëhet vetëm për qëllime jofitimprurëse;
- Pasuritë në pronësi të shtetit nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

¹Trajtohet në mënyrë të hollësishme në Seksionin 10.

- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- Banesat sociale në pronësi të bashkive, si dhe ato në pronësi të subjekteve juridike apo fizike, që, në bazë të marrëveshjeve me bashkitë, përdoren si banesa sociale;
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare në funksion të veprimtarisë së tyre;
- Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me 4 dhe 5 yje, status special”¹ dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht si “brand name”;
- Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

iii. Taksa mbi tokën bujqësore

Përfshihen të gjitha tokat bujqësore për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes me kultura drufrutor dhe vreshtari.

iv. Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Përfshihen nga kjo taksë:

- Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status “special”², që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht si “brand name”;
- Investimet e subjekteve, që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”³.

v. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Përfshihen nga kjo taksë:

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe njësitë e vetëqeverisjes

¹ Sipas përcaktimit në legjislacionin në fushën e turizmit.

² Sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit.

³ Sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

vendore e qendrore;

- Personat që janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake¹;
- Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
- Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste, dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak që është i përjashtuar nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi i paguan agjentit të taksave pjesën që i takon.

vi. Taksat e përkohshme vendore

Përjashtohen nga të gjitha taksat me karakter të përkohshëm antenat e telefonisë celulare, si dhe çdo antenë tjetër transmetimi.

9.2 Uljet

Këshilli vendor ka të drejtën të ndryshojë nivelin e taksës së pasurisë së paluajtshme në kufijtë +/- 30% të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse. Aktualisht, uljet nga nivelet e përcaktuara me ligj të taksave vendore mund të bëhen vetëm për taksën mbi pasurinë e paluajtshme, përmbledhur si më poshtë:

Lloji i taksës	Ulja	Përfituesi i përjashtimit
Taksa mbi tokën bujqësore dhe ndërtesën ⁴⁴	Deri në 30%	Pronari i pasurisë në nënndarjen zonale të NJVV që vendos uljen
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme ⁴⁵	Deri në 75%	Rastet e dëmtimit të pasurisë nga veprimi i forcave madhore

¹ Sipas Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".

⁴⁴ Neni 21, Pika 3 e Ligjit 9632, i ndryshuar.

⁴⁵ Neni 21, pika 5b e Ligjit 9632, i ndryshuar.

9.3 Marrëveshja e pagesës me këste

i. Nënshkrimi

Marrëveshja e pagesës me këste e detyrimit tatimor fillohet nga taksapaguesi, për shkaqe që kanë të bëjnë me pamundësinë e përkohshme financiare.

Kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor duhet:

- Të bëhet me shkrim;
- T'i drejtohet titullarit të NJVV;
- Të paraqesë rrethanat në të cilat ndodhet taksapaguesi, që konfirmojnë paaftësinë e tij për të paguar;
- Arsyet përse kërkon ta lidhë këtë marrëveshje.

Brenda dhjetë ditësh nga data e kërkesës, bashkia apo NJVV duhet të pranojë apo refuzojë kërkesën. Kohëzgjatja e marrëveshjes së pagesës me këste nuk mund të jetë më e madhe se perioda e fundit e vitit të ardhshëm.

Nënshkrimi i marrëveshjes së pagesës me këste nuk ndërpret llogaritjen e kamatëvonesave për mospagim të detyrimeve.

ii. Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste

Marrëveshja mund të zgjidhet nga drejtori i përgjithshëm i Taksave dhe Tarifave Vendore sapo taksapaguesi nuk respekton rregullueshmërinë e pagesave të përcaktuara në marrëveshjen mes palëve. Detyrimi total duhet të paguhet nga taksapaguesi brenda tridhjetë ditëve nga data e zgjidhjes së marrëveshjes. Ditën e parë pas tridhjetë ditëve nisin procedurat e mbledhjes me forcë.

Marrëveshja e propozuar kërkon më tepër vëmendje dhe kujdes sesa propozimet vetjake të individëve taksapagues. Inspektori i mbledhjes duhet të jetë i sigurt që:

- Biznesi është në gjendje të mirë, ka vetëm probleme likuiditeti;
- Nuk do të vazhdojë të shkaktojë borxhe tatimore, të cilat nuk do jetë në gjendje t'i paguajë;

Nëse analizat financiare tregojnë se biznesi nuk është në gjendje të gjenerojë të ardhura të nevojshme për pagesën e detyrimeve tatimore aktuale dhe një shumë të arsyeshme të borxhit tatimor (20% pagesë fillestare), atëherë marrëveshja e pagesës me këste nuk është zgjedhje e përshtatshme.

10. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

10.1 Baza ligjore

Ligji Nr. 9632 i vitit 2006, "Për sistemin e taksave vendore" që përcakton llojin, shkallën dhe bazën e llogaritjes së taksës, taksapaguesit të cilët i nënshtrohen kësaj takse, kompetencat, lehtësirat dhe përjashtimet si dhe përgjegjësitë në lidhje me administrimin dhe mbledhjen së taksës;

VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i cili trajton posaçërisht konceptet, mënyrën e mbledhjes së informacionit dhe metodologjinë e llogaritjes së taksës mbi ndërtesat;

VKM Nr. 171, datë 28.3.2018, "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë", krijon institucionin që administron nga pikëpamja metodologjike dhe ligjore taksën mbi pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë edhe bazën e të dhënave. Këtë të fundit trajton edhe VKM Nr. 273, datë 16.05.2018, "Për krijimin e regjistrit qendror".

10.2 Koncepte bazë

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme nënkupton mundësinë dhe detyrimin e ATV për të taksuar pasurinë e paluajtshme që ndodhet brenda territorit ku ushtron aktivitetin, duke e llogaritur atë mbi bazën dhe formulat e paravendosura nga legjislatori qendror e lokal.

Pasuri të paluajtshme, sipas Ligjit Nr. 9632, "Për sistemin e taksave vendore", konsiderohen:

- toka bujqësore;
- trualli;
- ndërtesa.

Kjo taksë përfshin taksën mbi ndërtesën, mbi tokën bujqësore dhe truallin, e cila kategorizohet mbi atë që është:

- Statusi pronësor, sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme, dhe
- Situata reale, në lidhje me pronat e papajisura me certifikatë pronësie.

Taksapagues, në kuptimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, janë:

- Individët, vendës ose të huaj; dhe/ose
- Personat fizikë apo juridikë, vendës ose të huaj të cilët janë pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit:

- Pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo
- Përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie; apo
- Zhvilluesi, në rastin e ndërtimeve për të cilat ka përfunduar afati i ndërtimit.

Për efekt të identifikimit të taksapaguesve pronarë të pasurive të paluajtshme dhe llogaritjes së taksës mbi këto pasuri, zyra e taksave pranë NJVV përdor si burim:

- Dokumentet e vërtetimit të pronësisë sipas regjistrit të pasurive të paluajtshme;
- Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës;
- Vendimet e privatizimit;
- Dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, NJVV përcaktojnë madhësinë e sipërfaqes së pronave, bazuar në vendimin e Komisionit të Verifikimit të Pasurisë së Paluajtshme, ngritur nga vetë NJVV. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me VKB.

10.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Është shumë e rëndësishme në punën e çdo NJVV që të sigurojë bashkëpunim të mirë e të vazhdueshëm me institucionet të tjerë të cilët disponojnë informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm si për grumbullimin e të dhënave parësore mbi këto pasuri, ashtu edhe për qëllime të përputhshmërisë me procedurat për llogaritjen dhe miradministrimin e kësaj takse.

Ndër këto institucione mund të përmendim Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish-ZRPP), ALUIZNI, Agjencinë e Trajtimit të Pronave, si burim parësor të dhënash për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së, Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile, subjekte ekonomike, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike apo ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve, që kanë një bazë të gjerë klientësh dhe informacioni rreth tyre, Këshilli Kombëtar i Territorit etj. Sidoqoftë, bazuar në fluksin e informacionit, vazhdimësinë në komunikimin dhe ndihmën e domosdoshme e të detyrueshme në nivel institucional, bashkëpunimi me dy institucionet e mëposhtme rezulton të jetë thelbësor në mbarëvajtjen e punës së NJVV:

i. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe Kadastra Fiskale

Si rezultat i nevojës shumëvjeçare për miradministrimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme dhe unifikimin e të dhënave mbi këto pasuri, në vitin 2017 u vendos krijimi i një regjistri qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme ("Kadastrës Fiskale") si dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë ("DPTP") si autoriteti përgjegjës në nivel qendror për administrimin, nga pikëpamja ligjore e metodologjike, e taksës vendore mbi pasuritë e paluajtshme.

Bazuar në sa u tha më sipër, është detyrë funksionale e të gjitha NJVV që t'i drejtohen DPTP për çështje që lidhen me çdonjërin nga detyrat e saj. Bashkëpunimi me këtë institucion është domosdoshmëri, në mënyrë që të sigurohet njëkuptueshmëria nga ana e NJVV në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, të cilat lidhen me taksën mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe unifikimi i praktikave në shkallë vendi, për taksim dhe trajtim uniform të taksës mbi pasuritë e paluajtshme në të gjithë territorin e vendit.

ii. Agjencia Shtetërore e Kadastrës

Regjistri publik i pasurive të paluajtshme, që tashmë administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ("ASHK") dhe është institucioni suksedues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI dhe AITTP, është sot burimi

parësori i të dhënave në lidhje me këto pasuri.

Të dhënat që disponon ASHK i shërbejnë ATV si për verifikimin e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme të mbledhura në kuadër të vetëdeklarimit nga ana e taksapaguesve, ashtu edhe për identifikimin e të dhënave të mëtejshme, të cilat mund të ndikojnë në llogaritjen e vlerës së taksës, siç janë shitblerjet e pasurive apo rivlerësimet e tyre.

Në kuadër të parashikimeve të Ligj Nr.9632,“Për sistemin e taksave vendore”,ASHK ka detyrimin ligjor të vendosë në dispozicion të NJVV, në baza tremujore dhe pa kundërshpërblim, të dhënat që disponon në lidhje me pasuritë e paluajtshme apo ndryshimet e ndodhura në harkun kohor mes këtyre komunikimeve periodike.

Komunikimi me këtë agjenci është i rëndësishëm, sepse, pas krijimit të saj, ajo disponon të dhëna të regjistrit të pasurive të paluajtshme - edhe të dhëna për pronat e legalizuara dhe/ose në proces legalizimi që më parë administroheshin nga ALUIZNI - si dhe të inventarit të pronave publike nga AITTP.

10.4 Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore paguhet nga:

- Pronari/bashkëpronari, i cili disponon dokumentet e pronësisë; apo
- Përdoruesi i tokës bujqësore në mungesë të dokumenteve të pronësisë dhe në përputhje me vetëdeklarimin e kryer nga ky i fundit pranë NJVV ku ndodhet toka.

Nivelet treguese të taksës mbi tokën bujqësore shprehen në “Lekë për hektar” dhe përcaktohen në bazë të të dhënave të Aneksit 1 të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar sipas:

- Kategorive të përcaktuara në bazë të vendndodhjes dhe grupimeve sipas bashkive; si dhe
- Kategorisë së tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Në kuadër të përcaktimit të nivelit tregues të taksës, është e rëndësishme të verifikohet nëse për NJVV janë zbatuar ndryshime nëpërmjet VKB në fuqi mbi sa vijon:

- Nivelin tregues bazë të taksës për kategoritë minimale në nivel NJVV në kufijtë +/- 30% të niveleve treguese;
- Nivelin tregues bazë të taksës për nënkategoritë e miratuara nëpërmjet VKB.

Zyra e taksave bashkëpunon me zyrën që trajton çështjet e bujqësisë në bashki dhe, veç kësaj, ato shkëmbejnë informacion mbi pronësinë, dhënien në përdorim të tokës bujqësore, sipërfaqet, klasifikimin sipas bonitetit etj.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore e shprehur në hektar dhe e përcaktuar sipas dokumenteve të pronësisë apo vetëdeklarimit të përdoruesit, në mungesë të dokumenteve të pronësisë. Mbi sipërfaqen zbatohen nivelet treguese të taksës, të evidentuara si më lart.

Detyrimi për taksën është vjetor. Është e nevojshme të verifikohet, përpara procedurave të njoftimit, nëse për taksapaguesin janë të zbatueshme përjashtime apo lehtësira, bazuar në dispozitat e Ligj 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Me vendim të Këshillit Bashkiak përcaktohet numri i kësteve, afati i pagesës, si dhe kushtet lehtësuese, në rastin e pagesës së plotë dhe para afateve.

Në përfundim të përlllogaritjeve dhe verifikimeve për përjashtime dhe/ose lehtësira të mundshme në pagesën e taksës, përgatitet Njoftimi i Vlerësimit Tatimor, i cili hartohet dhe i dërgohet taksapaguesit, në përputhje me udhëzimet e paraqitura në kreun ku trajtohen me hollësi procedurat e njoftimit të detyrimit.

10.5 Taksa mbi truallin

Taksa mbi truallin paguhet nga:

- Pronari/bashkëpronari, i cili disponon dokumentet e pronësisë; apo
- Përdoruesi i truallit, në mungesë të dokumenteve të pronësisë dhe në përputhje me vetëdeklarimin e kryer nga ky i fundit pranë NJVV ku ndodhet trualli (jo hapësirë publike).

Nivelet treguese të taksës mbi truallin shprehen në "Lekë për metër katror" dhe përcaktohen në përputhje me parashikimet e Aneksit 2 të Ligj 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar në varësi të:

- Kategorive sipas grupimit të bashkive; si dhe
- Përdorimit të truallit.

Për qëllime të sa më sipër, termi “përdorim” i truallit përfshin nënndarjet e mëposhtme:

- Përdorim për qëllime banimi nga individët; ose
- Përdorim për qëllime biznesi.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e tij e shprehur në metër katror dhe e përcaktuar sipas dokumenteve të pronësisë apo vetëdeklarimit të përdoruesit, në mungesë të dokumenteve të pronësisë. Mbi sipërfaqen zbatohen nivelet treguese të taksës, të evidentuara si më lart, në varësi të vendndodhjes dhe përdorimit.

Zyra e taksave bashkëpunon me zyrën e urbanistikës në bashki. Mbi bazën e PPV përcaktohet trualli urban, që është sipërfaqja e cila i nënshtrohet kësaj takse. Më tej, ky informacion plotësohet me të dhëna rreth pronarit apo përdoruesit, si subjekte detyruese për pagesën e taksës mbi truallin urban.

Detyrimi për taksën është vjetor. Është e nevojshme të verifikohet, përpara procedurave të njoftimit, nëse për taksapaguesin janë të zbatueshme përjashtime apo lehtësira, bazuar në dispozitat e Ligjit 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe VKB në fuqi.

Në përfundim të përlllogaritjeve dhe verifikimeve për përjashtime dhe/ose lehtësira të mundshme në pagesën e taksës, përgatitet Njoftimi i Vlerësimit Tatimor, i cili hartohet dhe i dërgohet taksapaguesit, në përputhje me udhëzimet e paraqitura në kreun ku trajtohen me hollësi procedurat e njoftimit të detyrimit.

10.6 Taksa mbi ndërtesën

Për qëllime të taksës mbi ndërtesën, termi pasuri e paluajtshme “ndërtesë” përfshin objektin apo objektet e ndërtuara mbi apo nën sipërfaqen e tokës dhe/ apo të lidhura me tokën, të cilat përfaqësojnë një strukturë ndërtimore me një apo më shumë njësi pronësore.

Njësia pronësore përbëhet nga ndërtesa apo pjesë të ndërtesës dhe është e ndarë ligjërisht nga prona të tjera të tipit pasuri e paluajtshme “ndërtesë”.

Njësia pronësore mund të përdoret tërësisht vetëm për qëllime banim apo tërësisht vetëm për veprimtari tregtare, por edhe për të dyja qëllimet ku:

- Ndarja e njësisë pronësore për banim përfaqëson pjesën e saj që përdoret për banim; dhe
- Ndarja e njësisë pronësore për veprimtari tregtare përfaqëson pjesën e saj që përdoret për veprimtari tregtare.

Taksapagues i taksës mbi ndërtesën konsiderohet çdo individ, person fizik ose juridik, vendës apo i huaj, pronar apo përdorues i pasurisë së paluajtshme të tipit “ndërtesë” të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht prej nivelit të shfrytëzimit të ndërtesës apo njësisë pronësore.

Taksa mbi ndërtesën paguhet, sipas rastit, nga:

- Pronari/bashkëpronari i ndërtesës/njësisë pronësore, i cili disponon dokumentet e pronësisë;
- Personat që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtesës/njësisë pronësore;
- Përdoruesi i ndërtesës/njësisë pronësore, në mungesë të dokumenteve të pronësisë;
- Zhvilluesi, në rastin e ndërtimeve jashtë afatit të lejes së ndërtimit, të cilat nuk janë vënë në përdorim apo nuk janë transferuar te të tretët.

“Përdorues”, në kuptimin e identifikimit të taksapaguesit subjekt të taksës mbi ndërtesën, është individ, personi fizik apo personi juridik që zotëron, apo sillet si i tillë, ndërtesën/njësinë pronësore dhe e përdor atë për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo joekonomike, por nuk disponon ende dokumentet e pronësisë.

Për këto raste, është thelbësor identifikimi i taksapaguesit të saktë, në mënyrë që detyrimi t’i drejtohet personit të duhur. Taksapaguesi nuk mund të identifikohet me personin fizik apo juridik (personi i tretë), i cili merr me qira apo në përdorim ndërtesën nga Përdoruesi (ose ndryshe poseduesi/zotëruesi). Personat e tret, që hyjnë në marrëdhënie qiramarrjeje, huapërdorjeje etj. me Përdoruesin, mund të paguajnë detyrimin për llogari të këtij të fundit vetëm në rastet e mëposhtme:

- Me vullnet të lirë nga ana e individit, personit fizik apo personit juridik, i cili ka marrë me qira apo në përdorim pa kundërshtpërblim (huapërdorje) ndërtesën;
- Nëse është rënë dakord mes palëve në një marrëveshje të shkruar;
- Në kuadër të kërimit të detyrimit tatimor nga palët e treta, si pjesë e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor.

Fakti që personat e tretë që hyjnë në marrëdhënie me Përdoruesin (ose ndryshe poseduesin/zotëruesin) e ndërtesës/njesisë pronësore marrin përsipër të kryejnë për llogari të këtij të fundit pagesën e taksës së ndërtesës, nuk duhet të kuptohet nga ATV si arsye apo mundësi për të nxjerrë një njoftim për vlerësimin e detyrimit në emër të këtyre personave të tretë. Pavarësisht nga marrëveshjet private për pagesën mes Përdoruesit dhe personave të tretë, detyrimi për taksën gjithmonë duhet t'i drejtohet Përdoruesit (ose ndryshe poseduesit/zotëruesit) të ndërtesës/njesisë pronësore.

Pamundësia apo gabimet në identifikimin e saktë të taksapaguesit të taksës mbi ndërtesën sjellin pasojë për administratën tatimore vendore, të cilat variojnë nga mosmbledhja e detyrimit të llogaritur dhe deri në ekspozimin e ATV ndaj kostove administrative e gjyqësore, si rezultat i kundërshtimit të detyrimit nga ana e personit që i është drejtuar pa të drejtë ky detyrim.

Gjithashtu, drejtimi i detyrimit ndaj taksapaguesit të gabuar dhe ndjekja e procedurave të gjata administrative e gjyqësore për këto raste, e vendos ATV përballë rrezikut të humbjes së të drejtës së kërkimit dhe mbledhjes së detyrimit. Kjo për shkak se koha e shpenzuar për ndjekjen e procedurave të mësipërme me "taksapaguesin e gabuar" konsumon afatin pesëvjeçar për kërkimin dhe mbledhjen e detyrimit tatimor nga taksapaguesi i duhur, duke e bërë këtë detyrim të pakërkueshëm dhe të pambledhshëm nga ATV, bazuar në konceptin e parashkrimit të detyrimit tatimor, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën/njesisë pronësore është vjetor, ndërsa mënyra, kështet dhe afatet e pagesës nga ana e taksapaguesit apo nga kategori të caktuara taksapaguesish përcaktohen me VKB nga vetë NJVV.

Përpara procedurave të njoftimit, është e nevojshme të verifikohet nëse për taksapaguesin janë të zbatueshme përjashtime apo lehtësira, bazuar në dispozitat e Ligjit 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, si dhe VKB në fuqi.

Në përfundim të përlllogaritjeve dhe verifikimeve për përjashtime dhe/ose lehtësira të mundshme në pagesën e taksës, përgatitet Njoftimi i Vlerësimit Tatimor, i cili hartohet dhe i dërgohet taksapaguesit, në përputhje me udhëzimet e paraqitura në kreun ku trajtohen me hollësi procedurat e njoftimit të detyrimit.

a. Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesën shprehet në përqindje dhe detajohet në bazë të kategorisë së ndërtesës sipas përcaktimeve të mëposhtme:

Kategoria e ndërtesës	Shkalla e taksës
Për banim	0,05%
Për veprimtari tregtare	0,2%
Ndërtime jashtë afatit të lejes (pa shfrytëzuar/vënë në përdorim)	30% e shkallëve më sipër, sipas kategorisë përkatëse

Për rastet e ndërtimeve, që nuk kanë arritur të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, shkalla e taksës reduktohet në 30% të shkallës sipas kategorive të ndërtesës, pra:

- për njësitë pronësore të paracaktuara për banim = $30\% \times 0,05\% = 0,015\%$;
- për njësitë pronësore të paracaktuara për veprimtari tregtare = $30\% \times 0,2\% = 0,06\%$

Të gjitha NJVV kanë të drejtën të përcaktojnë nëpërmjet VKB ndarje apo nëndarje zonale brenda territorit të tyre për zbatimin e shkallëve të taksës brenda kufijve +/- 30% të shkallëve treguese të takës si më sipër. Nivelet e miratuara të shkallës së taksës për këto ndarje apo nëndarje zonale i komunikohen DPTP në formë zyrtare.

b. Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesën/njësinë pronësore, pra, vlera e taksueshme e saj, llogaritet si produkt i “Çmimit Vlerësues” dhe sipërfaqes së saj, ku termi “Çmim Vlerësues” përfaqëson njësinë matëse të vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme, llogaritur në përputhje me metodologjinë e detajuar në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018.

Metodologjia e llogaritjes së vlerës së taksueshme bazohet mbi prioritet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar detyruese. Baza e kësaj metodologjie është vetëdeklarimi i të dhënave nga taksapaguesi, të dhënat që u nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme nga ana e ATV, duke përdorur të dhëna të përfutuara nga burime zyrtare të besueshme apo duke zbatuar metoda alternative të vlerësimit, në mungesë të vetëdeklarimit apo informacioneve të tjera.

Radha e detyrueshme e vlerësimit të bazës së taksueshme sipas prioriteteve paraqitet si më poshtë:

(i) Vetëdeklarimi

Vetëdeklarimi është detyrim për të gjithë taksapaguesit e taksës mbi ndërtesën. Ky vetëdeklarim bëhet pranë NJVV ku ndodhet ndërtesa/njësia pronësore apo institucioneve të tjera të autorizuara nga qeveria qendrore ose vetë NJVV, për të marrë dhe përpunuar informacionin e vetëdeklaruar.

Për qëllime vetëdeklarimi mund të përdoren formularë të paracaktuar nga institucionet përgjegjëse, si p.sh., DPTP apo dhe formularë të përpunuar nga vetë NJVV, të cilët reflektojnë nevojat për informacione shtesë, i nevojshëm për qëllime të llogaritjes së bazës së taksueshme, por edhe të zbatimit të shkallës së duhur të taksës.

Vlera e taksueshme, që del nga të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi, krahasohet edhe me vlerat e dala nga mënyrat vijuese të vlerësimit për t'u përzgjedhur më pas vlera më e lartë e çmimit të vlerësuar.

(ii) Përcaktimi i çmimit, i vlerësuar sipas regjistrave të ASHK

Si metodë për vlerësimin e bazës së taksës përdoret edhe verifikimi i të dhënave me regjistrin e pasurive të paluajtshme mbajtur nga ASHK.

Të dhënat në këtë regjistër shërbejnë për të marrë informacionet e mëposhtme:

- Sipërfaqen e regjistruar të ndërtesës/njesisë pronësore;
- Rivlerësimet e kryera për ndërtesën/njësinë pronësore;
- Vlerën e shitblerjeve të ndërtesës/njesisë pronësore, kryer gjatë tri viteve të fundit.

Sipërfaqja e hedhur në këtë regjistër krahasohet me të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi. Në rast mospërputhjeje, përdoret sipërfaqja më e lartë dhe/ose verifikohet në vend sipërfaqja reale. Verifikimi kryhet në terren, mbi bazën e gjendjes fizike të ndërtesës, nga një komision i ngritur nga NJVV.

Rivlerësimet e kryera apo shitblerjet e tri viteve të fundit shërbejnë për të identifikuar vlerën e fundit të deklaruar të pasurisë. Në rast se ekziston si rivlerësimi, si shitblerja, merret në konsideratë vlera më e lartë nga të dyja.

Kjo vlerë më pas i nënshtrohet krahasimit me vetëdeklarimin nga taksapaguesi, por edhe me çmimin vlerësues, i cili bëhet në bazë të çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave si më poshtë, me qëllim përzgjedhjen e vlerës më të lartë.

(iii) Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave

Kur nuk është i mundur vlerësimi me dy metodat e mësipërme, shërben metoda e llogaritjes së çmimit të vlerësuar me bazë çmimet mesatare të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore për qëllime banimi, sipas Aneksit 1 të VKM 132, datë 07.03.2018.

Në rastet e ndërtesave për banim, çmimi i vlerësuar për qëllime të llogaritjes së taksave është i njëjtë me çmimin mesatar referues të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore, sipas Aneksit 1.

Në rastet e ndërtesave/njësive pronësore, që nuk shërbejnë për qëllime banimi, mbi çmimin mestar referues të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore për qëllime banime, sipas Aneksit 1 të VKM 132, aplikohen koeficientet e përcaktuara në Aneksin 2 të po të njëjtit vendim, ndryshuar me VKM 167, datë 27.03.2019.

Koeficientet e përcaktuara në Aneksin 2 të VKM 132 dhe 168, që aplikohen mbi çmimet mesatare të shitblerjes së ndërtesave për qëllime banimi, shërbejnë për të llogaritur një çmim të përafërt me atë të tregut për ato tipologji ndërtesash për të cilat mungojnë çmimet e referencës, si p.sh., njësi tregtare (dyqane), ndërtesa me karakter industrial, magazina etj. Për llogaritjen e bazës së taksueshme për këto tipologji ndërtesash, mund të shërbejnë si bazë krahasuese edhe të dhëna të tjera, si p.sh., vlera e tregut për shitblerjen e njësive pronësore të ngjashme në të njëjtat zona apo qytete. Mbi vlerën e ndërtesës, e llogaritur sipas tipologjisë së saj si më sipër, aplikohet shkalla e taksës në varësi të përdorimit, pra, për qëllime banimi apo për veprimtari tregtare, siç trajtohet në seksionet pararendëse.

Kështu, është e rëndësishme të bëhet diferencimi midis (i) përdorimit/shfrytëzimit të ndërtesave apo njësive pronësore për qëllime të përcaktimit të shkallës së taksës dhe (ii) tipologjisë së ndërtesave për qëllime të llogaritjes së bazës së taksës.

Shkalla e taksës përcaktohet veçmas në varësi të shfrytëzimit/përdorimit të ndërtesës/njësisë pronësore, pra, për banim apo veprimtari tregtare, duke i dhënë mundësinë ATV të ngarkojë taksapaguesin që përdor ndërtesën/njësinë pronësore për veprimtari tregtare me një shkallë takse më të lartë: me 0,2% në vend të shkallës 0,05%, e cila aplikohet për ndërtesat që shfrytëzohen për banim.

Nga ana tjetër, përdorimi i koeficienteve sipas Aneksit 2 të VKM 132 me qëllim llogaritjen e bazës së taksës për ndërtesat/njësitë pronësore jo për banim,

aplikohet vetëm për ato ndërtesa/njësi pronësore që nuk janë për banim, si rezultat i tipologjisë së tyre, dhe rrjedhimisht nuk kanë një çmim reference të përcaktuar sipas Aneksit 1 të VKM 132. Në këto raste, është e rëndësishme që ATV të identifikojë, nëpërmjet dokumenteve të pronësisë, ndërtesat që nuk shërbejnë për banim, pra dyqane, magazina, parkime/bodrume, ndërtesa industriale etj., dhe për këto të aplikojë koeficientet e përcaktuara në Aneksin 2 të VKM 132 mbi çmimet e referencës për ndërtesa banimi në po të njëjtën zonë, sipas Aneksit 1 të VKM 132.

SHEMBUJ: Taksa e ndërtesës

Një njësi pronësore që gjendet në katin e 3 të një pallati, e cila i jepet me qira nga ana e pronarit individ një personi juridik për përdorim në veprimtarinë e tij, ka tipologjinë e një "apartamenti", pra ndërtese banimi, sipas dokumenteve të pronësisë. Për të llogaritur bazën e taksës, në këtë rast duhet të përdoren çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për qëllime banimi, sipas Aneksit 1. Nga ana tjetër, shkalla e aplikueshme e taksës në këtë rast do të jetë ajo për veprimtari tregtare, 0,2%, sepse apartamenti nuk shfrytëzohet për qëllime banimi.

Një njësi pronësore që gjendet në katin përdhes të një pallati, e cila i jepet me qira nga ana e pronarit individ një personi juridik/fizik për përdorim në veprimtarinë e tij tregti/shërbime, ka tipologjinë e një "njësie shërbimi", sipas dokumenteve të pronësisë. Për të llogaritur bazën e taksës, bazuar edhe mbi tipologjinë e njësisë pronësore, në këtë rast, mbi çmimin mesatar referues të shitblerjes, sipas Aneksit 1 të VKM 132 për zonën ku ndodhet njësia pronësore, aplikohet koeficienti sipas shkronjës (a) të Aneksit 2 të VKM 132, pra për të sjellë vlerën e njësisë pronësore në një vlerë të përafërt me atë të shitblerjes së saj në tregun e lirë. Nga ana tjetër, shkalla e aplikueshme e taksës do të jetë ajo për veprimtari tregtare, 0,2%, sepse njësia pronësore shfrytëzohet për veprimtari tregtare. Në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe rastet kur njësitë e shërbimit gjenden në struktura të tipit "qendra tregtare", ku, për nga tipologjia e ndërtimit, këto njësi janë të paracaktuara të përdoren vetëm për veprimtari tregtare/shërbimi dhe rrjedhimisht baza e taksës së këtyre njësive përcaktohet duke aplikuar koeficientin sipas shkronjës (a) të Aneksit 2 dhe shkallën e taksës prej 0,2%.

Një njësi pronësore njëkatëshe e gjendur larg qendrave të banuara dhe që ka karakteristikat e një magazine, pra nuk mund të shfrytëzohet për qëllime banimi, i jepet me qira nga ana e pronarit individ një personi juridik/fizik për përdorim në veprimtarinë e tij. Në këtë rast, baza e taksës llogaritet sipas tipologjisë së ndërtesës, duke aplikuar koeficientin sipas shkronjës (ç) të Aneksit 2 të VKM 132 prej 50% e çmimit mesatar referues të shitblerjes së ndërtesave të banimit në zonën ku ndodhet njësi pronësore, për të përcaktuar kështu një vlerë të përafërt me vlerën e saj të tregut. Mbi këtë bazë të taksës aplikohet shkalla e taksës për ato njësi pronësore të cilat shfrytëzohen për veprimtari tregtare, 0,2%. Për qëllime të llogaritjes së bazës së taksës, në mënyrë të ngjashme trajtohen edhe ato ndërtesa që shfrytëzohen për aktivitete industriale, si p.sh., ndërtesat e fabrikave, njësi të prodhimit, etj., të cilat, si rezultat i tipologjisë së ndërtimit dhe vendndodhjes së tyre, kanë një vlerë tregu më të ulët se ndërtesat e banimit në zonat ku ato ndodhen apo zona të afërta.

Vlera e taksueshme e ndërtesës/njesisë pronësore e llogaritur me këtë metodë krahasohet me dy metodat pararendëse, pra çmimin e vlerësuar sipas të dhënave nga vetëdeklarimi i taksapaguesit dhe sipas të dhënave nga regjistrat e ASHK, dhe si bazë e taksës merret vlera më e lartë.

c. Vlera e taksueshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit

Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, që nuk kanë arritur të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të lejes së ndërtimit, si bazë për llogaritjen e taksës mbi ndërtesën/njesisë pronësore shërben kostoja e parashikuar e ndërtimit, sipas dokumentacionit të depozituar pranë NJVV apo KKT për qëllime të pajisjes me leje ndërtimi.

Në rastin kur ndërtesa përbëhet nga një njësi e vetme pronësore me vetëm një destinacion përdorimi, pavarësisht prej fazës në të cilën ndodhet ndërtimi, si bazë e taksës për të gjithë ndërtesën përdoret kostoja e parashikuar në lejen e ndërtimit. Mbi këtë bazë më pas aplikohet 30% i shkallës së taksës sipas përdorimit, pra për banim apo veprimtari tregtare.

Në rastet kur ndërtesa e papërfunduar, pavarësisht nga faza në të cilën ndodhet ndërtimi, përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore që kanë qëllime të ndryshme përdorimi apo do të transferohen në pronësi të më shumë se një pronari/përdoruesi, atëherë si bazë e taksës përsëri shërben kostoja e plotë e ndërtimit të të gjitha njësive. Shkalla e taksës së aplikueshme mbi këtë bazë takse

do të variojë sipas destinacionit të përdorimit të secilës njësi pronësore, pra 30% e shkallës së taksës prej 0,05% mbi koston e secilës njësi pronësore të destinuar për banim dhe 30% e shkallës së taksës prej 0,02% mbi koston e secilës njësi pronësore të destinuar për veprimtari tregtare.

Kur zhvilluesi ka lidhur kontrata për tjetërsimin e pronësisë së ndërtesës së papërfunduar po njërive pronësore që përbëjnë këtë të fundit, si bazë për efekt të llogaritjes së taksës shërbejnë kontratat e shitjes së ndërtesës apo njërive të veçanta pronësore (pra, jo më kostoja e ndërtimit). Vlerat e paraqitura në kontratat për transferimin e pronësisë, në çdo rast i nënshtrohen gjithashtu vlerësimit me çmimin vlerësues, siç detajohet në seksionet pararendëse, dhe si bazë e taksës përdoret vlera më e lartë.

Kur nga verifikimet në terren të ATV konstatohet së ndërtesa apo pjesë të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, megjithëse ndërtesa nuk ka përfunduar në tërësinë e saj, baza e taksës llogaritet e plotë për pjesën e vënë në përdorim/shfrytëzim, pra jo më me kosto, dhe shkalla e taksës aplikohet e plotë sipas kategorisë së ndërtesës/njësive pronësore, pra jo më e reduktuar në 30% të shkallës së taksës. Të njëjtat rregulla vlejné edhe nëse për ndërtesën nuk është dhënë ende leja e shfrytëzimit apo nëse nuk është bërë ende regjistrimi pranë ASHK/ZVRPP.

Bazuar në sa më sipër, taksa paguhet nga zhvilluesi, me përjashtim të rasteve kur ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim dhe kur detyrimi për pagesën e taksës i takon përdoruesit.

d. Verifikimi në terren

Të gjitha NJVV kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të kryejné verifikime në terren. Qëllimi kryesor i verifikimeve në terren është:

- Identifikimi i ndërtesave/njësive pronësore të paregjistruara më parë në regjistrin bazë të të dhënave;
- Identifikimi i ndarjeve të njësive pronësore;
- Verifikimi i ndryshimeve që ndikojné në vlerën e ndërtesës, si p.sh., shtesa, përmirësime strukturore, tjetërsim pronësie, ndryshime të përdorimit, ndryshime në statusin e përfitimit të lehtësirave/përjashtimeve nga taksa etj.;
- Korrektimi i bazës së të dhënave mbi sipërfaqen e ndërtesave.

Verifikimet kryhen në mënyrë periodike e në baza vjetore, deri në 20% të territorit të NJVV. Të dhënat e verifikimeve në terren krahasohen me të dhënat nga burime

të tjera zyrtare mbi sipërfaqen. Në mungesë të këtyre të dhënave zyrtare, vetë NJVV bën vlerësimin e ndërtesës/njesisë pronësore në bazë të sipërfaqeve të konstatuara nëpërmjet verifikimit në terren.

Nëse nëpërmjet procedurave të verifikimit në terren konstatohet ekzistenca e një ndërtese/njësie pronësore, por nuk mund të verifikohet sipërfaqja, atëherë NJVV përdor sipërfaqet e prezumuara prej:

- 100 m² për ndërtesat për banim;
- 70 m² për ndërtesat për banim, privatizuar me Ligjin Nr. 7652/1992.

Për ndërtesat që nuk shërbejnë për qëllime banimi, NJVV bën verifikimin në terren, si për të përcaktuar sipërfaqen, ashtu edhe për të llogaritur bazën e taksës. Verifikimi në terren shërben edhe për të identifikuar/konstatuar dëmtime të ndërtesave si rezultat i fatkeqësive natyrore, që ndikojnë në vlerën e kësaj pasurie. Në këto raste, vlerësimi dhe korrektimi i ndërtesës bëhet nëpërmjet ngritjes së një komisioni të posaçëm, duke marrë për bazë gjendjen fizike të ndërtesës/njesisë pronësore të dëmtuar.

Procedura e verifikimit në terren kryhet me urdhër të titullarit të NJVV dhe i njoftohet taksapaguesit me postë apo dorazi, kundrejt firmës së taksapaguesit. Në rast të dërgimit në rrugë postare, urdhri konsiderohet të jetë marrë pas dhjetë ditëve të dorëzimit të tij në zyrën postare. Urdhri përmban të dhënat e detyrueshme si më poshtë:

- Të dhënat identifikuese të pronës dhe të taksapaguesit;
- Objektin e procedurës së verifikimit;
- Arsyet e kryerjes së procesit të vlerësimit;
- Kohën kur do të kryhet verifikimi dhe afatin e mundshëm;
- Emrat e punonjësve të NJVV që do të përfshihen në proces
- Datën dhe orën kur punonjësit e NJVV do të paraqiten;
- Të drejtat e taksapaguesit për të shprehur mendimet, vërejtjet apo kundërshtitë lidhur me procesin;
- Informacionin mbi përdorimin e metodave alternative të vlerësimit në mungesë të mundësisë së verifikimit.


Në rast të mosgjendjes së taksapaguesit pas dërgimit të njoftimit të parë, sipas detajeve të përcaktuara, NJVV bën një njoftim të dytë dhe, nëse përsëritet e njëjta situatë apo ka mungesë bashkëpunimi nga ana e taksapaguesit, NJVV procedon duke përdorur metoda alternative në vlerësimin e detyrimit.

Çdo verifikim në terren duhet të dokumentohet nga ana e punonjësit(ve) të NJVV si më poshtë:

- Nëpërmjet mbajtjes së një Akti Verifikimi për verifikimet e kryera;
- Nëpërmjet një Procesverbali, nëse konstatohen ndërtesa për të cilat nuk ka informacion.

Në rast se mbahet një Akt Verifikimi, nëpunësit e NJVV kanë për detyrë të informojnë taksapaguesin mbi gjetjet, duke ia lexuar këtij të fundit me zë përmbajtjen e aktit dhe, në përfundim të procesit, t'i kërkojnë nënshkrimin, duke përfshirë orën dhe datën kur ai ka nënshkruar aktin. Nga ana tjetër, taksapaguesi ka të drejtë të bëjë vërejtje apo të shprehë kundërshtitë e tij me shkrim në aktin e verifikimit.

Në vijim paraqitet një bllok-skemë me hapat e procedurës së verifikimit në terren:



Në rastin e mbajtjes së procesverbaleve për konstatimet e ndërtesave për të cilat nuk ka informacion, nëpunësi i NJVV ka detyrën ta plotësojë këtë akt me të dhënat e mëposhtme:

- Adresën, koordinatat e vendndodhjes gjeografike, sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore;
- Qëllimin e përdorimit të ndërtesës/njesisë pronësore;
- Të dhënat identifikuese të siguruara për taksapaguesin;
- Emrin/emrat e punonjësve të NJVV që kanë bërë verifikimin;

- Datën dhe orën kur punonjësit e NJVV kanë bërë verifikimin;
- Çdo informacion tjetër të nevojshëm, që shërben për identifikimin e ndërtesës/njesisë pronësore, taksapaguesin dhe përcaktimin e bazës së taksueshme.

Në këtë rast, taksapaguesi duhet të njoftohet për detyrimin e taksës së llogaritur. Nëpunësi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme ka të drejtën dhe detyrimin të kryejë rishikimin dhe verifikimin e dokumentacionit të mbledhur si rezultat i procedurave të verifikimit në terren, si më poshtë:

Çfarë verifikohet?	→	Dokumentacioni dhe akti i verifikimit në terren
Kush verifikon dhe konfirmon?	→	Nëpunësi për taksën e pasurisë së paluajtshme
Cili është objekti i verifikimit?	→	Gabimet, mangësitë, pasaktësitë
Pasojat në rast vërejtjesh	→	Rishikim i aktit dhe/ose përsëritje e procedurës
Në mungesë të vërejtjeve	→	Konfirmim i aktit nga nëpunësi

Të gjitha Aktet e Verifikimit në terren hidhen në sistemin bazë të të dhënave jo më vonë së tridhjetë ditë nga data e aktit. Të gjitha aktet që ndikojnë në ndryshimin e detyrimit tatimor janë efektive nga momenti i konstatimit e në vijim, pa efekt prapaveprues.

e. Korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës së ndërtesës në rastet e saktësisht të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, qëllimin e përdorimit dhe çmimet përkatëse

Taksapaguesi ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë nuk është bërë në përputhje me parashikimet e VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa', e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", apo kur ky vlerësim ka pasaktësi për sa u takon të dhënave të përdorura.

Pasi merr njoftimin e detyrimit për taksën e ndërtesës, taksapaguesi, nëse nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës:

- Në Drejtorinë/Zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore të NJVV-së, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme “ndërtesë”;
- Në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra shërbimi i korigjimit ofrohet nga NJVV me punonjësit e saj.

Për të disiplinuar dhe unifikuar procedurat e korigjimit, taksapaguesit plotësojnë një formular tip, formati i të cilit përcaktohet nga vetë NJVV. Formulari i plotësuar shoqërohet gjithnjë me dokumentacionin justifikues e plotësues.

Brenda tridhjetë ditëve, Drejtoria/Zyra e Taksave Vendore bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit dhe vendos:

- Ta pranojë kërkesën për korigjim dhe bën korigjimin e vlerës, nëse vlerësimi fillestar është bazuar mbi të dhëna të gabuara apo ka gabime në përlllogaritje;
- Ta refuzojë kryerjen e korigjimit dhe arsyeton me vendim arsyet e refuzimit të kërkesës për korigjim.

Procedurat e korigjimit, nuk kushtëzohen me ndonjë detyrim nga ana e taksapaguesit për të parapaguar taksën për të cilën është bërë kërkesa për korigjim.

Nëse kërkesa e taksapaguesit për korigjim vendoset të mos merret në konsideratë nga Zyra Tatimore Vendore, taksapaguesi në çdo rast ka të drejtë të kryejë ankim administrativ në strukturën përkatëse pranë NJVV. Afatet e shqyrtimit të kërkesës për korigjim si më lart, nuk shtyjnë afatet për depozitimin e një ankimi administrativ nga ana e taksapaguesit, të cilat fillojnë të maten nga data e njoftimit fillestar të detyrimit dhe ndjekin afatet e përcaktuara në rregulloret për procedurat e ankimit administrativ, miratuar nga vetë NJVV.

11. Transparenca e administratës tatimore

11.1 Transparenca, aksesit në informacion dhe bashkëpunimi me taksapaguesit

Veprimtaria e administratës tatimore duhet të bazohet në parimin e transparencës, parim që lidhet ngushtësisht me garantimin e aksesit në informacion dhe bashkëpunimin me taksapaguesit.

Në veçanti, për sa u përket NJVV, legjislacioni përcakton në mënyrë specifike detyrimin që të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre¹.

Për sa i përket aksesit në informacion, vetë legjislacioni mbi procedurat tatimore përcakton se administrata tatimore duhet të përshtatet me ndryshimet e teknologjisë së informacionit për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur. Për këtë qëllim, është tepër e rëndësishme që të zbatohen metoda informimi dhe komunikimi efikase dhe eficiente me taksapaguesit.

Kjo është e ndërlidhur edhe me nxitjen e bashkëpunimit të taksapaguesve, duke u krijuar atyre mundësinë e kryerjes së shërbimeve në mënyrë elektronike, sidomos ato që lidhen me deklarimin dhe pagesën elektronike të detyrimeve tatimore.

Transparenca e organeve të administratës publike mund të garantohet lehtësisht nëpërmjet përdorimit të teknologjisë. Përdorimi i faqeve të internetit (website) nga ana e bashkive, në të cilat publikohen aktet administrative, kryhen njoftimet apo komunikohen vendimet, planet dhe strategjitë e miratuar në nivel vendor, ndihmon në aksesin e informacionit dhe njohjen nga ana e qytetarëve e biznesit të vendimmarrjes në nivel vendor. Po kështu, komunikimi përtej formave "klasike" me shkrim, nëpërmjet përdorimit të postës elektronike të certifikuar (e-mail), lehtëson dhe përshpejton metodat e komunikimit dhe marrjen e njoftimeve në lidhje me detyrimet tatimore.

¹ Shih nenin 15 i Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Së fundi, përdorimi i sistemeve apo portaleve elektronike, nëpërmjet të cilave dorëzohen deklaratimet dhe kryhen pagesat, lehtëson punën e administratës tatimore e të taksapaguesve, duke shmangur radhën, kohën e pritjes e pagesat cash dhe duke reduktuar burokracinë.

11.2 E drejta e taksapaguesve për informim, asistencë dhe njoftim

Legjislacioni i zbatueshëm për procedurat tatimore u njeh taksapaguesve një sërë të drejtash, ku, midis të tjerave, përfshihen: e drejta për informim dhe asistencë, e drejta për njoftim, e drejta për të kërkuar evidencë, si dhe e drejta për t'u ankimuar.

Bazuar mbi përcaktimet ligjore¹, çdo taksapagues ka të drejtë që të marrë informacion dhe të asistohet pa shpërblim nga administrata tatimore. Brenda strukturës së administratës tatimore duhet të krijohen strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve ndaj taksapaguesve.

Është tepër e rëndësishme që taksapaguesi të njihet në kohë dhe në mënyrë transparente me detyrimet e tij tatimore, të cilat duhet t'i njoftohen në mënyrën e duhur nga administrata tatimore. Pikësëpari, kjo është një e drejtë specifike që u njihet taksapaguesve, pasi legjislacioni përcakton shprehimisht se çdo taksapagues ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij.²

Ky aspekt është gjithashtu i rëndësishëm, sepse bën të mundur që taksapaguesit të njihen në kohë me detyrimet e tyre, duke lehtësuar edhe pagesën e detyrimeve, në kohë dhe pa vonesa.

Kjo u bën po ashtu të mundur atyre edhe vlerësimin e gabimeve apo saktësimeve nga ana e administratës dhe zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjeve në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore.

Së fundi, njoftimi në kohë dhe në mënyrë të rregullt, është i lidhur ngushtë me ushtrimin e së drejtës së taksapaguesve për të ankimuar vendimet e

¹ Shih nenin 30 i Ligjit 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore".

² Shih nenin 32 i Ligjit 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore".

administratës tatimore, në rrugë administrative apo gjyqësore. Kjo pasi afatet e ankimit të taksapaguesve lidhen dhe fillojnë nga data e njoftimeve të dërguara prej administratës tatimore.

11.3 Publikimi i legjislacionit për çështjet tatimore

Administrata tatimore duhet të publikojë dhe të përditësojë aktet ligjore dhe nënligjore tatimore. Ndaj, ligjet e reja tatimore, ndryshimet dhe aktet nënligjore të tyre, duhet të publikohen në faqet zyrtare të internetit, së bashku me buletinet informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e taksapaguesve, unifikimin e praktikave dhe përshtatjen me to të vendimeve teknike. Në nivel qendror, ky është një detyrim ligjor për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, detyrim që zbatohet në mënyrë analoge edhe për administratën në nivel vendor. Në nivel vendor, legjislacionit të publikuar i shtohen edhe vendimet e Këshillit Bashkiak në lidhje me taksat dhe tarifatat apo çështjet e lidhura me buxhetin dhe administrimin e të ardhurave në nivel vendor. Gjithashtu, bashkitë mund të publikojnë materiale sqaruese, komentare, opinione dhe materiale të tjera shpjeguese për zbatimin e legjislacionit tatimor.

NJVV kanë detyrimin e publikimit të vendimeve të këshillave bashkiakë¹ pasi aktet e këshillave vendorë duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe të afishohen në vende me akses të lirë të publikut. Në veçanti, vendimet e këshillit vendor që lidhen me detyrimet fiskale vendore, duhet të publikohen brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga miratimi i tyre², i cili duhet të jetë jo më vonë (në rast ndryshimesh) se tridhjetë ditë pas miratimit nga Kuvendi të ndryshimeve në legjislacionin fiskal, me ndikim në të ardhurat e vetëqeverisjes vendore; pra, jo më vonë se tetori i çdo viti, për vitin pasardhës fiskal.

Për qëllimet e mësipërme, administrata tatimore mund të përdorë të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike, fushatat promovionale, spotet televizive apo radiofonikë, si dhe fushata edukimi dhe sensibilizimi.

¹ Shih nenin 15 i Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

² Shih nenin 5 i Ligjit 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

11.4 Njohja dhe zbatimi i jurisprudencës për çështjet tatimore

Praktikat e mira sugjerojnë që, për të shmangur përsëritjen e praktikave tatimore të gabuara, të cilat janë rrëzuar si të paligjshme nga gjykatat kompetente, administrata tatimore në nivel vendor duhet të njihet dhe të përditësohet me vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore.

Administrata tatimore duhet të përshtatë dhe unifikojë praktikat e saj në përputhje me jurisprudencën e gjykatave kompetente.

11.5 Mënyrat e komunikimit me taksapaguesin

Bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për procedurat tatimore, komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, mund të kryhet sipas mënyrave të mëposhtme:

- Komunikim elektronik (e-mail/e-system);
- Shërbim postar rekomandë;
- Dorazi;
- Me mënyra alternative.

Komunikimi elektronik bën të mundur dërgimin e vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe çdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore në llogarinë e taksapaguesit në sistemin elektronik të shërbimit tatimor (e-system), ose në adresën e postës elektronike (e-mail) të taksapaguesit. Kjo formë komunikimi, siç u tha edhe më sipër, shkon përtej formave "klasike" me shkrim, ndaj lehtëson dhe përshpejton metodat e komunikimit.

Duhet pasur kujdes, në rastin e përdorimit të postës elektronike, që adresa t'i komunikohet administratës tatimore në formën e duhur dhe me pëlqimin e taksapaguesve. Për këtë arsye, bashkitë dhe administrata e tyre këshillohen që të nxisin taksapaguesit për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve standardë, për dhënien e pëlqimit për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike, sipas rregullave të përcaktuara me udhëzimet e ministrit të Financave.

Gjithashtu, komunikimet mund të kryhen edhe në format tradicionale të komunikimit, ku forma kryesore e komunikimit është përmes shërbimit postar rekomande.

Udhëzimi i ministrit të Financave për procedurat tatimore, shton edhe një formë tjetër komunikimi, atë të marrjes dorazi nga ana e taksapaguesve¹, teksa përcakton se akti apo çdo korrespondencë tjetër zyrtare e administratës tatimore, mund të merret edhe dorazi nga taksapaguesi, nëse ky i fundit e dëshiron një gjë të tillë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të përdorin edhe mënyra alternative dhe praktike të njoftimit të taksapaguesve, me qëllim informimin dhe rritjen e suksesit në mbledhjen e të ardhurave. Një nga format mund të jetë ajo e njoftimit nëpërmjet agjentit tatimor, si p.sh., duke e pasqyruar gjendjen e detyrimeve në faturat e energjisë elektrike apo të ujit, apo në forma të tjera komunikimi, ku mbi të gjitha rekomandohen ato elektronike, nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efikas të sistemeve apo portaleve elektronike të komunikimit dhe bashkëpunimit me taksapaguesit.

Me qëllim lehtësimin dhe unifikimin e procedurave administrative, administrata tatimore mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve standardë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave.

¹ Pika 23.3 e Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

12. Menaxhimi i riskut

Në një shoqëri ideale, e cila i bindet ligjit, njerëzit do të paguanin taksat në ngarkim të tyre dhe administrata tatimore do të merrej vetëm me lehtësimin e metodave të përmbushjes së detyrimit nga qytetarët. Kjo shoqëri nuk ekziston. Respektimi i legjislacionit tatimor duhet të ndiqet, kultivohet, monitorohet dhe zbatohet në çdo shoqëri.

Administrimi i taksave është një detyrë komplekse. Administrata “më e mirë” tatimore nuk është thjesht ajo që mbledh të ardhurat më të mëdha; lehtësimi i respektimit të detyrimeve tatimore nuk është thjesht një çështje e ndëshkimit të përshtatshëm të shkeljeve. Administrimi i taksave varet nga shumë më tepër se kaq dhe ndikohet nga ndërveprimi kompleks midis faktorëve të ndryshëm të mjedisit përreth.

Menaxhimi i riskut ka si qëllim të bëjë të mundur që administrata tatimore të përmbushë misionin e saj, duke lehtësuar menaxhimin në marrjen e vendimeve më të mira. Menaxhimi i riskut është një proces i strukturuar, i përbërë nga hapa të mirëpërcaktuar, sipas të cilit po bëhet identifikimi sistematik, analiza, priorizimi dhe trajtimi i risqeve, në mënyrë që të mbështetet vendimmarrja e përmirësuar.

Qëllimi kryesor i organeve tatimore është mbledhja e tatimeve të detyrueshme, në përputhje me ligjin, në mënyrë të tillë që të krijojë besim te sistemi tatimor. Disa taksapagues, për shkak të padijes, pakujdesisë ose veprimeve të qëllimshme, si dhe dobësive të administratës tatimore, nuk i përmbushin detyrimet e tyre.

Për këtë arsye, administratat tatimore duhet të kenë në dispozicion strategji dhe struktura për të siguruar që mospërputhja me legjislacionin e taksave të mbahet në nivel minimal.

Në thelb respektimi i legjislacionit tatimor ka të bëjë me masën në të cilën një taksapagues përmbush detyrimet e tij. Menaxhimi i riskut shqyrton rreziqet që ndikojnë në respektimin e detyrimeve tatimore siç janë regjistrimi, dorëzimi, raportimi dhe pagesa e tatimit.

Qëllimi i menaxhimit të riskut

Menaxhimi i riskut nënkupton ndërmarrjen e veprimeve të qëllimshme për të përmirësuar mundësitë për rezultate të mira dhe për të zvogëluar ato për rezultate të këqija. Menaxhimi i rrezikut nuk është një formulë magjike, që jep gjithmonë përgjigjet e duhura. Ai është metodë pune, që mendohet se do t'u japë përgjigje më të mira pyetjeve më të mira. Është një mjet për marrjen e vendimeve dhe që do ta ndihmojë organizatën të arrijë objektivat e veta.

Objektivi i përgjithshëm është ofrimi i vlerave për aktorët e interesuar të administratës. Vlerat krijohen, ruhen ose shkatërrohen nga vendimet e drejtuesve, duke filluar nga përcaktimi i strategjisë deri tek administrimi i punës së përditshme. Elementi i pandashëm i vendimmarrjes është njohja e risqeve dhe oportuniteteve, çka kërkon që drejtuesit të marrin parasysh informacionet në lidhje me mjediset e brendshme e të jashtme, të shpërndajnë burimet e çmuara dhe të përshtatin aktivitetet me rrethanat e ndryshueshme.

Asnjë administratë nuk vepron në një mjedis ku rreziku nuk ekziston dhe menaxhimi i riskut nuk krijon një mjedis të tillë. Menaxhimi i riskut u jep mundësi drejtuesve të veprojnë në mënyrë më efektive në mjedise të mbushura me rreziqe.

Përkufizimi i riskut

Risku mund të përkufizohet si:

Çdo gjë negative, që mund të ketë ndikim në aftësinë e organizatës për të përmbushur objektivat e saj.

Koncepti i rrezikut i ka rrënjët në tregtinë detare të lashtësisë italiane. Ky koncept rrjedh nga ndërthurja e konceptit të shansit ose pasigurisë në dete dhe materialitetit të humbjes së anijeve dhe ngarkesave (për fat të keq, ekuipazhi nuk llogaritej si humbje). Që të ekzistojë rreziku, duhet të ekzistojnë njëkohësisht pasiguria dhe ekspozimi ndaj humbjes. Rreziku përbëhet nga karakteristika si: cenueshmëria, ashpërsia ose rëndësia dhe mundësia relative apo shpeshësia e ngjarjes.

Rreziqet janë ngjarje ose rrethana, që mund ose do të rezultojnë me probleme për organizatën. Rreziqet duhet të përcaktohen në një nivel të tillë, që vetë ato dhe shkaqet e tyre të jenë të kuptueshme e të mund të vlerësohen me saktësi. Rreziku mbulon të gjitha elementet më poshtë:

- Rrezik - po ndodhin gjëra të këqija;
- Pasiguri - gjërat nuk po shkojnë siç pritej;
- Mundësi - nuk po ndodhin gjërat e mira, ndaj japin një rezultat të keq (duke mos arritur objektivat). Këto ngjarje ose rrethana duhet të identifikohen.

Nëse objektivi është rritja e nivelit të përputhshmërisë vullnetare, sjellja e pandershme e taksapaguesve do të paraqesë një rrezik. Nga ana tjetër, nëse objektivi është maksimizimi i të ardhurave nga veprimtaria e auditimit, sjellja e ndershme e taksapaguesve do të përfaqësojë një rrezik. Janë objektivat ata që vendosin se cilat janë risqet. Si rrjedhojë, në varësi të objektivave, risqet do të jenë mjaft të ndryshme.

Duhet të identifikohen si rreziqet e jashtme ashtu edhe ato të brendshme, por vëmendja duhet të jetë te rreziqet që mund të ndikohen në ndonjë farë mënyre nga administrata tatimore. Rreziqet e jashtme janë, për shembull, sjellja e taksapaguesve dhe faktorëve të ndryshëm që varen nga mjedisi i jashtëm. Rreziqet e brendshme janë, për shembull, sjellja e punonjësit të tatimeve (si fjala vjen, korrupsioni). Është e rëndësishme që, në njëfarë mënyre, të mbulohen si rreziqet e jashtme ashtu dhe ato të brendshme.

Kuptimi i këtij koncepti është i domosdoshëm. Përkufizimi i rrezikut e bën të qartë se pikat fillestare për identifikimin e rreziqeve janë objektivat e organizatës. Pa kuptuar objektivat, është e pamundur të identifikohen rreziqet. Identifikimi i rreziqeve duhet të fillojë me objektivat e nivelit të lartë dhe të vazhdojë me objektivat e tjerë, të niveleve të ndryshme.

12.1 Mjedisi i menaxhimit të riskut

Konteksti operativ është thelbësor në procesin e menaxhimit të riskut dhe mund të përkufizohet si “mjedisi” në të cilin vepron administrata tatimore. Ekziston një shumëllojshmëri e gjerë faktorësh mjedisorë dhe organizativë që duhet të merren parasysh. Konteksti, së bashku me rregullat e lojës, mund të konsiderohet si fusha e lojës. Ky është kuadri brenda të cilit zbatohet menaxhimi i riskut. Objektivat përshkruajnë qëllimin e lojës dhe çfarë synohet të arrihet. Strategjia përshkruan se si duhet luajtur për të arritur objektivat. Menaxhimi i riskut përdoret brenda këtij kuadri, në mënyrë që të përcaktohet se çfarë duhet bërë për të arritur objektivat.

Administrata vepron brenda një numri kontekstesh, që janë njëkohësisht

kontekste të jashtme e të brendshme. Disa prej tyre janë ekonomike, disa janë të nivelit qeveritar e disa të tjera të nivelit kombëtar e rajonal.

12.1.1 Konteksti i jashtëm

Një numër faktorësh të mjedisit të jashtëm ndikojnë në kontekstin operativ, përfshirë legjislacionin, opinionin publik dhe kushtet ekonomike. Më poshtë jepen shembuj të faktorëve të jashtëm.

i. Legjislacioni

Ligjet përcaktojnë bazën e taksimit. Efikasiteti apo efektiviteti i administratës tatimore nuk mund të vlerësohet, pa marrë parasysh njëkohësisht shkallën e kompleksitetit të strukturës së taksës që duhet të administrohet dhe masën në të cilën ajo strukturë mbetet e qëndrueshme me kalimin e kohës. Edhe administrata tatimore më e sofistikuar lehtësisht mund të mbingarkohet me detyra të pamundura. Zbatimi i një legjislacioni tatimor të bërë keq, zakonisht nuk është ide e mirë. Që një ligj të zbatohet me përpikëri, duhet të jetë njëkohësisht i përshtatshëm me mjedisin dhe i zbatueshëm: zbatimi optimal kërkon një legjislacion të mirë tatimor. Ligji gjithashtu përcakton kuadrin e kompetencave formale të administratës tatimore.

ii. Opinioni publik

Shembuj të rëndësishëm të opinionit publik janë qëndrimet e taksapaguesve ndaj taksave dhe qeverisë në përgjithësi. Qëndrimet kanë ndikim të qëllimet dhe qëllimet kanë ndikim tek sjellja. Qëndrimet formohen në një kontekst shoqëror nga faktorë të tillë si niveli i perceptuar i evazionit, drejtësia e perceptuar e strukturës tatimore, kompleksiteti dhe stabiliteti i saj, mënyra se si administrohen taksat, vlera që i njihet veprimtarisë së qeverisë dhe legjitimiteti i qeverisë.

iii. Kushtet ekonomike

Mjedişi ekonomik ka gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në efektivitetin e administratës tatimore. Faktorët që duhen marrë parasysh mund të jenë përmasat e ekonomisë dhe ndikimi i saj te partnerët e biznesit, aksesit në dhe nga tregjet e tjera, politikat konkurruese të taksave të partnerëve kryesorë të biznesit dhe natyra e ekonomisë.

Shumë administrata përqendrohen te proceset ekzistuese brenda administratës, duke i kushtuar vëmendje më të vogël botës industriale dhe tregtare. Në këto

raste, administrata tatimore, përveçse mund të jetë duke krijuar një barrë të panevojshme për biznesin, mund të jetë gjithashtu duke vënë në rrezik të ardhurat. Prandaj është e rëndësishme të konsiderohet tatimi nga pikëpamja e taksapaguesve.

Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi ndikojnë në aftësinë për të mbledhur taksat dhe për të kryer auditimin e taksapaguesit. Korporatat që veprojnë në nivel ndërkombëtar nuk i konsiderojnë më kufijtë nacionalë si një pengesë për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

12.1.2 Konteksti i brendshëm

Ndikimi te rreziqet e administrimit të sistemit tatimor vijnë nga një numër aftësish të brendshme thelbësore. Këto përfshijnë organizimin, burimet dhe mjetet. Më poshtë jepen shembuj të faktorëve të brendshëm.

i. Organizimi

Kultura dhe struktura organizative janë të rëndësishme. Së pari dhe më e rëndësishmja, vetëdija e ekzistencës së rrezikut në të gjitha nivelet e administratës është e nevojshme për menaxhimin e suksesshëm të riskut. Të gjithë punonjësit duhet të kuptojnë dhe të pranojnë punën që bëjnë dhe arsyet përse po e bëjnë. Ashtu siç ndodh në një mekanizëm me rrota, kontributet e të gjitha pjesëve të administratës duhet të përputhen me njëra-tjetrën, ose përndryshe i gjithë mekanizmi nuk do të funksionojë.

Për të bërë të mundur që organizata të mund të veprojë në mënyrë efektive dhe efikase, struktura dhe karakteristikat e administratës duhet të përputhen me deklaratimet e misionit dhe strategjitë e saj.

ii. Burimet

Numri i punonjësve dhe niveli i tyre i trajnimit dhe edukimit janë gjithashtu pjesë e kontekstit. Si pasojë e një qasjeje të orientuar drejt riskut, shpërndarja e burimeve njerëzore dhe e burimeve të tjera duhet të bëhet në përputhje me riskun dhe jo anasjelltas. Kjo do të thotë që strategjitë e trajtimit nuk duhet të bazohen te njohuritë ose vendndodhja aktuale e stafit. Trajtimi duhet të bazohet te prioritizimi i riskut dhe njohuritë. Me kalimin e kohës do të duhet që edhe shpërndarja e stafit të përshtatet me këto të fundit.

iii. Mjetet dhe aksesit të dhënave

Disponueshmëria e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe aksesit të dhënave ka një rëndësi të madhe. Përdorimi në masë i teknologjisë së informacionit krijon mundësitë për të përmirësuar performancën e administratës tatimore. Ndikon te faktorë, të tillë si: dosjet e rregullta dhe të përditësuara të taksapaguesve, si dhe krijimi i bazave të dhënave, që bëjnë të mundur vlerësimin e kryqëzuar të dhënave. Mjetet e përparura nuk janë të dobishme, nëse aksesit të dhënave është i dobët. Si rrjedhojë, niveli i grumbullimit të dhënave në formë digjitale është thelbësor për administratën.

12.1.3 Objektivat

Objektivat përshkruajnë rezultatin e dëshiruar dhe përcaktojnë se çfarë duhet të arrihet në çdo nivel administrativ të një organizate. Ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis objektivave, të cilat janë synimet që një organizatë përpiqet të arrijë, dhe procesit të menaxhimit të riskut, i cili përfaqëson atë që nevojitet të kryhet për arritjen e objektivave.

Objektivat përcaktojnë se cilat rreziqe duhet të identifikohen. Objektivat kanë gjithashtu ndikim në vlerësimin e riskut dhe në mënyrën se si adresohen risqet. Çdo vendim i marrë gjatë procesit të menaxhimit të riskut duhet të marrë parasysh objektivin(at) që organizata po përpiqet të arrijë. Rreziku rrjedh nga objektivat. Kjo mund të përshkruhet nëpërmjet një shembulli.

Ti ke si qëllim të lundrosh me anije nga porti A në portin B. Duke u bazuar në këtë objektiv, mund të fillosh të identifikosh rreziqet. Rreziqet mund të jenë stuhitë, defektet teknike dhe ngjarje apo rrethana të tjera. Këto rreziqe duhet të vlerësohen dhe priorizohen. Sipas objektivit, shtrohet pyetja: A është vallë mbërritja e sigurt në port më të rëndësishme sesa mbërritja e shpejtë, por e rrezikshme? Nëse objektivi yt është që të arrish portin B me shpejtësi, mund të vendosësh të marrësh parasysh rrezikun, duke lundruar në mot të keq.

Vendosja e një objektivit, që synon vetëm mbledhjen e taksave shtesë si pasojë e deklarimeve të pasakta, mund të çojë në arritje nga viti në vit. Kjo metodë të jep përshtypjen se rreziqet janë identifikuar saktësisht dhe trajtimi ka qenë i duhuri. Një mënyrë për arritjen e objektivit mund të jetë pritja për periudha më të gjata ndërmjet identifikimit të rrezikut dhe trajtimit të tij në mënyrë që gabimet të shumëfishohen. Kjo mund të çojë në një rrezik të mëtejshëm, që nuk ishte konsideruar kur u miratua objektivi, domethënë, mundësinë e tatimpaguesit për

të paguar detyrime më të larta të vlerësuara vite më vonë. Gjithashtu pritja për periudha më të gjata, si në situatën e mësipërme, vështirëson ndryshimin e sjelljes së tatimpaguesit. Duke u përqendruar tek objektivi i gabuar dhe, si rrjedhojë, duke trajtuar riskun e gabuar, hendeku faktik i taksave mund të bëhet më i madh.

Kur nga objektivat janë identifikuar risqet, është gjithashtu e mundur që, duke u bazuar te risqet, të identifikohen objektiva të reja. Me qëllim trajtimin e një risku, mund të përcaktohet një objektivi për arritjen e diçkaje. Ky do të ishte një objektivi i nivelit më të ulët, që ka si target një objektivi të një niveli më të lartë. Për shembull, nëse mashtrimi tatimor perceptohet si një rrezik, një nga objektivat mund të jetë zhvillimi i një procesi të mirë, të ndërsjellë, të ndihmës administrative. Ky objektivi i ri (asistencë më e mirë administrative) mund të përdoret pastaj për identifikimin e objektivave të reja (të nivelit më të ulët; për shembull: nivele më të ulëta të humbjeve të pakthyeshme për tatimpaguesit e huaj).

Për administratën tatimore, mund të funksiononte si më poshtë:

- Objektivi i nivelit të lartë: Rritja e zbatueshmërisë vullnetare
- Rreziku i identifikuar: Mungesa e besimit tek administrata tatimore
- Objektivi i ri: Rritja e besimit tek administrata tatimore
- Rreziku i ri: Punonjësit e tatimeve keqtrajtojnë taksapaguesit
- Objektivi i ri: Ndryshimi i qëndrimeve të punonjësve të tatimeve

Kjo tregon se, për të filluar punën me menaxhimin e riskut, duhet të ekzistojë një objektivi. Objektivi është pika fillestare, por, kur procesi funksionon, ai mund të ketë gjithashtu ndikim tek objektivat e tjerë.

12.2 Procesi i menaxhimit të riskut

Procesi i menaxhimit të riskut mund të ilustruhet si një qark i vazhdueshëm, sipas një modeli që ndjek hapat e mëposhtëm: Identifikimi i riskut, Analiza e riskut, Vlerësimi i riskut dhe Prioritizimi, Trajtimi e Vlerësimi.

12.2.1 Identifikimi i riskut

Hapi i parë në procesin e menaxhimit të riskut është identifikimi i rreziqeve. Gjatë

fazës së identifikimit të rrezikut regjistrohen rreziqet potenciale, që kërcënojnë objektivat e organizatës. Identifikimi i rrezikut është një fazë e rëndësishme, sepse, nëse rreziqet nuk identifikohen gjatë kësaj faze, është e mundur të mos identifikohen më dhe kështu të mbeten të pambuluara. Përveç kësaj, momenti kur identifikohet një rrezik është vendimtar. Sa më herët të identifikohet risku, aq më herët mund t'i kushtohet vëmendja e duhur. Si rrjedhojë, jo vetëm që zvogëlohet rreziku i mospagimit të taksës, por rritet edhe efekti parandalues, sepse periudha kohore ndërmjet kryerjes së shkeljes dhe vendosjes së sanksionit është më e shkurtër. Gjatë fazës së identifikimit të riskut, hartohet edhe një listë e rreziqeve të mundshme.

Rreziqet mund të kategorizohen sipas llojeve të ndryshme:

i. Risku i regjistrimit:

Rreziku që rendimenti i taksave të reduktohet nga:

- Personat që nuk janë subjekt i regjistrimit tatimor regjistrohen ose mbeten të regjistruar kur pushojnë së qeni subjekt i regjistrimit tatimor, ose
- Mosregjistrimi i personave që janë subjekt i detyrimit të regjistrimit tatimor, ose
- Mbjajtja në regjistër e informacionit të pasaktë.

Risku i depozitimeve

Rreziku që rendimenti i taksave do të llogaritet më i vogël, zvogëlohet nga tatimpaguesit që nuk paraqesin deklaratimet e tyre në datën e duhur.

Për të siguruar trajtimet e duhura parandaluese dhe korigjuese, është e nevojshme targetimi i atyre taksapaguesve, të cilët i depozitojnë deklaratimet me vonesë ose nuk i depozitojnë fare.

ii. Risku i pagesave

Rreziku që rendimenti tatimor të zvogëlohet nga mospagesa e shumave të detyruara sipas deklaratimeve dhe vlerësimeve. Rreziku i pagesave dhe rreziku i depozitimeve mund të jenë të lidhura ngushtë, por, për shkak se trajtimi i tyre mund të jetë i ndryshëm, është e rëndësishme të analizohen veçmas.

iii. Risku i deklaratimeve

Rreziku që mbledhja e taksave do të ndikohet kur taksapaguesi deklaron informacione të pasakta për shkak të gabimit ose veprimit të qëllimshëm të deklaruesit. Tradicionalisht, shumë administrata tatimore përqendrohen në këtë

fushë risku, me qëllim identifikimin e rasteve që do të zgjidhen për verifikimin në terren.

Klasifikimi i rrezikut në këto zëra, i lejon çdo administratë tatimore të jetë në një pozicion më të fortë për të përcaktuar teknikën e duhur të trajtimit. Brenda secilës prej këtyre kategorive, ekziston një spektër i gjerë i nëngrupeve dhe i rreziqeve individuale.




Figura 1. Piramida e përputhshmërisë me detyrimet

Një zonë risku është një tërësi rreziqesh të lidhura, për shembull, rreziqet që kanë të bëjnë me xhiron ose rreziqet që kanë të bëjnë me një pjesë specifike të legjislacionit tatimor. Zonat e ndryshme të riskut mund të identifikohen dhe përshkruhen në një regjistër risku. Është e rëndësishme identifikimi i zonave të risqeve sipas fushës, por është gjithashtu e rëndësishme të mbahet parasysh se risku në një fushë mund të ketë ndikim në një ose më shumë risqe në fusha të tjera.

Tatimpaguesit mund të grupohen në mënyra të ndryshme, për shembull në sektorë (siç janë ndërtimi apo tregtia elektronike), niveli i rëndësisë, forma ligjore, niveli i përputhshmërisë ose një ndërthurje e këtyre kategorive. Natyrisht, niveli i përputhshmërisë është gjithmonë një llogaritje e përafërt, bazuar në një numër kriteresh që japin disa informacione në lidhje me sjelljen e njohur (tatimore) të një

tatimpaguesi, përfshirë rregullsinë e deklarimeve dhe pagesave.

Në fazën e analizës së riskut, rreziqet dhe tatimpaguesit e rrezikshëm, të identifikuar në fazën e mëparshme, janë peshuar në mënyrë sistematike dhe janë grupuar në mënyrë relative. Analiza e riskut kryhet në bazë të të dhënave të mbledhura nga burimet. Në botën e sotme ka shumë burime të mundshme, por vetëm disa prej tyre janë të dobishme për analizën e riskut. Ato mund të grupohen në:

- Të dhëna ekonomike dhe të taksave, për shembull raportet rreth rritjes ekonomike, pagat mesatare;
- Të dhënat e paraqitura nga tatimpaguesit, për shembull të dhënat nga deklaratimet tatimore;
- Të dhënat e taksave të mbledhura nga administratat, për shembull data e përputhshmërisë së fundit, numri i deklarimeve të dorëzuara me vonesë;
- Të dhënat e paraqitura nga një palë e tretë, për shembull një bankë
- Informacioni në dispozicion në Internet.

Informacioni ose të dhënat që mund të përdoren në analizë kufizohen vetëm nga:

- Aftësia për të gjetur informacionin;
- Ligjshmëria e informacionit të mbledhur;
- Vlera që informacionet ose të dhënat e reja u shtojnë informacioneve dhe të dhënave që janë tashmë në dispozicion (rreziku i informacionit të tepërt);
- Kapaciteti i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në përdorim;
- Kostot e mbledhjes së të dhënave të reja.

Administrata tatimore vendore, ka në dispozicion vetëm një përqindje të vogël të këtyre lloj burimeve të informacionit dhe duhet të bazohet kryesisht në historikun e taksapaguesve, shkëmbimin e informacionit me administratën tatimore qendrore, si dhe verifikimet në terren.

Si përfundim, analiza e riskut rezulton në marrjen e njohurive për një ose më shumë nga fushat e mëposhtme;

- Karakteristikat e tatimpaguesve të përfshirë;
- Arsyet e sjelljes së tatimpaguesit;
- Gjasat ose frekuenca e rrezikut;
- Treguesit/rregullat dhe parametrat e përzgjedhjes;
- Pasojat;
- Trendi, domethënë rreziku bëhet më shumë ose më pak i rëndë;

- Opsionet e mundshme të trajtimit;
- Kostoja e trajtimit.
- Ndikimi në objektivat e administratës tatimore: i ulët, i mesëm, i lartë, shumë i lartë.

Gjasat përfaqësojnë probabilitetin se diçka do të ndodhë. Frekuenca tregon se sa shpesh do të ndodhë. Gjatë studimit të një zone rreziku, gjasat e evazionit fiskal shpesh janë 100%, por ky nuk është një informacion interesant. Informacioni i nevojshëm është se sa i zakonshëm është evazoni fiskal në zonën e rrezikut, domethënë frekuenca e tij. Megjithatë, kur në fokus është një specifik, gjasa e evazionit fiskal përbën një informacion interesant. Pasojat përfshijnë një sërë faktorësh të ndryshëm, por duhet të bazohen në objektivat e administratës. Do të kemi një pasojë negative në rastet kur administrata nuk mund të arrijë objektivat e saj. Normalisht, kjo do të thotë se pasoja duhet të ndahet në faktorë të ndryshëm si shumë e taksave (shkalla), ndikimi në besimin e publikut në sistemin e taksave, rreziku i infektimit etj. Duhet të thuhet se rezultati 100% nuk është i arritshëm. Kjo ndodh jo vetëm për shkak të të dhënave të munguara ose të padobishme dhe teknikave të papërshtatshme, por do të ishte gjithashtu nënvlerësim mosmarrja parasysh e faktorit njerëzor dhe kreativitetit të tij në çështjet e taksave.

Sa më shpejt të analizohen dhe zbulohen rreziqet, aq më shpejt mund të trajtohen ato. Mbulimi i rrezikut, duke trajtuar mospërputhjen e pritshme, rezulton në korrigjimin e dëmit të pësuar, nëse rreziku ka ndodhur vërtet. Kur zbatohet në mënyrë korrekte, aktiviteti represiv prodhon gjithashtu një efekt parandalues dhe shërben si mbulim i riskut, jo vetëm kundrejt tatimpaguesit individual por, nëpërmjet rrjetit të tij shoqëror dhe tregtar, edhe kundrejt tatimpaguesve të tjerë. Në fund të fundit, një karakteristikë e përbashkët e mbulimit të riskut është se, përveç rasteve kur zhvillohen aktivitete të hetimit, tatimpaguesi e di se po trajtohet, ai e "përjeton" përvojën e administratës tatimore.

Megjithatë, ka shumë mënyra për të mbuluar risqet dhe për të bashkëvepruar me institucionet; mënyra që ndryshojnë jo vetëm në shkallën e thellësisë, por edhe në kapacitet e nevojshme. Përdorimi i një mase për mbulimin e riskut, nuk do të thotë se të gjitha rreziqet mbulohen. Disa prej tyre mund të pranohen, për shembull për shkak të pasojave të vogla financiare që prodhojnë. Për arsye të efikasitetit dhe efektivitetit, masat e mbulimit të riskut duhet të jenë në proporcion me masën e rrezikut dhe/ose të kostos ndaj tatimpaguesit. Ky quhet parimi i proporcionalitetit. Por duhet theksuar se përdorimi i masave të lartpërmendura natyrisht varet gjithmonë nga rrethanat specifike ligjore ekzistuese ose nga një domosdoshmëri politike.

13. Referenca

- Kodi Civil.
- Kodi i Procedurës Civile.
- Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 110/2016, "Për Falimentimin".
- Ligji Nr. 8537 datë 18.10.1999, "Për barrët siguroese", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9874, datë 14.2.2008, "Për ankandin publik" (referuar si "Ligji për ankandin publik").
- Ligji Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Rregullore e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Nr. 493, datë 06.07.2006, "Rregullore e barrëve siguroese".
- Udhëzim i ministrit të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
- Udhëzimi Nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (referuar si "Udhëzimi për procedurat tatimore").
- VKM Nr. 1234, datë 16.12.2009, "Për përcaktimin e formatit dhe të elementeve të njoftimit për barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekare".
- "Apelimi tatimor në nivel vendor", Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, Projekti për Planifikim dhe Qeverisjen Vendore, maj 2018.
- "Udhëzues praktik për mbledhjen e detyrimeve tatimore vendore", Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, Projekti për Planifikim dhe Qeverisjen Vendore, qershor 2016.
- "Raport vlerësimi për administrimin fiskal në nivel vendor dhe praktikat e mira", ESA Consulting/UNDP/STAR II, tetor 2018.

STAR II PROJECT

Consolidation of Territorial and Administrative Reform



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

+11,00.00



HM&H



Funded by the
European Union



Empowered lives.
Resilient nations.